

# Liahona



**Më Shumë  
Adoleshentë po  
Shkojnë në Tempull:  
Ndhimojini Ata që  
të Bëhen Gati, f. 18**

**Duke e Parë Misionin  
Tim me një Këndvështrim  
të Ri, f. 42**

**Në ç'Mënyrë Mund t'Ju  
Ndhimojë që të Pendoheni  
Peshkopi Juaj, f. 58**

**Jezusi Tha që t'i Doni të  
Gjithë – Madje dhe Ata që  
Ju Ngacmojnë, f. 68**



*“Por edhe pse mund të ndihemi të humbur në mes të rrethanave tona të tanishme, Perëndia premton shpresën e dritës së Tij – Ai premton të na e ndriçojë udhën përpara nesh dhe të na tregojë udhën për të dalë nga errësira.”*

Presidenti Diter F. Uhtdorf,  
Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë, “Shpresa e Dritës së Perëndisë”, *Liahona*, maj 2013, f. 70.



## MESAZHET

- 4 Mesazhi i Presidencës së Parë: Përgjegjësia Jonë për t'i Shpëtuar**  
Nga Presidenti Tomas S. Monson
- 7 Mesazhi i Vizitave Mësimore: Misioni Hyjnor i Jezu Krishtit: Krijuesi**

## ARTIKUJT KRYESORË

- 12 Luajeni Mirë Rolin Tuaj**  
Nga Plaku Kuentin L. Kuk  
*Kur të jesh anonim është më e lehtë se kurrë, ka parime të rëndësishme që përfshihen në mosbajtjen e një maske dhe në të qenit të vërtetë ndaj besimit tuaj.*
- 18 Adolehentët dhe Besëlidhjet e Tempullit**  
Nga Geri dhe Suzan Karter  
*Tani është koha që të filloni t'i përgatisni fëmijët tuaj për të hyrë në tempull.*
- 20 Trashëgimia Jonë e Madhe Misionare**  
Nga Larin Porter Gant dhe Linda Deker Lopez  
*Të gjithë misionarët, të së shkuarës ose të së sotmes, shërbejnë me shpresën për t'ua bërë jetën më të mirë njerëzve të tjerë.*
- 26 Gati për Ditën e Betejës**  
Nga Plaku Eduardo Gavaret  
*Parimet më të thjeshta mund të vendosin fatin tonë mes betejave të jetës.*
- 30 Përshpejtimi i Punës për Shpëtim**  
*Anëtarësia në Kishën e Zotit do të thotë të jesh thirrur për të qenë plotësisht i përfshirë në punën e Tij.*
- 34 Të Bërit një Njeri i Paqes**  
Nga Methju D. Fliton  
*Ungjilli ia ndryshoi zemrën një burri – dhe e bashkoi familjen e tij.*

## SEKSIONET

- 8 Bllok Shënimesh për Konferencën e Tetorit: Ide për Konferencën e Përgjithshme**  
Nga Tina Spenser
- 9 Mësimdhënie nga Për Forcën e Rinisë: Shëndeti Fizik dhe Emocional**
- 10 Lajme të Kishës**
- 38 Zëra të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme**
- 80 Kur Prapë të Takohemi: Unë Betohe . . .**  
Nga R. Val Xhonsen

### NË KOPERTINË

Përpara: Ilustrim me foto nga Cody Bell.  
Prapa: Ilustrim me foto nga Cody Bell.  
Brenda kapakut të përparmë: Ilustrim me foto nga iStockphoto/Thinkstock.

42



#### 42 Si Mund të Jem një Misionare e Suksesshme?

Nga Loren Bangarter Uajld

*Ne u përballëm me refuzim në çdo cep dhe unë isha e shkuraçar. Më duhej të gjeja një përkufizim të ri për suksesin.*



*Shihni nëse mund të gjeni Liahonën e fshehur në këtë botim.*

*E dhënë:  
Ndani frutin.*

**46** **Të Bërit një Misionar për Predikimin e Ungjillit Tim**  
Nga Plaku Dejvid A. Bednar  
*Këto pesë kërkesa do t'ju ndihmojnë të bëheni një misionar më i mirë.*

**51** **Thjesht Buzëqeshni dhe Thoni "Jo"**  
Nga Hazel Mari Tibule  
*Si mund t'i thoja "jo" presidentit të kompanisë?*

**52** **Për Forcën e Rinisë: Ji i Fortë, Ji i Shëndetshëm, Ji i Zgjuar**  
Nga Plaku Adrián Oçoa  
*Vishni atletet tuaja dhe ushtrohuni!*

**54** **Shkoni Pas Gjurmëve të Tij**  
Nga Melisa Zenteno  
*Të bërit si Jezu Krishti mund të duket si fizikë e përparuar, por procesi fillon me hapin tënd të parë.*

**56** **Pyetje e Përgjigje**  
*Çfarë u them unë joanëtarëve që pyesin përse disa anëtarë të Kishës nuk po i jetojnë standardet tona?*

**58** **Përse dhe Çfarë Duhet t'i Rrëfej Peshkopit Tim?**  
Nga Plaku C. Skot Grou  
*Pendimi është një gjë personale midis Zotit dhe meje. Përse duhet të flas edhe me peshkopin tim?*



61

**61** **Ta Ftojme Shpëtimtarin që të Hyjë Brenda**  
Nga Plaku O. Vinsent Halek  
*Shpëtimtari po pret që ta ftoni në jetën tuaj!*

**62** **Dhjak Fringo i Ri**  
Nga Xhejn Mek-Brajd Çoejt  
*Benxhi ishte i shqetësuar për shpërndarjen e sakramentit. A mund ta bënte vërtet këtë?*

**64** **Pas Gjurmëve: Duke Pritur në Lagjet Dimërore**  
Nga Xhenifer Medi

**66** **Shenjtorët Ndalojnë te Lagjet Dimërore**  
Nga Ari Van De Graf

**67** **Dëshmitar i Veçantë: Si u flet profetëve Jezu Krishti?**  
Nga Plaku D. Tod Kristoferson

**68** **Ndihmë për Violetën**  
Nga Sharlot Mae Shepard  
*Violeta ishte sjellë gjithmonë keq me Emën. Përse Ema duhej të sillej mirë me të?*

**70** **Sjellja e Fillores në Shtëpi: Unë do ta Ndaj Ungjillin me të Gjithë Fëmijët e Perëndisë**


**72** Kamila nga Nju-Jork-Siti

**74** Faqja Jonë

**76** Për Fëmijët e Vegjël

**81** **Portret Profeti: Dejvid O. Mek-Kei**

52



Për pajtimet dhe për çmimet jashtë Shteteve të Bashkuara dhe Kanadasë, shkoni në [store.lds.org](http://store.lds.org) ose kontaktoni me qendrën tuaj vendore të Kishës për shpërndarjen ose me udhëheqësin e lagjes apo degës

**Paraqitini dorëshkrimet dhe pyetjet në internet** në [liahona.lds.org](http://liahona.lds.org); nëpërmjet postës elektronike [liahona@ldschurch.org](mailto:liahona@ldschurch.org); ose nëpërmjet postës në *Liahona*, Rm. 2420, 50 E. North Temple St., Salt Lake City, UT 84150-0024, USA.

*Liahona* (një term nga Libri i Mormonit, që do të thotë "busull" apo "drejtues") botohet në anglisht, armenisht, bislamisht, bullgarisht, çekisht, danisht, estonisht, fihisht, finlandisht, frëngjisht, greqisht, gjermanisht, holandisht, hungarisht, indonezisht, islandisht, italisht, japonisht, kambozishit, kinezisht, kiribatishit, koreanisht, kroatishit, letonishit, lituanisht, malagasishit, marshallisht, mongolisht, norvegjisht, polonisht, portugalisht, rumanisht, rusisht, samoaisht, sebuanisht, sllovenisht, spanjisht, suahilisht, suedisht, shqip, tagalogisht, tahitisht, taisht, tongaisht, ukrainisht, urduisht dhe vietnamsisht. (Periodiciteti ndryshon sipas gjuhës.)

© 2013 nga Intellectual Reserve, Inc. I rezervohen të gjitha të drejtat. Shtypur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Lënda e shkruar dhe ajo figurative e *Liahonës* mund të kopjohet për ta përdorur me raste në kishë ose në shtëpi, jo për tregti. Lënda figurative nuk mund të kopjohet nëse ajo shoqërohet me kufizime të shënimi i meritave për punën artistike. Çështjet e së drejtës së autorit duhet të adresohen te: Intellectual Property Office, 50 E. North Temple St., Salt Lake City, UT 84150, USA; adresa elektronike: [cor-intellectualproperty@ldschurch.org](mailto:cor-intellectualproperty@ldschurch.org).

**For Readers in the United States and Canada:** October 2013 Vol. 15 No. 3. LIAHONA (USPS 311-480) Albanian (ISSN 1521-4753), is published four times a year (April, May, October and November) by The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints, 50 E. North Temple St., Salt Lake City, UT 84150. USA subscription price is \$3.00 per year; Canada, \$3.60 plus applicable taxes. Periodicals Postage Paid at Salt Lake City, Utah. Sixty days' notice required for change of address. Include address label from a recent issue; old and new address must be included. Send USA and Canadian subscriptions to Salt Lake Distribution Center at address below. Subscription help line: 1-800-537-5971. Credit card orders (Visa, MasterCard, American Express) may be taken by phone or at [store.lds.org](http://store.lds.org). (Canada Poste Information: Publication Agreement #40017431)

POSTMASTER: Send all UAA to CFS (see DMM 707.4.12.5). NONPOSTAL AND MILITARY FACILITIES: Send address changes to Distribution Services, Church Magazines, P.O. Box 26368, Salt Lake City, UT 84126-0368, USA.

# Ide për Mbrëmje Familjare

*Ky numër përmban artikuj dhe aktivitete që mund të përdoren për mbrëmje familjare. Sa vijon janë dy ide.*



ILUSTRIM ME FOTO NGA CRAIG DIMOND

**“Të Bërit një Misionar për Predikimin e Ungjillit Tim”,** faqe 46: Merrni parasysht të diskutoni si familje pesë karakteristikat e misionarëve për *Predikimin e Ungjillit Tim*. Pastaj përpiqui t’i praktikoni parimet. Ju mund të shqyrtoni shkurtimisht së bashku një pjesë nga udhëzuesi *Predikoni Ungjillin Tim* dhe t’i vini pjesëtarë të ndryshëm të familjes që me radhë e shkurtimisht të praktikojnë pjesë mësimdhënëse të mësimëve të misionarëve ndërsa pjesëtarë të tjerë të familjes bëjnë sikur janë kërkuar. Ju mund të diskutoni sfidat e punës misionare dhe të gjeni ide për të zhvilluar karakteristikat e përkthura nga Plaku Dejvid A. Bednar.

**“Ji i Fortë, Ji i Shëndetshëm, Ji i Zgjuar”,** faqe 52: Pasi të shqyrtoni artikullin e Plakut Adrián Oçoa, merrni parasysht të planifikoni një aktivitet që i lejon pjesëtarët e familjes suaj të jenë fizikisht aktivë së bashku. Ju mund të praktikoni një sport apo të bëni një ecje. Sigurohuni ta përshtasni aktivitetin tuaj me moshën dhe aftësitë e pjesëtarëve të familjes (për shembull, ju mund t’u kërkonit fëmijëve më të rritur që të ndihmojnë fëmijët më të vegjël për ta plotësuar aktivitetin). Pas aktivitetit tuaj, diskutoni si familje dobitë e një mënyre jetese fizikisht aktive. Ju mund të planifikoni gjithashtu mënyra se si të vazhdoni të punoni si familje për të ndjekur këshillën e profetëve tanë të gjallë për t’u kujdesur për trupat tanë.

## NË GJUHËN TUAJ

*Liahona* dhe materiale të tjera të Kishës janë të disponueshme në shumë gjuhë në [languages.lds.org](http://languages.lds.org).

## TEMAT NË KËTË BOTIM

*Numrat përfaqësojnë faqen e parë të artikullit.*

**Aktivizimi,** 4, 30, 38

**Betimi,** 80

**Cilësitë si të Krishtit,** 54

**Dashuria hyjnore,** 4, 20, 34, 68

**Falja,** 58, 68

**Fatkeqësia,** 42, 64, 68

**Fëmijët,** 76

**Fjala e Urtësisë,** 9, 51, 52

**Fjalori,** 80

**Fryma e Shenjtë,** 41, 46

**Gjykimi,** 56

**Historia e Kishës,** 64, 66

**Integriteti moral,** 12, 51

**Jezu Krishti,** 7, 76

**Krijimi,** 7

**Mek-Kei, Dejvid O.,** 81

**Miqësia,** 39, 40, 72

**Paqja,** 34

**Pendimi,** 58

**Peshkopët,** 58

**Përgatitja,** 26

**Pionierët,** 64

**Predikoni Ungjillin Tim,**

42, 46, 54

**Priftëria,** 62, 76

**Profetët,** 67

**Puna misionare,** 20, 30, 40, 42, 46, 61, 70, 72

**Rrëfimi,** 58

**Standardet,** 56, 80

**Synimet,** 12, 54

**Shembulli,** 12, 56

**Shëndeti,** 9, 52

**Tempulli,** 18, 34

**Tundimi,** 51, 80

**Zbulesa,** 67



Nga Presidenti  
Tomas S. Monson

# PËRGJEGJËSIA JONË PËR T'I Shpëtuar

**P**ër shenjtorët e ditëve të mëvonshme, nevoja për t'i shpëtuar vëllezërit dhe motrat tona që, për njëfarë arsye, janë larguar nga shtegu i aktivitetit të Kishës, është me rëndësi të përjetshme. A njohim njerëz të tillë që dikur e përqaftuan ungjillin? Nëse po, cila është përgjegjësia jonë për t'i shpëtuar ata?

Merrni parasysh të humburit mes njerëzve të moshuar, të ve dhe të sëmurë. Shumë shpesh ata gjenden në shkretëtirën fërgëlluese dhe të braktisur të izolimit të quajtur vetmi. Kur rinia largohet, kur shëndeti pakësohet, kur gjallëria venitet, kur drita e shpresës ndriçon gjithmonë e më zbehtë, ata mund të ndihmohen dhe të mbështeten nga dora që ndihmon dhe zemra që njeh dhembshuri.

Ka, sigurisht, të tjerë që kanë nevojë të shpëtohen. Disa ndeshen me mëkat, ndërsa të tjerë enden në frikë apo plogështi ose padituri. Për çfarëdo arsye, ata e kanë izoluar vetveten nga aktiviteti në Kishë. Dhe pothuajse në mënyrë të sigurt ata do të mbeten të humbur, në qoftë se nuk zgjohet brenda nesh – anëtarëve aktivë të Kishës – një dëshirë për t'i ndihmuar dhe shpëtuar.

## Dikush që të Tregojë Udhën

Ca kohë më parë mora një letër të shkruar nga një burrë i cili ishte larguar nga Kisha. Ajo është tipike për shumë prej anëtarëve tanë. Pasi përshkroi se si ishte bërë joaktiv, ai shkroi:

“Pata kaq shumë dhe tani kam kaq pak. Nuk jam i lumtur dhe ndihem sikur po dështoj në gjithçka. Ungjilli nuk është larguar kurrë nga zemra ime, edhe pse ai e ka lënë jetën time. Kërkoj lutjet tuaja.

Ju lutem, mos i harroni ata prej nesh që janë këtu jashtë – shenjtorët e humbur të ditëve të mëvonshme. E di se ku është Kisha, por nganjëherë mendoj se kam nevojë që dikush tjetër të ma tregojë udhën, të më nxisë, të ma largojë frikën dhe të më japë dëshmi.”

Teksa po e lexoja këtë letër, mendimet e mia u kthyen te një vizitë që bëra në një nga galeritë madhështore të artit të botës – në Muzeun e famshëm Viktoria dhe Alberti në Londër në Angli. Atje, e vënë në kornizë në mënyrë shumë të këndshme, është një kryevepër e pikturuar nga Xhozef Mallord Uilliam Tërnër. Piktura paraqet re të zeza të ngarkuara rëndë dhe furinë e një deti të turbulluar, duke paralajmëruar rrezik dhe vdekje. Një dritë nga një anije e përplasur pas shkëmbinjve shkëlqen në largësi. Në planin e parë, e shtyrë lart nga valët që janë duke u afruar me ujë të shkumbuar, është një varkë e madhe shpëtimi. Burrat tërheqin fuqishëm lopatat, ndërkohë që varka e shpëtimit zhytet në stuhinë. Në bregdet qëndron një grua dhe dy fëmijë, të lagur nga shiu dhe të fshikulluar nga era. Ata shohin me shqetësim drejt detit. Në mendjen time e shkurtova titullin e asaj pikturë. Për mua ai u bë *Drejt Shpëtimit*.<sup>1</sup>

Përmes stuhive të jetës, rreziku rri i fshehur. Burra dhe gra, djem e vajza e gjejnë vetveten të përplasur pas vështirësive dhe duke hasur shkatërrim. Kush do t'ua rrëfejë udhën varkave të shpëtimit, duke lënë pas rehatitë e shtëpisë dhe familjen, dhe do të shkojë drejt shpëtimit?

Detyra jonë nuk është e pakapërcyeshme. Ne jemi duke bërë detyrën e Zotit; ne na takon ndihma e Tij.

Gjatë shërbesës së Mësuesit, Ai thirri peshkatarë në Galile për t'i lënë rrjetat e tyre dhe për ta ndjekur Atë, duke



pak aktivë që presin të shpëtohen nga ata që drejtojnë barkat e shpëtimit. Zemrat e tyre mezi e presin ndihmën. Nënata dhe baballarët luten për bijtë dhe bijat e tyre. Bashkëshortet e përgjerohen qiellit që bashkëshortet e tyre të mund të ndihmohen. Nganjëherë fëmijët luten për prindërit e tyre.

Është lutja ime që ne të mund të kemi dëshirë për t'i shpëtuar anëtarët më pak aktivë dhe për t'i kthyer ata te gëzimi i ungjillit të Jezu Krishtit, që ata të mund të marrin pjesë me ne në gjithçka që shoqërimi i plotë ka për të ofruar.

Ndihmofshim për t'i shpëtuar të humburit që na rrethojnë: njerëzit e moshuar, të ve, të sëmurë, ata me pa aftësi, më pak aktivët dhe ata që nuk po i zbatojnë urdhërimet. U shtrifshim atyre dorën që ndihmon dhe zemrën që njeh dhembshuri. Duke e bërë këtë, ne vërtet do t'u sjellim gëzim zemrave të tyre dhe ne vërtet do të përjetojmë kënaqësinë e thellë që na vjen kur ndihmojmë së bashku përgjatë shtegut të jetës së përjetshme. ■

#### SHËNIME

1. Titulli i plotë i pikturës është *Varka e Shpëtimit dhe Grupi Njerëzor Duke Shkuar Drejt një Anijeje të Përplasur te Shkëmbinjtë që Jep Sinjalin e Rrezikut (Dritat Blu)*.
2. Mateu 4:19.
3. Efesianëve 2:19.
4. Shih Mateu 22:39.

shpallur: “Unë do t’ju bëj peshkatarë njerëzish”<sup>2</sup>. U bashkofshim me radhët e peshkatarëve të burrave dhe të grave, që ne të mund të japim çfarëdo ndihme që mundemi.

E jona është detyra për t’i ndihmuar që të shpëtohen ata që janë larguar nga siguria e aktivitetit, që ata të mund të sillen tek tryeza e Zotit për t’u ushqyer me bollëk me fjalën e Tij, për të gëzuar shoqërimin e Shpirtit e Tij dhe për të “[mos qenë] më të huaj, as bujtës, por bashkëqytetarë të shenjtorëve dhe pjestarë të familjes së Perëndisë”<sup>3</sup>.

#### Parimi i Dashurisë

Kam gjetur se dy arsye thelbësore konsiderohen gjerësisht për një kthim në aktivitet dhe për ndryshime të sjelljeve, zakoneve dhe veprimeve. Së pari, individët kthehen ngaqë dikush u ka treguar atyre mundësitë e tyre të përjetshme dhe i ka ndihmuar ata të vendosin t’i arrijnë ato. Anëtarët më pak aktivë nuk mund të mbeten për shumë kohë të kënaqur

me mediokritetin pasi e kuptojnë se përsosmëria është e mundshme për t’u arritur.

Së dyti, të tjerët kthehen ngaqë njerëz të dashur ose “bashkëqytetarë të shenjtorëve” e kanë ndjekur këshillimin e Shpëtimtarit, i kanë dashur fqinjët e tyre porsivetveten<sup>4</sup> dhe i kanë ndihmuar të tjerët t’i çojnë ëndrrat e tyre drejt përmbushjes dhe ambiciet e tyre drejt realizimit.

Katalizatori në këtë proces ka qenë – dhe do të vazhdojë të jetë – parimi i dashurisë.

Në një kuptim shumë real, ata njerëz të përplasur në detin e pështjelluar nga stuhia në pikturën e Tërnerit, janë si shumë prej anëtarëve tanë më

#### MËSIMDHËNIA NGA KY MESAZH

**M**errni parasysh t’i pyesni njerëzit që vizitoni nëse njohin dikë që po has vështirësi për të ardhur në kishë. Ju mund të zgjidhni një njeri dhe të diskutoni rreth mënyrave se si të tregoni dashuri, të tillë si ta ftoni atë që të marrë pjesë në një mbrëmje familjare ose që të vijë për të ngrënë me ju.

## Dhurata e Xhenit

Nga Xhosi S. Kilpak

Unë bëra një varg zgjedhjesh të gabuara gjatë vitit të dytë të shkollës së mesme. Ato zgjedhje çuan në pasoja të rënda dhe humbje të lumturisë dhe vendosa ta përdorja pushimin e verës për të filluar bërjen e ndryshimeve. Kur shkolla filloi përsëri, unë e hëngra drekën në banjo ose në ndonjë korridor të zbrazët për t’iu shmangur marrëdhënieve të këqija që prisnin të më ftonin përsëri.

Nuk isha ndier kurrë kaq e vetmuar.

Atëherë Perëndia më dha një dhuratë: Ai më dërgoi Xhenin. Ajo kurrë nuk më gjykoj për mëkatet e mia, por përkundrazi, më nxiti që të vazhdoja të lëvizja në drejtimin

e duhur. Dija se ajo do të ishte në shkollë, më ndihmoi të vazhdoja t’i lexoja shkrimet e mia të shenjta dhe ta ushqeja shpirtërisht dëshminë time. Kur erdhi koha për marrjen e diplomës, ia kisha vërtetuar vetes se isha e zotuar të ndryshoja.

Vras mendjen nganjëherë se ku do të isha sot nëse Xheni nuk do të më kishte ndihmuar. A mund t’u kisha qëndruar parimeve të mia pa të? Për fat të mirë, nuk do ta di asnjëherë, sepse ajo ishte atje me gjithë zemër, gati dhe plot dëshirë për të më ndihmuar.

Autorja jeton në Jutá, SHBA.

## FËMIJËT

### Mënyra për të Shpëtuar

Presidenti Tomas S. Monson na mëson se ne duhet t’i ndihmojmë të tjerët, duke përfshirë njerëzit e mosuar, të ve, të sëmurë, më pak aktivë dhe ata që kanë

nevojë për më shumë ndihmë. I shihni fotografitë më poshtë dhe i qarkoni ato që tregojnë diçka që mund të bëni për t’i ndihmuar të tjerët.



Në rreshtat më poshtë, shkruani disa mënyra se si mund t’i ndihmoni të tjerët. Ju mund t’i përdoni fotografitë për ide.

---



---



---



---



Studiojeni këtë material plot lutje dhe kërkoni të dini se çfarë të ndani me motrat që vizitoni. Në ç'mënyrë kuptueshmëria për jetën dhe misionin e Shpëtimtarit do ta rrisë besimin tuaj tek Ai dhe do të bekojë ato mbi të cilat vëzhgoni? Për më tepër informacion, shkoni te [reliefsociety.lds.org](http://reliefsociety.lds.org).

## Misioni Hyjnor i Jezu Krishtit: Krijuesi

Ky është mesazhi i parë në një seri Mesazhesh të Vizitave Mësimore që paraqesin aspekte të misionit të Shpëtimtarit.


Jezu Krishti “krijo[i] qiejt dhe tokën” (3 Nefi 9:15). Ai e bëri këtë nëpërmjet fuqisë së priftërisë, nën drejtimin e Atit tonë Qiellor (shih Moisiu 1:33).

“Sa mirënjohës duhet të jemi që një Krijues i urtë i dha formë tokës dhe na solli këtu”, tha Presidenti Tomas S. Monson, “. . . që të përjetojmë një periudhë prove, një mundësi për të provuar veten që të mund të kualifikohemi për gjithçka që Perëndia ka përgatitur për ne që të marrim.”<sup>1</sup> Kur e përdorim lirinë tonë të zgjedhjes për t’iu bindur urdhërimeve të Perëndisë dhe për t’u penduar, ne bëhemi të denjë për t’u kthyer që të jetojmë me Të.

Për Krijimin, Presidenti Diter F. Uhtdorf, Këshilltari i Dytë në Presidencën e Parë, tha:

“Ne jemi arsyeja pse Ai krijoi universin! . . .

Ky është një paradoks i njeriut: krahasuar me Perëndinë, njeriu është hiç; por ende ne jemi gjithçka për Perëndinë.”<sup>2</sup> Dija se Jezu Krishti krijoi



tokën për ne, sepse ne jemi gjithçka për Atin Qiellor, mund të na ndihmojë të shtojmë dashurinë tonë për Ta.

### Nga Shkrimet e Shenjta

Gjoni 1:3; Hebrejve 1:1–2; Mosia 3:8; Moisiu 1:30–33, 35–39; Abraham 3:24–25

#### SHËNIME

1. Tomas S. Monson, “Vrapimi i Jetës”, *Liahona*, maj 2012, f. 91.
2. Diter F. Uhtdorf, “Ju Keni Rëndësi për Të”, *Liahona*, nëntor 2011, f. 20.
3. Joseph Smith, në *Daughters in My Kingdom: The History and Work of Relief Society* (2011), f. 171.
4. *Daughters in My Kingdom*, f. 171.
5. Joseph Smith, në *Daughters in My Kingdom*, f. 169.

Besim, Familje, Ndhimë



### Nga Historia Jonë

Ne jemi krijuar sipas shëmbëll-tyrës së Perëndisë (shih Moisiu 2:26–27) dhe kemi potencial hyjnor. Profeti Jozef Smith i këshilloi motrat në Shoqatën e Ndhimës që të “jetonin sipas privilegjit [të tyre]”<sup>3</sup>. Me atë nxitje si themel, motrat e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme janë mësuar që të jetojnë sipas potencialit të tyre hyjnor duke përbushur qëllimet e Perëndisë për to. “Kur arrijnë të kuptojnë se cilat janë me të vërtetë – bija të Perëndisë, me një aftësi të brendshme për të dashur dhe për të ushqyer shpirtërisht – ato e arrijnë potencialin e tyre si gra të shenjta.”<sup>4</sup>

“Ju vendoseni tani në një gjendje ku mund të vepronin në përputhje me ato mirëkuptime që Perëndia i ka mbjellë në kraharorin tuaj”, tha Profeti Jozef Smith. “Nëse jetoni denjësisht sipas këtyre parimeve, sa gjë e madhërishtme dhe e lavdishme! – Nëse jetoni sipas privilegjit tuaj, engjëjt nuk do të ngurrojnë të bëhen shoqëruarit tuaj.”<sup>5</sup>

### ÇFARË MUND TË BËJ UNË?

1. Si e rrit dashurinë tonë për Shpëtimtarin synimi për të kuptuar natyrën tonë hyjnore?
2. Si mund ta shfaqim dashurinë tonë për krijesat e Perëndisë?

# IDE PËR KONFERENCËN E PËRGJITHSHME

Nga Tina Spenser



## “E Gjen Dot Kush po Vjen për Darkë?”

Pesëmbëdhjetë ditë përpara fillimit të çdo konference të përgjithshme, familja jonë var shenjën tonë duke shpalluar fillimin e “E Gjen Dot Kush po Vjen për Darkë?” Më pas shtojmë fotografitë më të fundit të profetëve, shikuesve dhe zbuluesve tanë nga botimi i konferencës së mëparshme në revistat e Kishës.

Unë përgatitem duke bërë kërkime për profetin që do ta mirëpresim atë natë. Nganjëherë gjej objekte përreth shtëpisë për të përfaqësuar disa gjëra që kam mësuar, dhe i vendos ato në një pjatë. Gjatë darkës, ndërsa tregoj histori rreth secilit objekt, çdonjëri përpriqet të gjejë se cili është i ftuari. Herë të tjera, unë tregoj një ose dy histori që profeti i tregoi gjatë konferencës së përgjithshme të mëparshme.

Mahnitem me gjërat që fëmijët e mi i mbajnë mend rreth profetëve dhe apostujve tanë të dashur dhe unë e di se kjo lojë e thjeshtë e ka rritur gjithashtu dashurinë dhe dijen time për këta burra të madhërisëm.

## Kopja Ime e Konferencës

Kur Plaku Nil L. Andersen, i Kuumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dhe gruaja e tij, Kathi, na vizituan gjatë konferencës tonë të kunjit, motra Andersen tregoi një histori për ne. Ajo tha se kur jetuan në Francë, ajo bëri kopje të bisedave të konferencës për secilin nga fëmijët e tyre – edhe për të vegjlit fare. U trondit shumë kur mësoi çmimin e fotokopjeve, që ishte shumë i shtrenjtë. Atëherë mendimi i erdhi në mendje: “Çfarë vlere ka për ty që familja jote të ketë fjalët e profetëve?”

Kjo histori më preku me të vërtetë

dhe u sigurova që çdonjëri në familjen tonë të kishte kopjen e tij ose të saj të bisedave të konferencës. Bijat tona u kënaqën shumë. Ne i përdorëm ato për mbrëmje familjare dhe gjatë studimit të shkrimeve të shenjta. U gëzova shumë të shihja një bijë duke i lexuar bisedat vetë dhe duke i shënuar ato me nënvizime me lapsa me ngjyrë. Një bijë tjetër, e pagëzuar kohët e fundit, m’u lut që të lexoja biseda veçmas me të.

## Sfida e Konferencës

Si pjesë e mësimit tim në Shoqatën e Ndihmës, i dhashë një sfidë secilës motër për të rishikuar bisedat nga konferenca e mëparshme; disa motra i rilexuan bisedat, të tjera i panë ato në internet. Shumë motra shprehën se ato u ndien shumë më të përgatitura për konferencën e ardhshme. ■

Autorja jeton në Uashington, SHBA.

# SHËNDETI FIZIK DHE EMOCIONAL

Për disa të rinj, dështimi për zbatimin e parimeve të shëndetit fizik mund të bëhet një pengesë e madhe në bërjen e miqve dhe në ndërtimin e besimit të vetja. Megjithatë, shëndeti fizik dhe emocional janë të rëndësishëm, por shpesh, edhe aspekte pak të zhvilluara të përgatitjes për të shërbyer një mision. Në faqet 52–53 të këtij botimi, Plaku Adrián Oçoa, i Të Shtatëdhjetëve, diskuton për mënyrën se si përkujdesja për trupat tanë mund të na e mbrojë shëndetin tonë fizik dhe emocional. Ai na kujton të bëjmë ushtrime fizike dhe t'i bindemi Fjalës së Urtësisë (shih DeB 89) kështu që ne do të jemi vërtet më të shëndetshëm dhe më të lumtur. Kur i ndihmoni fëmijët tuaj të mësojnë dhe t'i zbatojnë parimet e shëndetit fizik dhe emocional, ata do të jenë të aftë ta rrisin besimin e tyre të vetja dhe të përgatiten për shërbime të ardhshme.

Siç thotë Plaku Oçoa: “Kujdesi për trupin tuaj gjithashtu e bekon mendjen tuaj dhe ju ndihmon të kujtoni se ju jeni një fëmijë i Perëndisë dhe mund të keni besim të vetja dhe të jeni i lumtur. Anët tona emocionale, fizike dhe shpirtërore të gjitha lidhen së bashku.”

## Sugjerime për t'i Dhënë Mësim Rinisë

- Lexojeni artikullin e Plakut Oçoa së bashku dhe zhvilloni një plan

ushtrimesh fizike si familje me synime të përcaktuara, realiste për shëndetin fizik.

- Me fëmijët tuaj adoleshentë, lexoni pjesën e shëndetit fizik dhe emocional në broshurën *Për Forcën e Rinisë* (faqet 25–27). Diskutoni rreth asaj që do të thotë të jesh i shëndetshëm emocionalisht.
- Këndoni së bashku “Though Deepening Trials [Dhe Mes Shqetsimit]” (*Hymns*, nr. 122) dhe diskutoni atë që ringjallja na mëson rreth rëndësisë së trupave tanë fizikë.
- Studioni shkrimet e shenjta të renditura në këtë artikull dhe diskutoni se çfarë na mësojnë ato rreth shëndetit fizik dhe emocional.

## Sugjerime për t'u Dhënë Mësim Fëmijëve

- I tregoni fëmijës suaj një fotografi të një tempulli. Diskutoni se çfarë do të thotë kur Apostulli Pal na mëson se trupat tanë janë “tempulli i Frymës së Shenjtë” (1 Korintasve 6:19) dhe se si kjo njohuri mund të na ndihmojë të kujdesemi për trupat dhe mendjet tona.
- Bëni një listë të veprimtarive të shëndetshme sportive që fëmija juaj do të donte të bënte me



## SHKRIME TË SHENJTA PËRKATËSE

Fjalët e Urta 16:32

Danieli 1:3–20

Lluka 21:19

Romakëve 12:1–2

1 Korintasve 6:19–20

1 Thesalonikasve 5:14

Alma 38:12; 53:20

Doktrina e Besëlidhje  
88:15; 89

familjen. Më pas krijoni një plan për mënyrën se si t'i bëni këto veprimtari pjesë të jetës familjare.

- Diskutoni rreth mënyrave për t'i kuptuar dhe kontrolluar emocionet, duke përfshirë zemërimin ose trishtimin. Këndoni “If You’re Happy” [“Nëse Je i Lumtur”] (*Children’s Songbook*, f. 266), “I’m Trying to Be Like Jesus” [“Po Përpiqem të Jem si Jezusi”] (*Children’s Songbook*, f. 78) ose një këngë tjetër rreth emocioneve dhe bërjes së zgjedhjeve të mira. ■

# LAJME TË KISHËS

Vizitoni [news.lds.org](http://news.lds.org) për lajme dhe ngjarje të tjera të Kishës.

## Anëtarët Mund të Kërkojnë Hierarkinë e Autoritetit të Priftërisë

**Nga Rajën Morgeneg**

*Lajme të Kishës*

**K**isha tani mund të sigurojë, sipas kërkesës, informacion mbi hierarkinë e autoritetit të priftërisë si një shërbim ndaj anëtarëve. Hierarkia e autoritetit të priftërisë është një strukturë vijuese e ordinancave që mund të ndiqen deri në fillimet e hershme të Kishës dhe, së fundi, te Shpëtimtari.

Edhe pse një mbajtës i priftërisë me detyrën si I Shtatëdhjetë mund të përfshihet në hierarkinë personale të autoritetit të një anëtari, nuk mbahet një hierarki e veçantë autoriteti për detyrën si I Shtatëdhjetë. Gjithashtu, hierarkia e autoritetit të priftërisë për peshkopët dhe patriarkët e shuguruar, gjurmohet nëpërmjet shugurimit të tyre si priftërinj të lartë.

Mund të kërkohet nga Kisha vetëm informacioni mbi hierarkinë e autoritetit të Priftërisë Melkizedeke; hierarkia e Priftërisë Aarone nuk është e disponueshme. Anëtarët mund të kërkojnë informacion mbi hierarkinë e autoritetit të Priftërisë Melkizedeke vetëm për vete, për një fëmijë që kanë në shtëpi, ose për një misionar të ri që aktualisht po shërben. Këto shkresa nuk janë dokumente zyrtare të Kishës.

Nëse ju dëshironi të kërkonit hierarkinë tuaj të

autoritetit të priftërisë, përfshini emrin tuaj të plotë zyrtar, datën e lindjes, numrin tuaj të dokumentit të anëtarësisë (i disponueshëm në rekomandimin e tempullit ose nga nëpunësi juaj i lagjes), emrin e personit që ju shuguroi juve në detyrën e plakut ose të priftit të lartë (nëse dihet) si dhe adresën për përgjigje dhe numrin e telefonit ose adresën e postës elektronike.

Dërgojeni kërkesën tuaj në:

Priesthood Line of Authority [Hierarkia e Autoritetit të Priftërisë]

Global Service Center

120 North 200 West

Salt Lake City, Utah 84103-1514, USA

Faks: 1-801-240-6816

Telefon: 1-800-453-3860,

numri i brendshëm 2-3500

Posta Elektronike: Dërgoni një mesazh elektronik te [lineofauthority@ldschurch.org](mailto:lineofauthority@ldschurch.org) me "PLA" te reshti i lëndës. Do të merrni si përgjigje një formular për ta plotësuar dhe për ta dërguar sërish (ka një përgjigje automatike për çfarëdo mesazhi që përmban "PLA" te reshti i lëndës). ■



*Hierarkia e autoritetit të priftërisë për ata që kryejnë ordinancë, mund të gjurmohet pas deri te Shpëtimtari.*



**Kërcimtarë dhe admirues formojnë numrin "20" gjatë një shfaqjeje të dhënë për të përkujtuar përvjetorin e 20-të të Kishës në Mongoli.**

### Mongolia Feston 20-Vjetorin e Kishës

Të hënën, më 15 prill 2013, më shumë se 300 anëtarë të Kishës u mbledhën në Zaisan Hill në Ulan-Bator të Mongolisë, për të festuar përvjetorin e 20-të të Kishës në atë vend. Këndoi një kor i përbërë prej 50 anëtarësh dhe grupi dëgjoi një regjistrim të Plakut Nil A. Maksuell (1926–2004) ndërsa ai përkushtoi Mongolinë për predikimin e ungjillit në vitin 1993.

Plaku Tai Kuok Yuen, ish-anëtar i Presidencës së Zonës së Azisë, që shoqëroi Plakun Maksuell në Mongoli në vitin 1993, vërejtë si si "duart e Zotit kanë lëvizur pa pushim në këtë pjesë të vreshtit të Tij".

Një larmi aktiviteteve gjatë gjithë javës shënuan përvjetorin. Një mbledhje ritakimi e misionit mbledhi 200 misionarë të kthyer. Më shumë se 1.000 mongolë kanë shërbyer si misionarë kohëplotë – thujse 1 në çdo 10 anëtarë në Mongoli. Shërbimi pagëzimi u mbajtën në mbarë Mongolinë mbrëmjen e së premtes; 24 vetë u pagëzuan atë ditë. Meri N. Kuk, e liruuar së fundi nga presidenca e përgjithshme e Të Rejave, foli në një takim shpirtëror të Të Rejave dhe një shtëpi e hapur për historinë familjare shfaqti një video me udhëzime për projektin e ri Family Tree [Trungu Familjar].

Një shfaqje kulturore fantastike paraqiti kulturën e pasur të Mongolisë dhe talentet e shumë anëtarëve të Kishës.

### Shenjtore të Ditëve të Mëvonshme në Haiti Festojnë Përvjetorin, Ndihmojnë të Mbillen Pemë

Më 1 maj 2013, anëtarë të Kishës në Haiti morën pjesë në një projekt të madh e mbarëkombëtar për mbjellje pemësh. Dhjetëra fidanë u mbollën në ditën e parë të projektit dhe shumë të tjerë do të vijnë. Kur projekti të përfundojë, rreth 400.000 pemë të reja do të rriten në Haiti, përfshirë limona, portokalle, arra kokosi, papaja dhe lisa.

Kisha i bleu pemët si pjesë e mbështetjes së saj të vazhdueshme për rigjenerimin e Haitit pas tërmetit. Projekti gjithashtu u siguroi anëtarëve një projekt shërbimi për të festuar 30-vjetorin e Kishës në këtë komb ishullor. Tri dekada më parë, Presidenti Tomas S. Monson, në atë kohë anëtar i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, e vizitoi Haitin dhe përkushtoi tokën për predikimin e ungjillit të rivendosur.

Plaku Nil L. Andersen, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, ishte i pranishëm në Haiti në kohën e festimit të përvjetorit

dhe kryesoi në zbulimin e një pllake përkujtuese që shënon fillimet e Kishës në Haiti.

### Kisha i Dhuron më Shumë se Katërqind e Pesëdhjetë Ton Ushqime Organizatës "Feeding America"

Në maj 2013 Kisha, nëpërmjet organit të saj për ndihma humanitare Latter-day Saint Charities [Bamirësia e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme], i dhuroi më shumë se katërqind e pesëdhjetë ton ushqime organizatës "Feeding America" ["Ushqim për Amerikën"], organizata më e madhe jofitimprurëse e ndihmës kundër urisë në Shtetet e Bashkuara. Dhurimi përfshinte artikuj të konservuar të tillë si fruta, perime dhe fasule, të cilat do t'u shpërndahen familjeve në nevojë nëpërmjet depove ushqimore dhe strehëve të ndryshme të komuniteteve nëpër Shtetet e Bashkuara.

Bob Aiken, president dhe drejtuesi më i lartë ekzekutiv i organizatës "Feeding America", tha se dhurimi do të sigurojë rreth 625.000 vakte ushqimore.

### Misionarë dhe anëtarë në Haiti mbjellin pemë në male lart pranë kryeqytetit Port-o-Prens, që mund të shihet në sfond.



FOTOGRAFI IGA JASON SWENSEN



**Nga Plaku**  
**Kuentin L. Kuk,**  
i Kuorumit të  
Dymbëdhjetë Apostujve

**P**residenti Dejvid O. Mek-Kei (1873–1970) shpesh tregoi një ngjarje që ndodhi ndërsa ai ishte misionar duke shërbyer në Skoci. Atë po e mernte malli për shtëpinë pas një kohe shumë të shkurtër që kishte qenë në mision dhe kaloi disa orë duke shëtitur në afërsi të kështjellës Stirling. Kur ai dhe shoku i tij u kthyen nga vizita në kështjellë, ata kaluan pranë një ndërtese ku guri mbi derë kishte një mbishkrim të gdhendur të një citimi, zakonisht i njohur si i thënë prej Shekspirit, ku lexohej: “Pavarësisht se Kush Je, Luaje Mirë Rolin Tënd”.

Duke e kujtuar këtë përvojë, Presidenti Mek-Kei shpjegoi: “I thashë vetes, ose Shpirtit, brenda meje: “Ti je anëtar i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të



**LUAJENI  
MIRË  
ROLIN  
TUAJ**

*Jini të drejtë. Krijoni një familje. Gjeni një mënyrë të përshtatshme për të siguruar të ardhura. Shërbeni sipas thirrjeve. Përgatituni që të takoni Perëndinë.*



Mëvonshme. Më shumë se kaq, ti je këtu si përfaqësues i Zotit Jezu Krisht. Ti e pranove përgjegjësinë si një përfaqësues i Kishës.’ Pastaj mendova [rreth] asaj që ne kishim bërë atë paradite. Ne kishim qenë duke shëtitur; ne kishim marrë udhëzim dhe informacion historik, kjo është e vërtetë, dhe unë isha i ngazëllyer për këtë. . . . Megjithatë, kjo nuk ishte punë misionare. . . . E pranova mesazhin që m’u dha nga ai gur dhe që nga ai çast ne u përpoqëm të bënim pjesën tonë si misionarë në Skoci.”<sup>1</sup>

Ky mesazh ishte shumë i rëndësishëm dhe pati një ndikim të tillë mbi të sa Presidenti Mek-Kei e përdori atë si frymëzim gjatë gjithë jetës së tij. Ai vendosi se çfarëdoj përgjegjësie të kishte, ai do të bënte më të mirën e tij.

### **Shmangni të Vepruarit Duke Dalë Jashtë Karakterit**

Duke marrë parasysh potencialin e pamasë për të mirë që zotëroni ju të brezit më të ri të Kishës, cilat janë shqetësimet e mia për të ardhmen tuaj? Çfarë këshillash mund t’ju jap? Së pari, ju do të ndesheni me shtypje të madhe që të veproni duke dalë jashtë karakterit – madje që të vini një maskë – dhe të bëheni dikush që nuk e pasqyron me të vërtetë atë që jeni apo atë që dëshironi të bëheni.

Në historinë e hershme të Kishës, Profeti Jozef, Ema dhe binjakët e tyre 11-muajsh, Jozefi dhe Xhulia, ishin në Hajrëm të Ohajos, në shtëpinë e Xhon dhe Elis Xhonsonit. Të dy fëmijët po vuanin nga fruthi. Jozefi dhe biri i tij i vogël po flinin në një shtrat rezervë pranë derës kryesore.

Gjatë natës një grup burrash me fytyra të lyera me të zeze e shpërthyen derën dhe e tërhoqën zvarrë Profetin deri jashtë, ku e rrahën dhe u hodhën përsipër zift atij dhe Sidni Rigdonit.

Pjesa më tragjike e këtij sulmi nga turma ishte se Jozefi i vogël u gjend në ajrin e natës

dhe mori një të ftohtë të rëndë, kur të atin e tij e tërhoqën zvarrë jashtë. Për pasojë, ai vdiq pak ditë më vonë.<sup>2</sup>

Ata që morën pjesë në Martirizimin e Profetit dhe të vëllait të tij, Hajrëmit, gjithashtu i lyen fytyrat e tyre për ta fshehur identitetin e tyre të vërtetë.<sup>3</sup>

Në kohën tonë, kur të jesh anonim është më e lehtë se kurrë, ka parime të rëndësishme që përfshihen në mosmbajtjen e një maske dhe në të qenit “të vërtetë ndaj besimit . . . për të cilin kanë vdekur martirët”<sup>4</sup>.

Një nga mbrojtjet tuaja më të mira kundër të bërit të



**Plaku L. Tom Peri e luajti mirë rolin e tij ndërsa ndodhej në Japoni.**

zgjedhjeve të gabuara, është të mos vini asnjë maskë anonimiteti. Nëse ndonjëherë e gjeni veten duke dëshiruar të bëni kështu, lutem ta dini se është një shenjë serioze rreziku dhe një nga mjetet e kundërshtarit që t’ju shtyjë të bëni diçka që nuk duhet ta bëni.

Është e zakonshme sot që dikush ta fshehtë identitetin kur shkruan shkrime plot urrejtje, sarkastike, fanatike në mënyrë anonime në internet. Disa e quajnë këtë *zjarrvënie*.

Apostulli Pal tha:

“Mos u gënjeni; shoqëritë e këqija prishin zakonet e mira.

Zgjuhoni për drejtësinë dhe mos mëkatoni; sepse disa nga ju nuk e njohin Perëndinë” (1 Korintasve 15:33–34).

Është e qartë se komunikimet e liga nuk janë thjesht çështje të sjelljeve të këqija. Nëse praktikohen nga

shenjtorët e ditëve të mëvonshme, mund të ndikojnë për keq ata që nuk kanë njohuri për Perëndinë apo një dëshmi për Shpëtimtarin.

Çdo përdorim i internetit për të përqeshur, për të shkatërruar emrin e mirë të dikujt apo për ta bërë dikë të duket keq, është i dënueshëm. Ajo që po shohim në shoqëri është se, kur njerëzit mbajnë maskën e anonimisë, ka më shumë mundësi që ata të përfshihen në këtë lloj sjelljeje, që është kaq shkatërruese ndaj diskutimit civil. Ajo gjithashtu shkel parimet bazë që na mësoi Shpëtimtari.

Shpëtimtari shpjegoi se Ai nuk kishte ardhur për ta dënuar botën, por për ta shpëtuar botën. Ai më pas përshkroi se çfarë domethënie ka gjykimi:

“Tani gjykimi është ky se drita erdhi në botë dhe njerëzit deshën errësirën më tepër se dritën, sepse veprat e tyre ishin të mbrapshta.

Sepse kushdo që bën gjëra të mbrapshta e urren dritën dhe nuk vjen te drita, që të mos zbulohen veprat e tij.

Por kush bën të vërtetën vjen te drita, që veprat e tij të zbulohen, sepse u bënë në Perëndinë” (Gjoni 3:19–21; shih edhe vargjet 17–18).

Të drejtët nuk kanë nevojë që të mbajnë maska për të fshehur identitetin e tyre.


### **Veproni në Përputhje me Bindjet Tuaja të Vërteta**

Ju veproni në përputhje me bindjet tuaja të vërteta duke e kaluar kohën tuaj me ato gjëra që do ta ndërtojnë e zhvillojnë karakterin tuaj dhe do t’ju ndihmojnë të bëheni më shumë si Krishti. Unë shpresoj që asnjëri prej jush të mos e shohë jetën kryesisht si zbatimje dhe lojëra, por në vend të kësaj, si një kohë “që të përgatiten[i] të takohen[i] me Perëndinë” (Alma 34:32).

Një shembull i mrekullueshëm i bërjes së pjesës suaj dhe përdorimit të kohës siç duhet, vjen nga jeta e Plakut L. Tom Peri, të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, kur, si pjesëtar i marinsve, ai ishte pjesë e trupave pushtuese të Shteteve të Bashkuara në Japoni në mbarimin e Luftës II Botërore. Plaku Peri e tregoi këtë ngjarje kur ai shënoi dëshminë e tij të veçantë për Shpëtimtarin.

“Unë isha mes grupit të parë të marinsave që zbarkuan në Japoni pas nënshkrimit të traktatit të paqes pas Luftës II Botërore. Kur hymë në qytetin e shkretuar të Nagasakit, pata një nga përvojat më të trishtuara të jetës sime. Një





*Një nga mbrojtjet tuaja  
më të mira kundër  
të bërit të zgjedhjeve  
të gabuara, është të  
mos vini asnjë maskë  
anonimiteti.*

pjesë e madhe e qytetit ishte shkatërruar tërësisht. Disa nga të vdekurit nuk ishin varrosur ende. Si trupa pushtuese, ne ngritëm selitë tona dhe iu futëm punës.

Gjendja që shumë e vrerët dhe disa prej nesh dëshironin të jepnin më shumë. Ne shkuam tek kapelani i divizionit tonë dhe kërkua leje që të ndihmonim për të rindërtuar kishat e krishtera. Për shkak të kufizimeve qeveritare gjatë luftës, këto kisha thuajse kishin pushuar së funksionuari. Ndërtesat e tyre të pakta qenë dëmtuar keqas. Një grup prej nesh dolëm vullnetarë që t'i riparanim dhe suvatanim këto godina kishtare gjatë kohës sonë të lirë, kështu që ato të ishin të disponueshme për të kryer sërish shërbime të krishtera.

. . . Ne gjetëm shërbestarët që nuk kishin qenë në gjendje të shërbenin gjatë viteve të luftës, dhe i nxitëm ata që të ktheheshin tek foltoret e tyre. Ne patëm një përvojë të jashtëzakonshme me këta njerëz, ndërsa ata përjetuan sërish lirinë për t'i praktikuar besimet e tyre të krishtera.

Një ngjarje ndodhi kur po largoheshim nga Nagasaki për t'u kthyer në shtëpi, që unë vërtet do ta kujtoj gjithmonë. Ndërsa po hipnim në trenin që do të na çonte tek anijet për t'u kthyer në shtëpi, ne na tallën shumë prej marinsave të tjerë. Ata kishin të dashurat e tyre me vete dhe [po] u jepnin atyre lamtumirën. Ata u tallën me ne dhe na treguan se e kishim humbur zbavitjen e qëndrimit në Japoni. Ne thjesht e kishim çuar dëm kohën tonë duke punuar dhe duke suvatuar mure.

Pikërisht kur ata qenë në kulmin e talljeve të tyre, mbi një kodëz të vogël pranë stacionit të trenit erdhën rreth 200 prej këtyre japonezëve të shkëlqyer të krishterë nga kishat që ne kishim riparuar, duke kënduar 'Përpara, Ushhtarë të Krishterë'. Ata zbritën dhe na mbuluan me dhurata. Pastaj ata të gjithë u rreshtuan përgjatë shinave. Dhe ndërkohë që treni u nis nëpër shina, ne u zgjatëm dhe thjesht u prekëm gishtat ndërsa largoheshim. Nuk mund të flisnim; emocionet tona qenë tepër të fuqishme. Por ne ishim mirënjohës që mund të ndihmonim në ndonjë mënyrë të vogël për të rivendosur krishtërimin në një komb pas luftës."<sup>5</sup>

Ju lutem të meditonit dhe të merrni vendime të ndër-gjegjshme kur zgjidhni se si ta përdorni kohën tuaj. Siç mund ta shihni nga shembulli i Plakut Peri, unë nuk po flas për ta mbajtur fenë tuaj si flamur që ta shohin të tjerët apo të jeni besnikë në mënyrë sipërfaqësore. Ajo mund të

jetë turpëruese për ju dhe për Kishën. Unë po flas që ju të bëheni njeriu që duhet të jeni.

### **Vendosni Synime të Përshtatshme**

Këshilla ime e tretë lidhet me disa nga synimet që duhet të merrni parasysh. Pothuajse në të njëjtën kohë që Plaku Peri ishte në Japoni me marinsat, Presidenti Bojd K. Paker, Presidenti i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, shërbeu në Japoni me forcat ajrore në mbarimin e Luftës II Botërore.



**Presidenti Bojd K. Paker është bekuar për vendosjen e synimeve të drejta.**

Në vitin 2004, unë shoqërova Presidentin Paker dhe të tjerët në Japoni. Ai pati një mundësi për të ripërshkuar disa nga hapat e tij dhe për të menduar rreth disa përvojave e vendimeve që mori në atë kohë. Me lejen e tij, unë po ju tregoj disa nga mendimet dhe ndjenjat e tij.

Presidenti Paker përshkroi përvoja që ndodhën në një ishull pranë bregut të Okinauas. Ai e konsideron këtë si malin e tij në vendin e shkretë. Përgatitja e tij vetjake dhe takimi me anëtarë të tjerë e kishte thelluar besimin e tij në mësimet e ungjillit. Ajo që ende i mungonte, ishte vërtetimi – dija e sigurt e asaj që ai kishte arritur tashmë të dinte se që e vërtetë.

Shkruesi i biografisë së Presidentit Paker e përshkruan se ç'ndodhi: “Në kundërshtim me paqen e vërtetimit që

ai kërkoi, ai u gjend ballë për ballë me ferrin e luftës kundrejt të pafajshmëve. Duke kërkuar vetmi dhe kohë për të menduar, një ditë, ai u ngjiti te një kodër mbi oqean. Atje ai gjeti mbetjet e shkatërruara të një shtëpize fshati, fushën e braktisur me patate të ëmbla aty pranë. Dhe të shtrirë mes bimëve të thara, ai pa kufomat e një nëne të masakruar dhe të dy fëmijëve të saj. Pamja e mbushi me një trishtim të thellë, të përzier me ndjenjat e dashurisë për familjen e tij dhe për të gjitha familjet.<sup>6</sup>

Më pas ai u fut brenda një bunkerit të rastit ku mendoi, meditoi dhe u lut. Presidenti Paker, duke e kthyer mendjen te kjo ngjarje, përshkroi atë që unë do ta quaja një përvojë shpirtërore vërtetuese. Ai u ndje i frymëzuar në lidhje me atë që duhej të bënte me jetën e tij. Ai, sigurisht, nuk e kishte idenë se do të thirrej në thirrjen e lartë dhe të shenjtë që mban tani. Vegimi i tij ishte se ai dëshironte të bëhej mësues, për të theksuar mësimet e Shpëtimtarit. Ai mori vendim se do të jetonte një jetë të drejtë.

Ai e kuptoi në mënyrë mjaft të thellë se do t'i duhej të gjente një bashkëshorte të drejtë dhe se së bashku do të rrisnin një familje të madhe. Ky ushtar i ri e kuptoi se zgjedhja e tij për karrierë do t'i sillte përfitim të paktë dhe se shoqes së tij të ëmbël do t'i duhej të ndante të njëjtat përparësi dhe të ishte e gatshme të jetonte pa disa gjëra materiale. Motra Dona Paker ishte, dhe është, për Presidentin Paker, shoqja e përsosur. Ata nuk patën kurrë mjaft para të tepërta, por nuk u ndien të privuar në ndonjë mënyrë. Ata rritën 10 fëmijë dhe bënë sakrificë. Tani kanë 60 nipër e mbesa dhe më shumë se 80 stërnipër e stërmbesa.

Po jua tregoj këtë histori të vërtetë, sepse tepër shpesh synimet tona bazohen tek ajo që e vlerëson bota. Përbërësit thelbësorë janë mjaft të thjeshtë për anëtarët që i kanë marrë ordincat shpëtuese. Jini të drejtë. Ngrini një familje. Gjeneroni një mënyrë të përshtatshme për të siguruar të ardhura. Shërbeni sipas thirrjeve. Përgatituni që të takoni Perëndinë.

Shpëtimtari na mësoi se “jeta e njeriut nuk qëndron në mbushullinë e gjërave që zotëron” (Luka 12:15).

### **Ndërtojeni Atdheun dhe Komunitetin Tuaj**

Përveç cilësive, tipareve dhe vendimeve vetjake, nëse do të jeni brezi që keni nevojë të jeni, ju do të ndërtoni atdheun tuaj dhe komunitetin ku jetoni. Brezit tuaj do t'i



*Trashëgimia judeo-kristiane që kemi trashëguar, nuk është thjesht e çmuar, por edhe thelbësore për planin e Atit tonë në Qiell. Ne duhet ta ruajmë atë për brezat e ardhshëm.*

duhet të mbrojnë drejtësinë dhe lirinë fetare. Trashëgimia judeo-kristiane që ne kemi trashëguar, nuk është thjesht e çmuar, por edhe thelbësore për planin e Atit tonë në Qiell. Ne duhet ta ruajmë atë për brezat e ardhshëm. Ne duhet të bashkohemi me njerëz të mirë, përfshirë njerëzit e të gjitha besimeve – veçanërisht ata që ndihen përgjegjës përpara Perëndisë për sjelljen e tyre. Këta janë njerëz që do ta kuptonin këshillën se “pavarësisht se kush je, luaje mirë rolin tënd”. Rritja e suksesshme e vlerave judeo-kristiane dhe e lirisë fetare do ta shenjojë brezin tuaj si brezin e madhërishtëm që duhet të jetë.

Me sfidat që ekzistojnë në botë sot, Presidenca e Parë dhe Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve merakosen veçanërisht që ju të merrni pjesë siç duhet në procesin politik në vendin ku jetoni. Kisha është neutrale në garat politike dhe nuk mbështet kandidatë ose parti. Sidoqoftë, ne vërtet presim që anëtarët tanë të angazhohen plotësisht në mbështetjen e kandidatëve dhe të partive sipas zgjedhjes së tyre, bazuar mbi parime që do të mbrojnë qeverisjen e mirë. Doktrina jonë është e qartë: ata që janë të mirë, “të ndershëm . . . dhe të urtë . . . duhet të kërkohen me zell” (DeB 98:10).

Ne kemi mirëbesim të madh te ju. Udhëheqja e Kishës beson sinqerisht se ju mund ta ndërtoni mbretërinë si asnjë brez i mëparshëm. Ju nuk keni vetëm dashurinë dhe mirëbesimin tonë, por edhe lutjet dhe bekimet tona. Ne e dimë se sukcesi i brezit tuaj është thelbësor për themelimin në vazhdimësi të Kishës dhe në rritjen e mbretërisë. Ne lutemi që ju do ta luani mirë rolin tuaj, ndërsa e shmangni mbajtjen e një maske, veproni në përputhje me identitetin tuaj të vërtetë, vendosni synime të përshtatshme dhe ndërtoni atdheun dhe komunitetin tuaj. ■

*Nga një takim shpirtëror i Sistemit Arsmor të Kishës për të rinjtë në moshë madhore, i bërë tek Univerisiteti “Brigam Jang” në Ajdaho më 4 mars 2012. Për tekstin e plotë në anglisht, vizitoni [lds.org/broadcasts/archive/ces-devotionals/2012/01?lang=eng](http://lds.org/broadcasts/archive/ces-devotionals/2012/01?lang=eng).*

#### SHËNIME

1. David O. McKay, në Francis M. Gibbons, *David O. McKay: Apostle to the World, Prophet of God* (1986), f. 45.
2. Shih Mark L. Staker, “Remembering Hiram, Ohio”, *Ensign*, tetor 2002, f. 32, 35.
3. Shih *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 483.
4. “True to the Faith”, *Hymns*, nr. 254.
5. L. Tom Perry, në “Joy – for Us and Others – Comes by Following the Savior”, <http://lds.org/prophets-and-apostles/what-are-prophets-testimonies?lang=eng>.
6. Lucile C. Tate, *Boyd K. Packer: A Watchman on the Tower* (1995), f. 58–59.

# ADOLESHENTËT *dhe* BESËLIDHJET E TEMPULLIT

**Nga Geri dhe Suzan Karter**

**S**i punonjës tempulli, ne kemi pasur bekimin e takimit me të rinj në moshë madhore që po vijnë në tempull për të marrë indaumentet e veta. Ne kemi mësuar se një seminar përgatitjeje për në tempull ishte i dobishëm për ta, por ndikimi i prindërve dhe udhëheqësve të drejtë luajti një rol më domethënës për t'i ndihmuar të përgatiteshin për të bërë besëlidhje tempulli. Si prindër dhe udhëheqës, ne kemi nevojë ta ndihmojmë rininë jo vetëm që të përgatitet për shërbim misionar kohëplotë, që zgjat veçse për pak muaj, por gjithashtu për të bërë dhe mbajtur besëlidhje tempulli, të cilat zgjasin për përjetësinë. Hapat e parë fillojnë në fëmijëri.

## **Përgatitja e Fëmijëve**

Prindërit mund t'u tregojnë fëmijëve të tyre për rëndësinë e tempullit duke adhuruar në tempull dhe duke dhënë dëshmitë e tyre për punën në tempull. Edhe në zona ku pjesëmarrja e shpeshtë në tempull nuk është e mundur, prindërit mund të rrënjosin te fëmijët e tyre dëshirën për të shkuar në tempull.

Presidenti Hauard W. Hanter (1907–1995) i mësoi prindërit: “Le të ndajmë me fëmijët tanë ndjenjat shpirtërore që kemi në tempull. Dhe le t'u mësojmë atyre më me zell dhe më me kënaqësi gjërat që mund të themi siç duhet mbi qëllimet e shtëpisë së Zotit.”<sup>1</sup> Fëmijët tanë kanë nevojë të dinë se tempulli është një vend ku ne kemi marrë përgjigje për lutjet dhe ku ne e ndiejmë dashurinë e Perëndisë.

Prindërit gjithashtu mund t'u mësojnë fëmijëve të tyre që të presin me padurim dhe të jetojnë të denjë për rekomandimin e tyre me përdorim të kufizuar, për të cilin kanë mundësinë për t'u kualifikuar kur mbushin 12 vjeç. Kur vjen koha që këta të rinj të shkojnë në tempull, ne shohim gëzimin dhe krenarinë me të cilat ata i paraqesin këto rekomandime në tempull.

## **Përgatitja e Rinisë**


Prindërit mund t'i ndihmojnë fëmijët e tyre të përfshihen në kërkimin e historisë familjare, me qëllim që kur të mbushin 12 vjeç, të mund t'i çojnë em-

rat e familjes në tempull. Të rinjve që e bëjnë këtë, Plaku Dejvid A. Bednar, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, u ka premtuar: “Dashuria dhe mirënjohja juaj për paraardhësit tuaj do të shtohet. Dëshmia juaj për Shpëtimtarin dhe kthimi në besim tek Ai, do të bëhen të thellë dhe të qëndrueshëm. Dhe unë ju premtoj se ju do të mbroheni ndaj ndikimit në rritje të kundërshtarit.”<sup>2</sup>

Ne kemi parë shumë shembuj të këtij premtimi duke u përmbushur. Kohët e fundit, një e re na tha se pasi kishte kërkuar emrin e gjyshes së saj, ajo kishte ardhur në tempull për të bërë punën për të. Ajo tha se kur ishte pagëzuar për të, kishte pasur mbresën e qartë se gjyshja e saj do ta mirëpriste atë në jetën e ardhshme. Përvoja si këto i forcojnë dëshmitë dhe e rrënjosin dëshirën për të marrë pjesë në ordianca të mëtejshme të tempullit.

Shumë të rinj hasin tundime për t'u veshur në mënyrë të pahijshme. Kur prindërit dhe udhëheqësit veshin rroba





të hijshme, të thjeshta, të rinjtë do ta kuptojnë se edhe ata mund të bëjnë të njëjtën gjë. Të rinjtë kanë nevojë të kuptojnë se mënyra se si vishen dhe se si i trajtojnë trupat e tyre mund të tregojë se janë dishepuj.

Prindërit mund t'i ndihmojnë të rinjtë të përgatiten për të hyrë në tempull duke i ndihmuar ata të kuptojnë besëlidhjet që do të bëjnë atje. Besëlidhjet e tempullit përfshijnë premtime për ta “vëzhguar ligjin e virtytit të përpiktë dhe të dëlirësisë, për të qenë bamirës, të dashur, tolerantë dhe të pastër; për t'i përkushtuar si talentet ashtu edhe mjetet materiale për shpërndarjen e së vërtetës dhe për lartësimin e [familjes njerëzore]; për të ruajtur përkushtim ndaj kauzës të së vërtetës; dhe për të kërkuar në çdo mënyrë që të kontribuojmë në përgatitjen e madhërishe që toka të mund të jetë gati për ta pranuar Mbretin e saj – Zotin Jezu Krisht”<sup>3</sup>. Prindërit mund të dëshmojnë se të rinjtë do të marrin bekime vetjake dhe të fuqishme gjatë gjithë jetës së tyre, kur ata i mbajnë këto besëlidhje dhe këto besëlidhje do të bëhen më domethënëse për të rinjtë, ndërkohë që prindërit i ndihmojnë ata të kuptojnë se si bekimet ashtu edhe besëlidhjet bëhen të mundura nëpërmjet Shlyerjes së Jezu Krishtit.

Ka shumë mënyra si mund t'i ndihmojmë të përgatiten fëmijët dhe të rinjtë tanë për t'i marrë bekimet e tempullit. Sa më të përgatitur të jenë, aq më shumë ka mundësi që ata të jenë në paqe e ta ndiejnë Shpirtin dhe kështu do të jenë në gjendje të kenë përvoja të mëdha shpirtërore kur marrin indaumentin. Një përvojë tempulli që lartëson shpirtërisht, do t'i bëjë ata dishepuj më të zotuar të Krishtit dhe misionarë më të mirë – të nxitur për t'i ndihmuar njerëzit të cilëve u japin mësim, që të përgatiten të marrin ordinancat e veta të shenjta të tempullit. ■

#### SHËNIME

1. Howard W. Hunter, “Follow the Son of God”, *Ensign*, nëntor 1994, f. 88.
2. David A. Bednar, “Zemrat e Fëmijëve do të Kthehen”, *Liahona*, nëntor 2011, f. 26–27.
3. James E. Talmage, në *Preparing to Enter the Holy Temple* (2002), f. 34–35.

# Trashëgimia JONË E MADHE Misionare

*Të gjithë misionarët, të së shkuarës ose të së sotmes, shërbejnë me shpresën për t'ua bërë jetën më të mirë njerëzve të tjerë.*

**Nga Larin Porter Gant  
dhe Linda Deker Lopez**

Revistat e Kishës

**M**isionarët e sotëm e vazhdojnë trashëgiminë e madhe të mbushjes së tokës me njohurinë e Zotit (shih Isaia 11:9). Që nga Abrahami te Pali, nga Amoni tek Uillford Udrafi, misionarët në shkrimet e shenjtja dhe në historinë e Kishës u sigurojnë misionarëve të ditëve tona modele të fuqishëm për t'u ndjekur.

Qoftë nëse jemi misionarë anëtarë, duke u përgatitur për shërbim misionar kohëplotë, duke shërbyer një mision apo duke u kthyer nga një mision, ne mund të marrim kurajë dhe frymëzim nga këta shembuj.

## Trashëgimia Jonë Misionare në Bibël dhe në Perlën me Vlerë të Madhe

Misionarët e Dhiatës së Vjetër, të tillë si Jona, u thirrën për t'u dhënë një zë paralajmërimi njerëzve (shih Ezekieli 3:17–19). Nga shembulli i Jonas kuptojmë rëndësinë e pendimit dhe të bindjes. Historia e Abrahamit na mëson rreth prejardhjes dhe fuqisë së Priftërisë Melkizedeke.

Misionarët e Dhiatës së Re, të tillë si Pjetri dhe Pali, punuan për t'i ruajtur mësimet e Jezu Krishtit. Megjithatë, me kalimin e kohës bota shkoi drejt braktisjes. Perëndia e rivendosi ungjillin përmes Profetit Jozef Smith. Ne po punojmë tani, sikurse bënë ata misionarë, për t'i ruajtur dhe për t'i ndarë mësimet e Jezu Krishtit.



© 2002 DANIEL A. LEWIS

Jona në Bregdet në Ninive, nga Daniel A. Ljuis. Jona u pendua dhe shkoi duke predikuar dhe pohuar se Jehovai mbretëron kudo dhe se nuk e kufizon dashurinë e Tij te një komb ose një popull i vetëm (shih Jona 1–4).



## NJË ZË PARALAJMËRIMI

“Ngaqë Zoti është dashamirës, Ai thërret shërbëtorë për t'i paralajmëruar njerëzit për rrezikun. . . . Mendoni për Jonan. Ai u largua fillimisht nga thirrja e Zotit për ta paralajmëruar popullin e Ninivesë, të cilët ishin të verbuar ndaj rrezikut për shkak të mëkatit. Ai e dinte se njerëzit e ligj përmes epokave i kanë mohuar profetët dhe nganjëherë i vranë ata. Prapëseprapë, kur Jona eci përpara me besim, Zoti e bekoji atë me siguri dhe sukses.”

Presidenti Henri B. Ajring, Këshilltar i Parë i Presidencës së Parë, “Let Us Raise Our Voice of Warning”, *Liahona*, janar 2009, f. 3.



Pjetri dhe Gjoni përpara Sundimtarëve në Jeruzalem, nga Simon Veder. Pjetri dhe Gjoni u sollën përpara këshillit dhe prifti i lartë i pyeti ata: “Po a nuk ju kemi ndaluar rreptësisht të mësoni në atë emër? Dhe ja, ju e keni mbushur Jeruzalemin me doktrinën tuaj. . . . Por Pjetri . . . duke u përgjigjur, tha: ‘Duhet t’i bindemi Perëndisë më shumë sesa njerëzve’” (Veprat e Apostujve 5:28–29).

Apostulli Pal, nga Karel Skreta. Në udhëtimet dhe letrat e tij, Pali dha dëshmi të fuqishme për Shpëtimtarin nëpër të gjithë Azinë e Vogël dhe në shumë prej botës së njohur në atë kohë.



Melkisedeku Bekon Abramit [Abrahamin], nga Uollter Rejn. Melkisedeku beko Abramit (shih Zanafilla 14:18–20) dhe gjithashtu i dha atij priftërinë (shih DeB 84:14). Në një rast tjetër, Zoti iu shfaq Abramit, duke thënë: “Unë kam si qëllim . . . të të bëj një shërbestar për ta çuar emrin tim në një tokë të huaj. . . . Dhe ti do të jesh një bekim për farën tënde pas teje, që në duart e tyre ata do ta mbajnë këtë shërbesë dhe Priftëri për të gjitha kombet” (Abraham 2:6, 9).



## MËSIMDHËNIA JOBESIMTA- RËVE

“Bijtë e Mosias . . . shkuan mes lamanitëve. Duke i dhënë mësim një populli, traditat e të cilit në dukje nuk i çonin drejt rritjes shpirtërore, këta misionarë besnikë, sidoqoftë, ndihmuan për të bërë të ndodhte një ndryshim i madh në këta lamanitë. Ne e dimë se . . . ‘të gjithë Lamanitët që besuan në predikimin e tyre dhe që u kthyen në besim te Zoti, nuk hoqën dorë kurrë nga besimi i tyre’ (Alma 23:6).”

Plaku James B. Martino, i Të Shtatëdhjetëve, “Repentance That Brings Conversion”, *Ensign*, shtator 2012, f. 58.

Amoni përpara Mbretit Lamoni, nga Geri L. Kap. Amoni, një nga bijtë e Mosias, shpëtoi tufat e mbretit Lamoni. Kur mbreti e pyeti Amonin nëse u dërgua nga Perëndia, Amoni tha se ai ishte një burrë i thirrur nga Shpirti i Shenjtë për t’u mësuar ungjillin “popullit të Lamontit; që ata të sillen në një njohuri të asaj që është e drejtë dhe e vërtetë” (Alma 18:34).

## Trashëgimia Jonë Misionare në Librin e Mormonit

Alma, Amuleku, bijtë e Mosias dhe Samuel Lamaniti janë vetëm pak nga modelet e madhërishtme misionare për t’u ndjekur, që ne gjejmë në Librin e Mormonit. Nga ata ne shohim shembuj të pendimit, besimit, bindjes dhe kurajës. Si ata, ne mund të mbështetemi te frymëzimi dhe zbulesa nga Perëndia për ta drejtuar shërbimin tonë misionar.

Ai i Solli Lajme të Mira Shpirtit Tim, nga Uollter Rejn. Një engjëll vizitoi Samuel Lamanitin dhe i solli “lajme të mira shpirtit [i Samuelit]” lidhur me ardhjen e Shpëtimtarit (Helamani 13:6–7). Si pjesë e thirrjes së tij për t’u predikuar nefitëve, Samueli u ngjit në murin e qytetit të Zarahemlës dhe i ndau këto lajme të mira me njerëzit.





## Trashëgimia Jonë Misionare në Doktrina e Besëlidhje

Pas Rivendosjes së ungjillit, misionarët ishin thelbësorë. Misionarë të tillë si Den Xhons, Orson Hajd dhe Parli P. Prat treguan për Librin e Mormonit dhe për ungjillin e Jezu Krishtit. Disa njerëz, si vëllai i Profetit Jozef, Samueli, shërbyen afër shtëpisë së tyre. Të tjerë udhëtuan larg për ta ndarë ungjillin në vende të tilla si Tajlanda, Ishujt

Senduiç (Havai), Danimarka dhe Anglia.

Këta misionarë të hershëm shpesh shërbyen misione të gjata dhe të shumta. Ata i lanë prindërit, të dashurat, gratë, fëmijët dhe nipërit e mbesat po ashtu siç bëjmë ne. Ata shërbejnë për ne sot si shembuj të besimit, kurajës, bindjes, durueshmërisë dhe zellit.



Predikuesit Mormonë, nga Arnold Friberg, bazuar në një original nga Kristen Dalsgard. Kjo skenë e një misionari të hershëm shenjtor i ditëve të mëvonshme duke u mësuar ungjillin e Jezu Krishtit një familjeje daneze të mbledhur në shtëpinë e tyre fshatare ishte tipike për përpjekjet predikuese të shekullit të 19-të. Misionarët gjithashtu dhanë mësim në cepat e rrugëve ose në sallat e mbledhjeve të qyteteve.



Uillford Udrafi Përgatitet për Pagëzime në Fermën Benbo, nga Riçard A. Mëri. Zoti e drejtoi Uillford Udrafën në vitet 1840 drejt fermës së Xhon Benboit në Hirfordshajr në Angli. "Kishte një grup njerëzish atje që ishin duke u lutur për urdhrin e lashtë të gjërave", shkroi Uillfordi. Pasoja ishte, në tridhjetë ditët e para pasi mbërrita atje, unë pagëzova gjashitëqind vetë. . . . Pas një pune tetëmujore në atë vend, unë solla njëmitjehetë e tetëqind vetë në Kishë. Përse? Ngaqë kishte një popull të përgatitur për Ungjillin" ("Discourse", Deseret Weekly, 7 nëntor 1896, f. 643).

*Misionarët e sapombërritur pagëzuan vendas në Ishujt Senduiç (Havai) që në vitin 1851. Kjo fotografi daton në një kohë shumë më të vonshme.*



NUK LEOHET/KOPIIMI

## Duke Ndërtuar mbi Trashëgiminë Tonë Misionare

Që kur Presidenti Tomas S. Monson shpalli në konferencën e përgjithshme të tetorit 2012 se të rinjtë dhe të rejat mund të largoheshin për mision në moshë më të re, dhjetëra mijëra nga shenjtorët e ditëve të mëvonshme e kanë mbushur fushën e misionit.

Në konferencën e përgjithshme të prillit 2013, Plaku Nil L. Andersen, i Kuorunit të Dymbëdhjetë Apostujve, shtoi dëshminë e tij për punën misionare dhe e nxiti secilin prej nesh që të bëhej një pjesë e rëndësishme e kësaj mrekullie që po

shpalosej, duke ndihmuar për t'i gjetur ata që janë gati për ta dëgjuar ungjillin: "Me aq siguri sa Zoti ka frymëzuar më shumë misionarë për të shërbyer, Ai gjithashtu po zgjon mendjet dhe po hap zemrat e më shumë njerëzve të mirë e të ndershëm për t'i pranuar misionarët e Tij. Ju tashmë i njihni apo do t'i njihni ata. Ata janë në familjen tuaj dhe jetojnë në lagjen tuaj. Ata ecin duke u shkëmbyer me ju në rrugë, ulen pranë jush në shkollë dhe lidhen me ju në internet" ("Është një Mrekulli", *Liahona*, maj 2013, f. 78). ■

*Duke Qenë Pionierë në Rrugë, nga Ken Spenser. Këta dy misionarë ndajnë ungjillin me një burrë përpara një librerie në Nju-Bransuik në Nju-Xhersi, SHBA.*



ME MIRËSINË E MUZEUT TË HISTORISË SE KISHËS



## ETIKETA E JUAJ E ZEZË E MISIONARIT

"Nëse nuk jeni një misionar kohëplotë me një etiketë të zezë misionari të kapur në pallton tuaj, tani është koha që ta pikturoni një [të tillë] në zemrën tuaj – të ngjyrosur, siç tha Pali, 'jo me bojë, por me Frymën e Perëndisë së gjallë'."

Plaku Nil L. Andersen, i Kuorunit të Dymbëdhjetë Apostujve, "Është një Mrekulli", *Liahona*, maj 2013, f. 78.



ME MIRËSINË E MUZEUT TË HISTORISË SË KISHËS

Lamanitët do të Lulëzojnë si një Trëndafil, nga *Hoselito Hesus Asevedo Garsia*. Ky imazh tregon shpirtin e punës misionare mes njerëzve që flasin gjuhën spanjolle. Dy misionarë përgatiten për t'u dhënë mësim për ungjillin, ndërkohë që njerëzit vazhdojnë të bëjnë detyrat e tyre të përditshme. Tempulli i Limës në Peru, i vendosur mes shtëpish të vogla dhe kafshësh të vendit, përfaqëson rritjen e Kishës.



© IRI, ME MIRËSINË E JUEI ING CHEN

Misionarë të Palodhur, nga *Xhui Ing Çen*. Anëtarët e Kishës në Tajvan, si misionarët anëtarë kudo, kërkojnë ta ndajnë gëzimin e tyre për ungjillin dhe për shkrimet e shenjta. Shkrimet e shenjta janë mbi tavolinë, dhe kutia e madhe ngjyrë blu që mban fletë të rrotulluara, tregon një pikturë të Tempullit të Tajpeit në Tajvan.



ME MIRËSINË E MUZEUT TË HISTORISË SË KISHËS

Misionarët Shenjtorë të Ditëve të Mëvonshme në Sierra-Leone, nga *Emili Uillson*. Misioni i parë në Sierra-Leone u organizua në Fritaun më 1 korrik 2007. Fritauni u bë kunji i 3.000-të në Kishë më 2 dhjetor 2012.



**Nga Plaku Eduardo Gavaret,**  
i Të Shtatëdhjetëve

# GATI

## PËR DITËN E BETEJËS

*Qofshim ne, duke e vendosur mirëbesimin te Shpëtimtari,  
Zoti i Ushtrive, të përgatitur dhe të mos pengohemi në fushëbetejë.*

**N**ë vitin 1485, Rikardi III që në krye të fronit anglez. Ishte kohë paqëndrueshmërie dhe Rikardit iu desh ta mbronte kurorën më shumë se një herë. Por ai ishte një veteran ushtarak i rrahur, një luftëtar syapatrembur e mendjehollë që kishte një ushtri prej 8.000 deri në 10.000 burrash.

Po atë vit, një pretendues për fronin anglez, Henri Tudor, Konti i Riçmondit, e sfidoi dhe u ndesh me Rikardin në një vend që i dha betejës emrin e vet: Fusha Bosuorth. Henri, ndryshe nga Rikardi, kishte përvojë të pakët luftimi dhe forcat e tij numëronin vetëm 5.000 veta. Por ai kishte në anën e vet këshillues të mirë – fisnikë që kishin marrë pjesë në beteja të ngjashme, përrshirë disa kundër Rikardit. Mëngjesi i betejës mbërriti dhe çdo gjë linte të kuptohej që Rikardi do të dilte fitimtar.

Një legjendë e famshme dramatike përmbledh ngjarjet e 22 gushtit 1485. Atë mëngjes mbreti Rikard dhe burrat e tij u përgatitën për t'u përballur me ushtrinë e Henrit. Fituesi i betejës do të ishte sundimtari i Anglisë. Pak para betejës, Rikardi dërgoi një kujdestar kuajsh për të parë nëse kali i tij i parapëlqyer ishte gati.







“Vendosja shpejt patkonjtë”, e urdhëroi kujdestari i kuajve farkëtarin. “Mbreti dëshiron ta ngasë në krye të forcave të tij.”

Farkëtari u përgjigj se atij do t’i duhej të priste. “I kam vënë patkonj të gjithë ushtrisë së mbretit ditët e fundit”, tha ai “dhe tani duhet të shkoj të marr më tepër hekur.”

Kujdestari i paduruar tha se nuk mund të priste. “Armiqtë e mbretit po përparojnë pikërisht tani dhe duhet të takohemi me ta në betejë”, tha ai. “Bëj si të bësh me ato që ke.”

Siç e urdhëruan, farkëtari bëri më të mirën që mundi, duke bërë katër patkonj nga një shufër hekur. Pasi i sheshoi patkonjtë, i gozhdoi tre prej tyre në këmbët e kalit. Megjithatë, kur u përpoq t’i ngulte patkoin e katërt, ai e kuptoi se nuk i dilnin gozhdët.

“Më duhen një ose dy gozhdë të tjera dhe do të duhet pak kohë sa t’i përgatis”, i tha ai kujdestarit të kuajve.

Por, kujdestari nuk mund të priste më gjatë. “Po dëgjoj boritë tani”, shpalli ai. “Nuk mund të përdorësh thjesht ato që ke?”


Farkëtari u përgjigj se do të bënte më të mirën, por që nuk mund të garantonte se patkoi i katërt do të mbante.

“Thjesht ngule me gozhdë”, e urdhëroi kujdestari i kuajve. “Dhe ngutu, ose mbreti Rikard do të zemërohet me të dy ne.”

Beteja filloi shpejt. Për t’i grumbulluar burrat e tij, Rikardi ngiste kalin lart e poshtë nëpër fushë, duke luftuar e duke i nxitur ata me thirrjen: “Çani përpara! Çani përpara!”

Sidoqoftë, kur Rikardi vështroi për qark fushës, ai pa disa nga burrat e tij duke u tërhequr. Duke pasur frikë se edhe ushtarët e tij të tjerë mund të fillonin të tërhiqeshin, ai eci me galop drejt rreshtit të prishur për t’i nxitur të luftonin. Por përpara se Rikardi të mund t’i arrinte, kali i tij u pengua dhe ra, duke e hedhur mbretin në tokë. Një nga patkonjtë e kalit, pikërisht ashtu siç ishte druajtur farkëtari, ishte shkëputur gjatë ecjes së dëshpëruar të mbretit me galop.

Rikardi kërcëu nga toka teksa kali i tij u ngrit dhe vrapoi tutje. Teksa ushtria e Henrit përparonte, Rikardi valëviste shpatën e tij lart në ajër, duke thirrur: “Një kalë! Një kalë! Gjithë mbretërinë time për një kalë!”



### **MBAJINI MEND GJËRAT E VOGLA**

“Bindjuni mësi-  
meve profetike që  
Krishti dëshiron që  
ju t’i ndiqni. Mos e

lini pas dore lumturinë e ardhshme duke i rënë shkurt, në vend që të vini në jetë parimet e shëndetshme të ungjillit. Mbani mend: gjëra të vogla çojnë te gjëra të mëdha. Pamaturia ose lënia pas dore, në dukje e parëndësishme, mund të çojë në probleme të mëdha. Më e rëndësishme, zakone të thjeshta, të vazhdueshme, të mira çojnë drejt një jete plot me bekime bujare.”

**Plaku Riçard G. Skot, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, “Për Paqe në Shtëpi”, Liahona, maj 2013, f. 29.**

Por ishte tepër vonë. Në atë kohë, burrat e Rikardit po arratiseshin nga frika e ushtrisë së Henrit që po përparonte dhe beteja u humb. Që nga ajo kohë, njerëzit kanë nxjerrë fjalën e urtë:

*Prej mungesës së një gozhde, një patkua u humb,  
Prej mungesës së një patkoi, një kalë u humb,  
Prej mungesës së një kali, një betejë u humb,  
Prej mungesës së një beteje, një mbretëri u humb.  
Dhe e gjitha kjo prej mungesës së një gozhde  
për patkoin e kalit.<sup>1</sup>*

### **Kapja pas Parimeve Tona**

Kur mendoj për këtë histori, reflektoj për mënyrën se si një gozhdë sa e thjeshtë edhe e dobët e një patkoi kali, çoi në një kthesë të tillë të ngjarjeve. Ne mund ta krahasojmë gozhdën që mungonte, me parimet e ungjillit. Mungesa e parimeve të ungjillit dhe e vlerave e praktikave që i shoqërojnë ato, mund t’i lerë njerëzit të pambrojtur në fushëbetejë kundër tundimit dhe të keqes.

Çfarë praktikash na mungojnë në jetën dhe familjet tona? A po e shpërfillim lutjen vetjake apo familjare? Studimin e zellshëm të shkrimeve të shenjta? Mbrëmjen e rregullt familjare? Pagimin e plotë të së dhjetës? Shërbimin ndaj vëllezërve dhe motrave tona? Respektimin e ditës së Shabatit? Adhurimin në tempull? Dashurinë për të afërmit tanë?

Secili prej nesh mund të hedhë një vështrim brenda dhe të zbulojë se çfarë mund t’i mungojë – te cili parim apo praktikë kemi nevojë të *kapemi* më vendosmërisht në jetën dhe në familjet tona. Pastaj, pasi ta kemi përcaktuar atë parim apo praktikë, mund të veprojmë me zell dhe vendosmëri që ta *ngulim gozhdën* – për ta jetuar atë parim më plotësisht dhe për ta përgatitur më mirë veten dhe familjet tona që të ngrihemi për atë që është e drejtë.

Te Doktrina e Besëlidhje, Zoti këshillon: “Merrni përkrenaren e shpëtimit dhe shpatën e Shpirtit tim, të cilin do ta derdh mbi ju, dhe fjalën time, të cilën unë jua zbuloj, . . . e jini besnikë, derisa unë të vij” (27:18).

Shërbëtorëve të Tij besnikë, Shpëtimtari u ka premtuar: “Dhe krahu i tyre do të jetë krahu im, dhe unë do të jem mburoja dhe shqytja e tyre; e do t’i ngjesh ijët e tyre dhe ata do të luftojnë burrërisht për mua; . . . dhe nëpërmjet zjarrit të zemëratës sime do t’i ruaj ata” (DeB 35:14).

U kujtofshim që edhe nëse “kali është gati për ditën e betejës”, siç thonë Fjalët e Urta, “fitorja i përket Zotit” (21:31). E ndjekshim ftesën e Moronit për të “[ardhur] te Krishti dhe [për t’u] përsosur] në të” (Moroni 10:32). Dhe qofshim ne, duke e vendosur mirëbesimin te Shpëtimtari, Zoti i Ushtrive, të përgatitur dhe të mos pengohemi në fushëbetejën kundër së ligës. ■

### **SHËNIM**

1. Shih “For Want of a Horseshoe Nail”, në William J. Bennett, red., *The Book of Virtues: A Treasury of Great Moral Stories* (1993), f. 198–200.

# Përsheptimi

## I PUNËS PËR SHPËTIM

*Teksa i ftojmë, i duam dhe u shërbejmë të tjerëve, ne bëhemi dishepuj të vërtetë të Jezu Krishtit dhe ndihmojmë që të përsheptojmë punën për shpëtim.*

**E**dhe pse ka entuziazëm për misionarët kohëplotë që punojnë në internet dhe që udhëheqin vizita në shtëpitë e mbledhjeve, këto ndryshime janë vetëm një pjesë e vockël e figurës së madhe të punës për shpëtim. Shumë më e rëndësishme është çështja se si ne si anëtarë përshtatemi në figurën më të madhe të përsheptimit të punës për shpëtim. Nuk po na kërkohet që të përfshihemi në një program të ri. Thjesht po na jepet nxitje të jemi dishepuj të vërtetë të Jezu Krishtit. Roli ynë është të zhytemi në dashurinë dhe shërbimin për njerëzit rreth nesh – duke ngushëlluar një koleg pune në nevojë, duke ftuar miqtë tanë në një pagëzim, duke ndihmuar një fqinj të moshuar për punën e tij në kopsht, duke ftuar një anëtar më pak aktiv për një vakt ushqimor, ose duke ndihmuar një fqinj për historinë e familjes së saj. Të gjitha këto janë mënyra të natyrshme e të gëzueshme për të ftuar anëtarë më pak aktivë dhe njerëz jo të besimit tonë në jetën tonë dhe, si pasojë, në dritën e ungjillit. Ndarja me ta e momenteve zbavitëse dhe atyre të shenjta në jetën tonë, mund të jetë në të vërtetë mënyra më efikase se si secili prej nesh mund të “pun[ojë] në vreshtin e [Jezu Krishtit] për shpëtimin e shpirtave të [burrave dhe grave]” (DeB 138:56).

### Çfarë Është Puna për Shpëtim?

Puna për shpëtim është puna e Atit Qiellor që “të bëj[ë] të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme e njeriut” (Moisiu 1:39). Kjo punë e rëndësishme përfshin punën misionare të anëtarit, mbajtjen e të kthyerve në besim, aktivizimin e anëtarëve më pak aktivë, punën në tempull e për historinë familjare dhe mësimdhënien e ungjillit.<sup>1</sup> Tepër shpesh, ne mendojmë se këto aspekte të ungjillit janë të palidhura. Por te *The Work of Salvation: Worldwide Leadership Broadcast [Puna për Shpëtim: Transmetim Mbarëbotëror për Udhëheqjen]* më 23 qershor 2013, Plaku Rasëll M. Nelson, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dha mësim se “puna në të vërtetë është e padukshme. Këto përpjekje nuk janë të ndara; ato janë të gjitha pjesë e punës për shpëtim.”<sup>2</sup>



ILLUSTRIM ME FOTO NGA DAVID STOKER



Fraza “Përshpejtimi i Punës për Shpëtim” – emërtimi i faqes në internet që shoqëron transmetimin, ([hasteningthework.lds.org](http://hasteningthework.lds.org)) – i referohet premtimit të Zotit: “Vini re, unë do ta përshpejtoj veprën time në këtë kohë” (DeB 88:73).

Ordinancat thelbësore të priftërisë – pagëzimi, konfirmimi, shugurimi në priftëri për burrat dhe ordinancat e tempullit – qëndrojnë si gurë kilometrazhi përgjatë shtegut tonë për t’u kthyer tek Ati ynë Qiellor. Ndërsa marrim pjesë në punën për shpëtim, ne ndjekim dhe frymëzojmë të tjerët të ndjekin këtë shteg besëlidhjeje.

### **Anëtarët dhe Misionarët Punojnë së Bashku nën Çelësat e Priftërisë**

Ka ardhur koha për t’u ripërqendruar te parimi themelor se anëtarësia në Kishën e Zotit do të thotë të jesh thirrur për të qenë plotësisht i përfshirë në punën e Tij për shpëtim. Presidentët e kunjeve dhe peshkopët mbajnë çelësat e priftërisë të punës misionare në njësitë e tyre të Kishës<sup>3</sup> dhe i ndihmojnë anëtarët të bëjnë atë çfarë bëjnë dishepujt e vërtetë të Krishtit – të ndajnë dritën e ungjillit. Presidentët e misioneve mbajnë çelësat e priftërisë që i mundësojnë ata të drejtojnë punën e misionarëve që udhëheqin.<sup>4</sup> Misionarë



kohëplotë janë stërvitur për t'u dhënë mësim atyre që janë përgatitur për ta marrë ungjillin. Ata ndihmojnë anëtarët për punën misionare të anëtarëve, jo e anasjellta. Misionarët kohëplotë dhe misionarët anëtarë janë kështu partnerë në sjelljen e ungjillit në jetën e atyre që Zoti i ka përgatitur për ta marrë atë.

Gjatë transmetimit, Presidenti Tomas S. Monson tha: “Tani është koha që anëtarët dhe misionarët të bashkohen së bashku, të punojnë së bashku, të mundohen së bashku në vreshtin e Zotit për t'i sjellë shpirta Atij. Ai ka përgatitur mjetet që ne ta ndajmë ungjillin në një mori mënyrash dhe Ai do të na ndihmojë në punët tona nëse ne do të veprojmë me besim për ta përbushur punën e Tij.”<sup>5</sup>

Plaku Nil L. Andersen, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, foli për rëndësinë e dashurisë. Ai tha: “Ne punojmë së bashku në besim dhe unitet – besim se Zoti do të na udhëheqë hapat dhe unitet me njëri-tjetrin e me misionarët,

gjithmonë të shtyrë nga dashuria jonë për [Jezu Krishtin], dashuria jonë për njëri-tjetrin dhe dashuria jonë për ata të cilëve u shërbejmë”<sup>6</sup>.

### **Këshillat e Lagjeve Udhëheqin, Udhëheqësit e Misionit të Lagjeve Bashkërendojnë**

Nën drejtimin e peshkopit, këshilli i lagjes lehtëson, mbështet dhe bashkërendon përpjekjet e anëtarëve të lagjes duke planifikuar dhe udhëhequr punën për shpëtim për lagjen.<sup>7</sup>

Si anëtar i këshillit të lagjes, udhëheqësi i misionit të lagjes “bashkërendon përpjekjet e lagjes për të gjetur, për t'u dhënë mësim dhe për të pagëzuar kërkues. Ai e bashkërendon këtë punë me punën e misionarëve kohëplotë.”<sup>8</sup>

Duke u folur udhëheqësve të misionit të lagjeve, Plaku Nelson tha: “Ndihmohini [misionarët] të mbushin blloqet e tyre të takimeve me mundësi kuptimplote dhe takime, që ata të mos kenë kohë të trokasin nëpër dyer duke kërkuar



njerëz për t'u dhënë mësim. . . [Ju] jeni hallka lidhëse mes misionarëve, këshillit të lagjes dhe anëtarëve të lagjes.”<sup>9</sup>

### Shenja e Vërtetë e Suksesit

Si shenjtore të ditëve të mëvonshme, ne jemi bekuar të jetojmë në këtë kohë kur Zoti po e përshpejton punën e Tij. Për shkak se Perëndia ka një qëllim në vendosjen tonë në tokë në këtë kohë, ne kemi zotësinë të bëjmë më shumë nga sa mendojmë se mundemi. Për sa kohë ne do t'u afrohemi me mirësi dhe dashuri njerëzve që kanë nevojë për miqësinë dhe ndihmën tonë, ne nuk do të dështojmë. Suksesi misionar vjen duke ndjekur frymëzimin që rrjedh në mendjet e zemrat tona dhe thjesht duke ftuar të tjerët në jetët tona të përqendruara tek ungjilli. Ftesa është shenja e suksesit, jo nëse njerëzit pagëzohen apo bëhen aktivë në Kishë. Ashtu siç tha Plaku Xhefri R. Holland, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, për ushtrinë e madhe të misionarëve që po hyjnë tani në terrenin e misionit: “Na ka mbërritur ora në të cilën ne tani duhet të themi: ‘Ja ku po vijnë’. Të gjithë ne duhet të planifikojmë dhe ta përdorim këtë burim të dërguar nga qielli në mënyrën më prodhimore të mundshme.”<sup>10</sup>

Është koha për të gjithë ne që ta kuptojmë më qartësisht rolin tonë në përshpejtimin e punës për shpëtim. Ndërsa i bëjmë punën misionare të anëtarit, mbajtjen e të kthyerve në besim, aktivizimin e anëtarëve më pak aktivë, punën në tempull e për historinë familjare dhe mësimdhënien e ungjillit një pjesë të natyrshme të jetës sonë, ne do të përjetojmë gëzim të madh dhe do të na dhurohen dhuratat shpirtërore që na nevojiten për ta forcuar Kishën në shekullin e 21-të. ■


#### SHËNIME

1. Shih *Manuali 2: Administrimi i Kishës* (2010), kapitulli 4.
2. Russell M. Nelson, *The Work of Salvation: Worldwide Leadership Broadcast*, 23 qershor 2013, [hasteningthework.lds.org](http://hasteningthework.lds.org).
3. Shih *Manuali 2*, 5.1.6; 5.1.9.
4. Shih *Manuali 2*, 5.1.6.
5. Thomas S. Monson, *The Work of Salvation*, [hasteningthework.lds.org](http://hasteningthework.lds.org).
6. Neil L. Andersen, *The Work of Salvation*, [hasteningthework.lds.org](http://hasteningthework.lds.org).
7. Shih *Manuali 2*, 5.1.2.
8. *Manuali 2*, 5.1.3.
9. Russell M. Nelson, *The Work of Salvation*, [hasteningthework.lds.org](http://hasteningthework.lds.org).
10. Jeffrey R. Holland, *The Work of Salvation*, [hasteningthework.lds.org](http://hasteningthework.lds.org).

**P**ër videon e transmetimit *The Work of Salvation: Worldwide Leadership Broadcast* [Puna për Shpëtim: Transmetim Mbarëbotëror për Udhëheqjen] në 26 gjuhë, vizitoni [hasteningthework.lds.org](http://hasteningthework.lds.org). Ju gjithashtu mund ta gjeni transmetimin të arkivuar në 59 gjuhë te [lds.org/broadcasts](http://lds.org/broadcasts). *Manuali 2: Administrimi i Kishës* mund të gjendet në 29 gjuhë në [lds.org/manual/handbook](http://lds.org/manual/handbook).



*Roxher Rendrienerison e nisi shtegun drejt dishepullimit duke marrë misionaret në taksi.*



# TË BËRIT NJË Njeri i Paqes

*Tempulli, misionet dhe shërbimi e ndihmuan Roxherin dhe familjen e tij që të ecnin drejt të bërit një familje e përjetshme.*

**Nga Methju D. Fliton**

Revistat e Kishës

**R**oxher Rendrienerison e dinte se mungonte diçka në jetën e familjes së tij. “Tu luta Perëndisë që të më ndihmonte të gjeja diçka për ta udhëhequr familjen time”, tha ai. “Kisha dëshirë ta udhëhiqja familjen time drejt diçkaje të mirë, diçkaje që do ta çonte në shtegun e drejtë.”

Ai ishte i shqetësuar rreth mënyrës se si t’i rriste tre fëmijët e tij – bijtë Rendrieneridri dhe Sedinirina dhe të bijën, Nirina. Ai ishte i mërzitur sepse gjaknxehtësia e tij kishte sjellë sfida në familje. Ai dëshironte të ishte një prind më i butë.


“Vendosa se isha unë ai që duhej të ndryshoja sepse e pashë se cili isha bërë”, tha ai.

Roxheri e kishte humbur biznesin e tij të ndërtimit disa vite më parë dhe po punonte si shofer taksie në Antananarivo të Madagaskarit. Një ditë ai mori me makinë dy motra misionare.

“Pasi u futën në makinë, më pyetën për emrin dhe nëse kisha familje”, tha ai. “Më pyetën nëse e dija cili ishte Perëndia dhe nëse i lutesha Atij.”

Misionaret kënduan këngë me Roxherin gjatë rrugës dhe e ftuan atë në Kishë. Ai u përpoq të shkonte disa herë, por nuk mundi të gjente asnjëherë kohë në axhendën e tij dhe i humbi lidhjet me misionaret.

Rreth pesë muaj më vonë, Roxheri po punonte në shtëpi një ditë kur dëgjoi dy misionarë duke i folur dikujt jashtë gardhit të tij. Roxheri e dinte se ata kishin ardhur për të folur me të. Ai ndjeu se duhej t’i përgjigjej me po, cilëso pyetje që ata do t’i bënin.



**Studimi i ungjillit si familje e ka ndihmuar familjen Rendrienerison të afrohet më tepër së bashku.**

Pasi u prezantuan, misionarët e pyetën nëse dinte gjë për Perëndinë. Po. A dëshironte ai t'i lutej Perëndisë? Po. A dëshironte të fliste me misionarët? Po. Kur? Tani. Misionarët thanë se do të ktheheshin për 20 minuta. Kur u kthyen, kishin një anëtar me vete që jetonte aty pranë.

Misionarët i dhanë mësim Roxherit shumë herë për një muaj në shtëpinë e tij. Për shkak të gjërave që kishin dëgjuar rreth Kishës, pjesa tjetër e familjes së tij nuk dëshironte të studioje me misionarët. Pas një muaji duke mësuar rreth ungjillit, Roxheri shkoi në kishë me misionarët. Pritja e dashur që përjetoj, i la mbresa. “Anëtarët më pritën si të më kishin njohur tashmë prej një kohe shumë të gjatë”, tha ai.

Roxheri u kthye në shtëpi nga kisha dhe i tregoi familjes se do të pagëzohej për një muaj dhe se ata ishin të lirë të zgjidhnin të bashkoheshin me Kishën ose jo. Ata i kërkuan atij të priste që të mund të bashkoheshin me të. Filluan të merrnin pjesë në mbledhje dhe patën gjithashtu një surprizë të këndshme.

Hera e parë kur mori pjesë në mbledhjet e Kishës, i la një mbresë të qëndrueshme birit më të madh të Roxherit, Rendrienendrit. “Herën e parë që shkova në kishë, u habita shumë sepse njerëzit ishin aq të përlurur”, tha ai. “Së pari, ata ishin veshur siç duhet për kishë. Pas asaj e kuptova se ata ishin atje vërtet për një qëllim, jo vetëm për t’u dukur para të tjerëve.”

Rendrienerisonët u pagëzuan si familje më 20 shkurt 2003. Në atë kohë, Nirina ishte 8 vjeçe, Sedinirina ishte 17 vjeç dhe Rendrienendri ishte 19 vjeç. Familja ndaloi së punuari të dielave dhe e bëri të jetuarin e ungjillit një përparësi.

### **Ndryshimet**

“Pasi u pagëzova, pashë shumë ndryshime në shtëpinë tonë”, tha Arelina, gruaja e Roxherit. “U bë një shtëpi shpirtërore dhe kaq shumë bekime, si materiale ashtu edhe shpirtërore, erdhën nga të jetuarit e ungjillit.”

Nga një këndvështrim material, Roxheri i njeh merita Atit Qiellor për ndihmën që i dha për ta rindërtuar biznesin e tij. Pas dy vitesh si shofer taksie dhe bërjes së çfarëdolloj pune që mundej për të siguruar të ardhura për familjen, ai filloi të merrte kontrata ndërtimi. “Besoj se Perëndia më bekon gjithnjë kur vendos ta ndjek Atë”, tha ai.

Por bijtë e tij thonë se ndryshimi më i madh që kanë parë, është në temperamentin e të atit. Ata e përshkruajnë atë tani si një shembull përlulësie dhe mirësjelljeje. Roxheri tha se ungjilli e bindi se duhej të ndryshonte. Që kur filloi ta studioje atë, Roxheri është përpjekur ta mbushë jetën me gjëra të mira.

“Për shkak të mësimëve të ungjillit, nuk e humbas kurrë durimin”, tha ai. “Ka provokime ndonjëherë, por

ungjilli është në zemrën time, në kokën time dhe në shpirtin tim. Ai më ndihmon të rri i qetë.”

Kur krijohen situata acaruese, Roxheri është personi që i qetëson pjesëtarët e familjes dhe i kujton ata të veprojnë siç do të vepronte Shpëtimtari.

“Im atë u bë i përlurur dhe tani kujdeset për familjen tonë me dashuri”, tha Sedinirina. “Kur shoh ndryshimin tek ai, jam shumë mirënjohës për Atin Qiellor, për ungjillin dhe për të qenit anëtarë të Kishës.”

### Një Familje e Përzetshme

Në 2006-ën, me ndihmën e Fondit të Përgjithshëm të Ndihmës për Përkrahjen për Tempuj, Roxheri dhe Arelina shkuan në Johannesburg të Afrikës së Jugut, për t’u vulosur në tempull.

Nga viti 2009 deri në 2011, Sedinirina dhe Rendrienendri shërbyen në misione në Afrikën e Jugut – Sedinirina në Kejptaun dhe Rendrienendri në Johannesburg. Pjesë e shtysës së tyre për të shërbyer ishte që t’i ndihmonin familjet e tjera të ndryshonin, siç kishte bërë familja e tyre.

“Një mrekulli si kjo mund të ndodhë dhe ndodhi, sepse misionarët erdhën në shtëpinë tonë”, tha Rendrienendri. “Ndaj kisha dëshirën që të bëja po të njëjtën gjë për një familje diku.”

Ai vendim i solli një bekim tjetër familjes Rendrienerison. Qe një periudhë nëntëditëshe kur të dy Sedinirina dhe Rendrienendri do të ishin në Qendrën e Trajnimit të Misionarëve në Johannesburg. Roxheri e rregulloi që të fluturonte për në Afrikën e Jugut me Arelinën dhe të bijën, Nirinën, që e tërë familja të mund të vULOSEJ në tempull. Nirina, që ishte 14 vjeçe në atë kohë, tha se është e vështirë të përshkruhet përvoja dhe ajo që ndjeu.

“Ma forcoi besimin dhe më ndihmoi të ndihem më pranë Perëndisë”, tha ajo.

Sot, pjesëtarët e familjes punojnë që t’i ndërtojnë e t’i forcojnë njerëzit përreth tyre. Roxheri shërben si peshkop i lagjes së tij. Arelina punon në Fillore me programin “Besim në Perëndi”. Sedinirina është ndihmësnëpunës kunji. Rendrienendri është ndihmësnëpunës lagjeje. Nirina është drejtuesja e muzikës për lagjen.

Ungjilli ka qenë një përgjigje për lutjet e familjes Rendrienerison. I ka shëruar plagët e vjetra, i afroi më tepër dhe u dha atyre mundësi për të qenë së bashku përgjithmonë. Ai e ka mësuar Roxherin të dojë. “Jeta familjare”, tha ai, “është një jetë plot me dashuri.” ■

***Udhëtimi për në Afrikën e Jugut për t’u vulosur në Tempullin e Johannesburgut e forcoi familjen Rendrienerison.***



### FONDI I NDIHMËS PËR PËRKRAHJEN PËR TEMPULL

“Ka ende zona të botës ku tempujt janë kaq larg nga anëtarët tanë sa që ata nuk mund ta sigurojnë udhëtimin e kërkuar për të shkuar atje. Kështu që ata nuk janë në gjendje të marrin bekimet e shenjta e të përjetshme që sigurojnë tempujt. Për të ndihmuar në lidhje me këtë, ne kemi në dispozicion atë që quhet Fondi i Përgjithshëm i Ndihmës për Përkrahjen për Tempujt. Ky fond siguron vetëm një vizitë për në tempull për ata që ndryshe nuk do të ishin në gjendje që të shkonin në tempull, por që ende e dëshirojnë skajshëm atë mundësi. Kushdo që mund të dëshirojë të kontribuojë në këtë fond, thjesht mund të shkruajë në informacionin e fletës së zakonshme të kontributit që i jepet peshkopit çdo muaj.”

**Presidenti Tomas S. Monson, “Ndërsa Prapë Takohe”, Liahona, nëntor 2011, f. 5.**

## A DO TË KTHEHEJ MATEU?

**N**e kishim një grup të fortë të rinjsh në lagjen tonë, por biri ynë Mateu, u afrua me një joanëtar me të cilin kishte të përbashkët dashurinë për makinat dhe çdo gjë mekanike. Fatkeqësisht, ky i ri rridhte nga një familje që nuk e vlerësonte fenë. Prindërit e tij e lejonin pirjen e alkoolit dhe të duhanit në shtëpinë e tyre dhe nuk besonin se të qenit moralisht i pastër ishte e rëndësishme.

Mateu kishte fituar vendin e parë në skautizëm, por nuk mori pjesë në mbledhjet e ndarjes së çmimeve sepse kishte pushuar së jetuari standardet e skautizmit. I mbledha të gjitha çmimet e tij të skautizmit dhe bëra një kuti ekspozimi. Më pas e vura mënjanë, duke shpresuar se një ditë do të ishte me vlerë për të. Kur ishte 16 vjeç, Mateu pinte duhan, alkool dhe merrte drogë. E la shkollën dhe shkoi të

jetonte me të dashurën. Për dy vjet, e pamë shumë rrallë.

U shkatërruam. Nuk e dinim nëse ai do t'i kthehej ndonjëherë familjes dhe besimit të tij, por vendosëm të ndiqnim këshillën e Almës që kishte të bënte me birin e tij të pabindur. Alma vazhdoi ta donte të birin dhe u lut me besim se ai “do të sille[ ] në njohurinë e së vërtetës” (Mosia 27:14).

Ne luteshim vazhdimisht që Zoti të ndërhynte në jetën e Mateut dhe kapëm çdo mundësi për të shprehur me fjalë dhe vepra sa shumë e donim. Kur ai vinte në shtëpi, ne nuk thonim asgjë që ai mund ta interpretonte si kritikë apo gjykim. Ne thjesht shprehnim gëzimin tonë që e shihnim.

Një ditë, Mateu erdhi në shtëpi dhe tha që dëshironte të fliste. Ai tha se kishte takuar një vajzë në një

festë që kishte pyetje rreth Kishës. Përpara se të mund t'i thoshte asaj që nuk i dinte më përgjigjet, fjalët filluan t'i dilnin nga goja. Ai e gjeti veten duke iu përgjigjur pyetjeve të saj sapo ajo i bënte. Mateu tha se nuk mbante mend t'i kishte mësuar gjërat që tha, por e dinte se fjalët e tij ishin të vërteta. Ai vriste mendjen pse po jetonte ashtu kur ende besonte tek ungjilli.

Pas tri ditësh analizimi të brendshëm, ai vendosi ta linte prapa jetën që kishte bërë. Erdhi në shtëpi për të na kërkuar ndihmë që t'ia niste nga e para.

Mateu i telefonoi një kushëriri në një shtet tjetër që kishte mposhtur vështirësi të ngjashme, dhe e pyeti nëse mund të rrinte me të. Kushëriri i tij pranoi dhe Mateu filloi t'i ndiqte mbledhjet e Kishës me të dhe u takua me peshkopin që të merrte ndihmë me procesin e pendimit. Ai ndjeu dashuri dhe mbështetje dhe u bë aktiv në Kishë.

Me kohë, ai takoi një të re të këndshme e të drejtë. Ata ranë në dashuri dhe u martuan në tempull.

Kur lindi fëmija i tyre i parë, unë shkova për një vizitë dhe i çova kutinë e ekspozimit që kisha bërë me çmimet e tij të skautizmit. Ai u ngazëllye dhe e vari atë me krenari në një vend të dukshëm në shtëpinë e tij.

Birit tonë nuk iu shfaq një engjëll, siç i kishte ndodhur Alma të Riut. Por kthimi i Mateut tek e vërteta ishte po aq i mrekullueshëm. ■

Emri rezervohet



I mbledha të gjitha çmimet e skautizmit të Mateut dhe bëra një kuti ekspozimi. Më pas e vura mënjanë, duke shpresuar se një ditë do të ishte me vlerë për të.



# ISHA NË SHTËPI

**S**i pjesë e një projekti shërbimi, udhëtova për në Ruandë së bashku me disa mjekë të tjerë për të ndihmuar me nevojat mjekësore. Pas dy javësh, pranë fundit të udhëtimit tim, ia behu malli për shtëpinë. Më mungonte familja ime, shtrati im i rehatshëm dhe shtëpia ime.

Të dielën time të fundit në Afrikë, munda ta bashkërendoja programin e ditës që të mund të shkoja në kishë. Edhe pse Kisha nuk ishte e njohur zyrtarisht në Ruandë, pata mundësi të gjeja orarin dhe udhëzimet për mbledhjen në faqen e Kishës.

Dhe çfarë udhëzimesh që qenë: “Ec teposhtë rrugës së shtruar me kalldrëm matanë ndërtesës së ministrisë. Kërko një derë të hapur. Pastaj zbrit shkallët.”

Teksa i ndiqja këto udhëzime, fillova të dëgjoja refrenin e qartë të një himni të njohur. I zbrita shkallët dhe veshët më kapën fjalët e himnit “Sa i Fortë një Themel” (*Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 6). Shkallët mbaronin në një ndërtesë të vogël, ku duzina njerëzish të buzëqeshur po qëndronin rotull hyrjes. Pavarësisht faktit se isha

një i panjohur në bashkësi, ndjeva përkatësi të menjëhershme. Duzina vëllezërisht e motrash nga Ruanda erdhën për të më shtrënguar dorën dhe teksa e bënin, një barrë shtypëse vetmie m’u hoq nga shpina – isha në shtëpi!

Kur hyra në ndërtesë, mora pjesë në bllokun e zakonshëm treorësh të mbledhjes që nuk ishte ndryshe nga ai në lagjen e shtëpisë sime në

**P**avarësisht faktit se isha një i panjohur në bashkësi, ndjeva përkatësi të menjëhershme. Duzina vëllezërisht e motrash nga Ruanda erdhën për të më shtrënguar dorën.

Kaliforni. Mbjatësit e Priftërisë Aarone shpërndanë sakramentin, bisedat u përqendruan te Shpëtimtari dhe madje mësimi i Shkollës të së Dielës që njësoj me atë që jepej mësim në lagjen e shtëpisë sime atë javë.

Më e rëndësishmja, Shpirti i Zotit i depërtoi shërbesat. Qartazi, Zoti ishte i kënaqur me këta njerëz të mirë që bënë më të mirën e tyre për t’i shërbyer Atij. Mësova se gjatë vitit të kaluar, vetëm një grusht vendasish i ndiqnin shërbesat këtu. Megjithatë unë numërova më shumë se 100 pjesëmarrës, gjysma e tyre fëmijë të buzëqeshur.

Tani që Ruanda është hapur për punën misionare, mendoj se misionarët do të gjejnë sukses të madh teksa Shpirti u dëshmon numrit gjithnjë e në rritje të kërkuesve nga Ruanda se Kisha e rivendosur është mbretëria e Perëndisë për të gjithë tokën – për çdo kontinent, për çdo popull dhe për çdo fëmijë të Perëndisë. Sa mirënjohës jam për Kishën, qoftë nëse është e themeluar në bregun qendror të Kalifornisë ose teposhtë një shtegu me kalldrëm në Afrikën qendrore. ■  
Stiven Seinsbëri, Kaliforni, SHBA



## ÇFARË JU SOLLI NË REKSBURG?

**P**as dhjetëvjeçarësh që jetuam atje ku anëtarët e Kishës janë një pakicë, im shoq dhe unë u shpërngulëm në një lagje në Reksburg të Ajdahos në SHBA, që përmbante vetëm dy familje joanëtare. Ishte fati ynë i mirë që të jetonim ngjitur me një tjetër prej tyre.

Babai po kosiste lëndinën e tij herën e parë që erdhëm me makinë në oborrin tonë. Im shoq dhe unë e kaluam lëndinën për t'u njohur. Teksa i zgjata dorën, e pyeta: “Pra, çfarë e solli familjen tuaj në Reksburg?”

Ai u përgjigj: “Puna ime – dhe ne kërkuam posaçërisht një qytezë që duhej të prezantohej me Krishtin”.

Ndjeva si të më kishin hedhur një kovë me ujë të ftohtë në fytyrë, por buzëqesha. Vendosa në atë çast se pavarësisht çfarë do të thoshte apo bënte fqinjji ynë i ri, ne do të

bëheshim fqinjët *më të mirë* që kishte pasur ajo familje. Ne do të përpiqeshim të përgjigjeshim në çdo ndërveprim me ta, në një mënyrë të sjellshme, të dashur e të arsyeshme, ashtu siç do të bënte Shpëtimtari.

Tetë vitet pasuese sollën shumë veprimtari të përbashkëta mes familjeve tona. Nëna u ftua dhe mori pjesë tek aktivitetet e Shoqatës së Ndihmës. Ajo më ftoi mua dhe shumë fqinj shenjtorë të ditëve të mëvonshme në mbrëmjen e një gruaje të financuar nga kisha e saj. Im shoq dhe unë u ftuam në vallëzimin dhe recitalet në piano të fëmijëve të tyre. Familja e tyre u përfshi në gatimet në oborr dhe në festat e lagjes. Dhe ne morëm telefonata nga fëmijët e tyre më të mëdhenj kur ata kishin nevojë për t'u kthyer me makinë në shtëpi nga puna dhe nuk mund të flisnin me prindërit e tyre.

**V**endosa se pavarësisht çfarë do të thoshte apo bënte fqinjji ynë i ri, ne do të bëheshim fqinjët më të mirë që kishte pasur ajo familje.

Prindërit shqetësoheshin se fëmijët e tyre mund të fillonin t'i pëlqenin së tepërmi shenjtorët e ditëve të mëvonshme, ndaj nuk i lanë bijtë e tyre të bashkoheshin me programin e skautizmit të lagjes sonë. Por shtëpia jonë konsiderohej një vend i sigurt, ku ata i linin fëmijët e tyre të luanin kur kishim nipërit e mbesat tona për vizitë.

Sa herë që fqinjët tanë përpiqeshin të na ndihmonin të shihnim “gabimin e mënyrave tona”, ne i kujtonim ata që kishim respektin më të madh për bindjet e tyre dhe mënyrën se si jetonin dhe i edukonin fëmijët e tyre. Më pas shtonim se prisnim të njëjtin respekt për bindjet tona, të cilat gjithashtu përqendroheshin te mësimet e Shpëtimtarit.

Kur nëna përpiqej t'i bënte ndryshimet tona një hendek të thellë e të pakalueshëm duke pretenduar se shenjtorët e ditëve të mëvonshme besonin në një “Jezus tjetër”, i kujtoja asaj se të dyja ne besonim se Ai është hyjnor dhe Biri i dashur i Perëndisë. Përfundimisht, ajo dhe unë gëzuam një marrëdhënie të ngrohtë e miqësore.

Familja e tyre u shpërngul pa u bashkuar me Kishën. Por nëse ata mund të thonë: “Ne jetuam mes mormonëve; ata janë njerëz të mirë e respektues me zemra të sinqerta”, atëherë ndiej se ia kemi dalë mbanë me të qenit fqinj të mirë dhe me ndihmën ndaj tyre për t'u bërë më të hapur e më të drejtë në vlerësimin e tyre për shenjtorët e ditëve të mëvonshme. ■

Sandra Rash, Ajdaho, SHBA



## NJË KUTI FOTOGRAFISH

**D**isa vjet më parë, im shoq dhe unë, po linim një ngarkesë mbeturinash në vendin e zbrazjes së mbeturinave të qytetit kur vura re një nga zonjat që punonin atje duke marrë një kuti për ta futur në furrën e djegies. Papritur, kutia u çka dhe ranë disa fotografi.

Teksa po e shihja, pata një shtysë të fortë që të shkoja e ta merrja atë kuti fotografish. Dola jashtë makinës për të ndihmuar në mbledhjen e fotografive. Edhe zonja, edhe unë, ndiem se fotografitë ishin hedhur gabimisht dhe e binda të më linte t'i merrja fotografitë që të përpiqesha të gjeja dikë që do të kishte qejf t'i kishte.

Duke shqyrtuar qindra fotografitë në kuti, gjeta një zarf që i adresohet dikujt në Uorburg të Albertës në Kanada. Gjatë viteve të ardhshme, i shkrova disa letra njerëzve me të njëjtin mbiemër, por nuk mora kurrë një përgjigje.

Pasi familja ime mori qasje në internet, zbulova se kishte një shoqëri historike në Uorburg. Pyeta nëse ndokush që punonte atje, i njihte emrat që kisha gjetur prapa fotografive.

Një muaj më vonë, ne morëm një telefonatë nga një burrë që ishte kontaktuar nga shoqëria historike. Ai tha se motra e tij jetonte pranë nesh dhe pyeti nëse ajo mund t'i shihte fotografitë. Sigurisht që thamë po.

Të nesërmen, Flojd dhe Beth Houthorn, të dy shenjtorë të ditëve të mëvonshme, erdhën të shihnin fotografitë. Kur e hapa kutinë, vëllai Houthorn tha: "Mirë, ja ku është",

duke treguar me gisht fotografinë e sipërme. Qe një fotografi e gjyshit të motrës Houthorn.

Teksa shikonin fotografi pas fotografie, vëllai dhe motra Houthorn na tregonin histori rreth njerëzve në çdo fotografi. Houthornët dyshonin nëse kishin lidhje familjare me personin që i kishte hedhur fotografitë dhe nuk kishin asnjë ide se përse

fotografitë kishin përfunduar në vendin e zbrazjes së mbeturinave.

Ndjeva fuqishëm se Ati Qiellor më ndihmoi t'ia ktheja fotografitë familjes Houthorn. Dëshmoj se puna për historinë familjare është një nga punët më të rëndësishme për t'u bërë. Nëse jemi të gatshëm ta bëjmë punën, Zoti do të na ndihmojë ta bëjmë. ■

Sindi Hegi, Alberta, Kanada

**P**apritur, kutia u çka dhe ranë disa fotografi. Teksa po e shihja, pata një shtysë të fortë që të shkoja e ta merrja atë kuti fotografish.



# Si Mund të Jem një Misionare **E SUKSESSHME?**

*Pavarësisht sa fort punonim unë dhe shoqja ime e misionit, të gjithë po e refuzonin mesazhin tonë. Çfarë mund të bënim për t'u bërë misionare të suksesshme?*

**Nga Loren Bangerter Uajld**

**K**isha qenë në mision për më pak se një vit kur qëllova në një periudhë veçanërisht të vështirë. Ne qemë pikërisht në mes të një stine të zymtë, gri – sapo po dilnim nga një dimër i ftohtë dhe po hynim në pranverë. Dhe pavarësisht sa fort punonim unë dhe shoqja ime e misionit, të gjithë ata me të cilët flisnim, e refuzonin prerazi mesazhin tonë. Kur u takuam me misionarët e tjerë, mësuam se puna e tyre po përparonte. Nuk mund të mendoja ndonjë arsye përse ishim kaq të pasuksesshme. Kisha qenë në terrenin e misionit mjaftueshëm për ta folur gjuhën mirë, shoqja ime dhe unë ishim mikështa të mira, kishim krijuar mirëbesim tek anëtarët dhe përpiqeshim të ndiqnim Shpirtin dhe t'u bindeshim rregullave të misionit me përpikëri.

Por pavarësisht asaj që bënim, ne e hasnim refuzimin në çdo cep. Pas javësh e javësh kështu, e lashë qëndrimin tim të pakënaqur të më mposhtte. Gjatë një sesioni planifikimi më në fund thirra: “Çfarë kuptimi ka? Askush nuk do të na dëgjojë gjithsesi.” Shoqja

ime, duke pasur një këndvështrim më të mirë se unë, më tha thjesht: “Ne vendosim synime për të treguar besimin tonë. Ne i ndjekim më tej synimet që të numërojmë bekimet tona.”

Teksa meditoja për mendjemprehësinë e saj, e kuptova se kisha përdorur njësinë e gabuar matëse për të gjykuar suksesin tim si misionare. *Predikoni Ungjillin Tim: Një Udhëzues për Shërbimin Misionar* përmban një listë sjelljesh të misionarëve të suksesshëm<sup>1</sup>, dhe e kuptova se të gjitha ato sjellje janë nën kontrollin e misionarit. Nuk mund ta kontrolloja faktin nëse njerëzit në misionin tim do ta pranonin ose jo mesazhin e ungjillit, por mund të kontrolloja llojin e misionares që zgjedha të bëhesha. Shoqja ime më tregoi se besimi më i madh te Jezu Krishti dhe mirënjohja për bekimet e Tij do të më lejonin t'i dalloja mënyrat në të cilat isha tashmë një misionare e suksesshme.

## **Besimi i Nxjerr në Dritë Mrekullitë**

Ishte përlënëse të kuptoja se më mungonte besimi. Kërkova zona ku

mund ta forcoja besimin tim dhe zbulova se kur gjërat nuk kishin shkuar sipas planit, e kisha lënë veten të shkurajohesha. *Predikoni Ungjillin Tim* thotë: “Dekurajimi do të dobësojë besimin tuaj. Në qoftë se i humbisni shpresat, efektiviteti i punës suaj do të zvogëlohet, dëshira juaj do të dobësohet dhe do të keni vështirësi më të mëdha për të ndjekur Shpirtin.”<sup>2</sup> E kuptova se kisha lejuar që pengesat tona ta dobësonin besimin tim.

Nisa duke u lutur për një ndryshim të zemrës dhe për më shumë besim. U mbështeta edhe te premtimi i dhënë te Mormoni 9:21: “Kush beson në Krisht pa dyshuar asgjë, çdo gjë që i kërkon Atit në emrin e Krishtit do t'i jepet atij; dhe ky premtim është për të gjithë, madje deri në skajet e tokës”. Ky premtim më bëri të lutesha më me zjarr për bekimet dhe mrekullitë për të cilat shoqja ime dhe unë kishim nevojë, duke shtuar gjithnjë: “U bëftë vullneti Yt”. Këto lutje më ndihmuan t'i pranoja planet e ndryshuara dhe pengesat me besim më të madh, duke e ditur se Ati Qiellor u përgjigjet



## TË BËRIT NJË MISIONAR I SUKSESSHËM

Ju mund ta dini se keni qenë një misionar i suksesshëm kur ju:

- E ndieni Shpirtin t'ua dëshmojë njerëzve nëpërmjet jush.
- I doni njerëzit dhe dëshironi shpëtimin e tyre.
- U bindeni plotësisht rregullave të misionit.
- Zhvilloni cilësi si të Krishtit.
- Paralajmëroni njerëzit mbi pasojat e mëkatit. I ftoni ata të bëjnë dhe t'i mbajnë besëlidhjet.
- U bëni mirë dhe u shërbeni njerëzve në çdo rast, pavarësisht nëse ata e pranojnë apo jo mesazhin tuaj.

Nga *Predikoni Ungjillin Tim: Një Udhëzues për Shërbimin Misionar* (2004), f. 10–11.



### KËRKONI PRANIMIN E ZOTIT

“Ju ftoj me gjithë zemër që të kërkoni pranimin e Zotit dhe të gëzoni bekimet e Tij të premtuara. . . . Ne [mund] të arrijmë ta dimë se jemi pranuar prej Tij, pavarësisht nga pozicioni, gjendja apo kufizimet tona tokësore. Pranimi i Tij i dashur do të na motivojë, do ta rrisë besimin tonë dhe do të na ndihmojë të përballojmë çdo gjë që hasim në jetë. Pavarësisht nga sfidat tona, ne do të jemi të suksesshëm, do të përparojmë [shih Mosia 2:22] dhe do të ndiejmë paqe [shih Mosia 2:41].”

Plaku Erik W. Kopishke, i *Të Shtatëdhjetëve*, “Të Pranohesh nga Zoti”, *Liahona*, maj 2013, f. 106.

përherë lutjeve të besimit – edhe kur përgjigjet mund të vijnë në mënyra që nuk i presim. U bëra më e aftë për t'i njohur mënyrat me të cilat Zoti po na udhërrëfente gjatë gjithë ditës sonë.

Teksa punoja me forcimin e besimit tim, zbulova se forma pozitive e shprehjes nga *Predikoni Ungjillin Tim* ishte e vërtetë: “Në qoftë se nuk i humbisni shpresat, efektiviteti i punës suaj do të rritet, dëshira juaj do të shtohet dhe ju do të jeni në gjendje ta ndiqni më mirë Shpirtin”. Përveç kësaj, isha më optimiste rreth punës misionare dhe shërbimit tim misionar kur munda t'i dalloja dhe t'i vlerësoja mrekullitë që ndodhnin përditë.

### Mirënjohja Kundërvepron ndaj Xhelozisë

Zoti filloi të më tregonte se Ai bënte mrekulli për ne çdo ditë – por unë nuk kisha qenë në gjendje t'i dalloja ato derisa bëra një përpjekje të ndërgjegjshme për të qenë sinqerisht mirënjohëse. Shprehja e mirënjohjes është më tepër se thjesht një zakon i mirë apo sjellje e hijshme. Kur u shpreha mirënjohje Zotit dhe të tjerëve, u fuqizova. E gjeta veten të entuziazmuar për misionarët e tjerë kur ata kishin sukses në vend që të isha xheloze (shih Alma 29:14, 16). Isha më në gjendje të përqendrohesh tek ato që kisha dhe ato që shkonin mirë në vend që të përqendrohesh tek ato që më mungonin dhe ato që shkonin keq.

Mësova se mirënjohja është kundërhelmi i krahasimit të vetes me të tjerët. Ato herë kur nuk ndihesh si një misionare e suksesshme zakonisht vinin sepse i thoja vetes: “Nuk po ia

dal aq mirë sa ata”, ose “Ata janë më të zotë te kjo se unë”. Mësova gjithashtu se ndërkohë që modeli i Zotit është të na japë shembuj të drejtë me të cilët të matemi e t'i ndjekim, kundërveprimi i Satanit është të na tundojë ta krahasojmë veten me ata në mënyrë që të përcaktojmë vlerën apo suksesin tonë. Por *Predikoni Ungjillin Tim* është i qartë për këtë: “Mos e krahasoni veten me misionarët e tjerë dhe mos i matni rezultatet e jashtme të përpjekjeve tuaja me rezultatet e tyre”<sup>3</sup>. Si përfundim, mirënjohja më ndihmoi ta shmang krenarinë dhe më kujtoi se Zoti është në krye të punës së Tij. Nuk kisha nevojë të isha xheloze për shkak se shokët e mi misionarë dukej se kishin më shumë sukses.<sup>4</sup>

### Masa e Vërtetë e Suksesit

Përpara se të kisha këtë ndryshim në këndvështrim, isha përqendruar aq shumë në një lloj të caktuar bekimi sa që kisha harruar t'i lija sytë hapur për mënyrat e tjera në të cilat Zoti po u përgjigjej lutjeve tona dhe po e bekonte punën tonë misionare. Përfundimisht, Zoti filloi ta bekonte punën misionare në zonën tonë në mënyra të bukura e të papritura. Ne gjetëm njerëz që ishin të gatshëm ta praninin mesazhin tonë, por unë kisha mësuar deri në atë kohë që të mos e matja suksesin tim nga zgjedhjet e të tjerëve.

Presidenti Gordon B. Hinkli (1910–2008) tregoi këshillën e një presidenti misioni për punën misionare: “Bëni më të mirën tuaj, më të mirën e të mirës suaj. Bëni lutje dhe punoni fort dhe lërjani të korrat Zotit.”<sup>5</sup> *Predikoni Ungjillin Tim* jep mësim diçka të ngjashme rreth misionarëve të



**Në shumë mënyra, masa e suksesit tim si misionare mund të gjykohej nga gatishmëria ime për t'u pënduar dhe vendosmëria ime për të vazhduar punën.**

suksesshëm: “[Jepni] maksimumin tuaj për të sjellë shpirtin e Krishtit dhe kërkonte me zell të mësoni dhe të përmirësoheni”<sup>6</sup>.

Për sa kohë që isha e gatshme të pendohesha, për sa kohë që mund t'i jepja llogari Zotit me ndershmëri se po bëja më të mirën time, mund të ndieja sigurinë se isha një misionare e suksesshme – pavarësisht nëse njerëzit e pranonin mesazhin tonë ose jo. Në shumë mënyra, masa e suksesit tim si misionare mund të gjykohej nga gatishmëria ime për t'u pënduar dhe vendosmëria ime për të vazhduar punën.

Kam shumë mrekulli të shënuara në ditar nga kjo periudhë e misionit tim. Teksa përpqesha të isha më besnike dhe mirënjohëse, pata një këndvështrim më të mirë, shmanga shkurajimin

dhe e ndjeva Shpirtin më me bollëk në punën misionare. Zbulova se ajo që jep mësim *Predikoni Ungjillin Tim* është e vërtetë: “Edhe pasi të keni dhënë maksimumin tuaj, mund të përjetoni përsëri zhgënjime, por thellë brenda vetes nuk do të ndiheni të zhgënjyer. Ju mund të ndiheni të sigurt se Zoti është i kënaqur kur ju e ndieni Shpirtin të punojë përmes jush.”<sup>7</sup> Dhe kur ndjeva se Zoti ishte i kënaqur me mua, mund të duroja çdo provë. ■  
*Autorja jeton në Mein, SHBA.*

#### SHËNIME

1. Shih *Predikoni Ungjillin Tim: Një Udhëzues për Shërbimin Misionar* (2004), f. 10–11.
2. *Predikoni Ungjillin Tim*, f. 10.
3. *Predikoni Ungjillin Tim*, f. 10.
4. Shih Xhefri R. Holland, “Punëtorët në Vresht”, *Liahona*, maj 2012, f. 31.
5. Gordon B. Hinckley, “Find the Lambs, Feed the Sheep”, *Liahona*, korrik 1999, f. 120.
6. *Predikoni Ungjillin Tim*, f. 11.
7. *Predikoni Ungjillin Tim*, f. 11.

## TREGOJENI PËRVOJËN TUAJ

*“Jam kthyer së fundi nga misioni im dhe ndihem sikur e kam humbur të pasurit e një qëllimi. Çfarë duhet të bëj?”*

Misionarë të kthyer, ju lutemi na tregoni se si e bëtë kalimin nga misioni te kthimi në shtëpi dhe rikthimi në shkollë, punësimi apo veprimtari të tjera. Dërgojeni përvojën tuaj me postë elektronike në [liahona@ldschurch.org](mailto:liahona@ldschurch.org) ose dorëzojeni me internet në [liahona.lds.org](http://liahona.lds.org). Ju lutemi të përfshini emrin tuaj të plotë, datën e lindjes dhe emrin e lagjes apo të degës.



# Të Bërit një Misionar për *Predikimin e Ungjillit Tim*



**Nga Plaku  
Dejvid A. Bednar,**  
i Kuorumit të  
Dymbëdhjetë  
Apostujve

*Ju mund ta bëni këtë!  
Zoti që ju përfaqësoni dhe i  
shërbeni, e di se ju mund ta  
bëni këtë. Unë e di se ju  
mund ta bëni këtë.*

**N**jë apostull është së pari, mbi të gjitha dhe gjithnjë një misionar. Për këtë arsye, jam veçanërisht i kënaqur t'ju drejtohem juve si bashkëshërbëtorë në këtë vepër madhështore të ditëve të mëvonshme.

## ÇFARË ËSHTË NJË MISIONAR PËR *PREDIKIMIN E UNGJILLIT TIM?*

Një misionar për *Predikimin e Ungjillit Tim* është një shërbëtor i Zotit, i thirrur nëpërmjet profesisë dhe i autorizuar me anë të vënies së duarve, i cili shpall ungjillin e përjetshëm e të rivendosur të Shpëtimtarit në mënyrën e Tij (shih DeB 50:13–14, 17–24; DeB 68:1).

Qëllimi gjithëpërfshirës i një misionari të përshkruar te manuali *Predikoni Ungjillin Tim* është t'i "ftoljël të tjerët të vijnë te Krishti duke e ndihmuar ata të marrin ungjillin e rivendosur nëpërmjet besimit në Jezu Krisht dhe Shlyerjes së Tij, pendimit, pagëzimit, marrjes së dhuratës së Frymës së Shenjtë dhe durimit deri në fund"<sup>1</sup>.

Përgjegjësia e shenjtë për të shpallur me autoritet ungjillin dhe për të administruar ordinancat shpëtuese ka qenë në veprim që kur Adami u nxor nga Kopshti i Edenit dhe do të vazhdojë derisa "Jehova i Madh të thotë se puna u krye"<sup>2</sup>.



## KËRKESAT PËR T'U BËRË MISIONARË PËR PREDIKIMIN E UNGJILLIT TIM

Dëshiroj të diskutoj rreth pesë kërkesave bazë për t'u bërë misionar për *Predikimin e Ungjillit Tim*.

### Kërkesa nr. 1: Misionarët për *Predikimin e Ungjillit Tim* e besojnë se i shërbejnë dhe përfaqësojnë Jezu Krishtin.

Misionarët për *Predikimin e Ungjillit Tim* e dinë dhe e kuptojnë se cilin përfaqësojnë, përse shërbejnë dhe se çfarë duhet të bëjnë. Misionarë kohëplotë thirren për të shërbyer dhe për t'u veçuar në mënyrën e duhur si shërbëtorë dhe përfaqësues të Zotit Jezu Krisht. Ne japim dëshmi për emrin e Tij dhe për realitetin, hyjninë dhe misionin e Jezu Krishtit te çdo komb, fis, gjuhë dhe popull (shih DeB 133:37).

Ne e duam Zotin. Ne i shërbejmë Atij. Ne e ndjekim Atë. Ne e përfaqësojmë Atë.

Qëllimet e Tij duhet të jenë qëllimet tona. Interesat e Tij duhet të jenë interesat tona. Puna e Tij duhet të jetë puna jonë. Udhët e Tij duhet të jenë udhët tona. Vullneti i Tij gjithnjë e më shumë duhet të bëhet vullneti ynë.

Si përfaqësues të Shëlbuesit, ne predikojmë me thjeshtësi dhe qartësi doktrinën dhe parimet themelore të ungjillit të Tij të rivendosur. Ne nuk paraqesim pikëpamje ose ide vetjake. Ne shpallim dhe dëshmojmë për të vërtetën e thjeshtë të rivendosur sipas mënyrës së Zotit dhe me anë të fuqisë së Shpirtit të Tij.

Misionarët për *Predikimin e Ungjillit Tim* e kuptojnë se përgjegjësia për ta përfaqësuar Shpëtimtarin dhe për të dhënë dëshmi për Të, nuk resht



ndonjëherë. Ju lutem, kujtojeni Atë në gjithçka që mendoni, në gjithçka që bëni, dhe në gjithçka që përpiqeni të bëheni, dhe përfaqësojeni Atë siç duhet tek të gjithë fëmijët e Atit Qiejllor me të cilët ndërveproni tani dhe gjithnjë.

### Kërkesa nr. 2: Misionarët për *Predikimin e Ungjillit Tim* janë të denjë.

Një kusht paraprak i domosdoshëm për t'u bërë misionarë për *Predikimin e Ungjillit Tim* është denjësia vetjake përpara Shpëtimtarit.

Më lejoni të shpall disa të vërteta të thjeshta me po aq qartësi sa i di.

- Ne jemi përfaqësues të autorizuar të Shëlbuesit dhe Shpëtimtarit të botës.
- Ne jemi thirrur për të shpallur ungjillin e Tij të rivendosur e të përjetshëm.
- Ne nuk mund të njollosemi me mëkatet e botës dhe ta përfaqësojmë Atë me autoritet e të vepruem me fuqi në emrin e Tij të shenjtë.
- Ne nuk mund t'i ndihmojmë të tjerët ta mposhtin skllavërinë e mëkatit nëse vetë ne jemi të përzier në mëkat (shih DeB 88:86).
- Ne nuk mund t'i ndihmojmë të tjerët të mësojnë të pendohen nëse vetë ne nuk kemi mësuar të pendohemi siç duhet dhe plotësisht.
- Ne mund të shpallim dhe predikojmë me fuqi vetëm atë çfarë po orvatemi të bëhemi.
- Ne do të mbahemi përgjegjës përpara Perëndisë për dëshirat tona të drejta dhe denjësinë për të vepruar si përfaqësues të Tij.

Neve nuk na kërkohet tani të jemi të përsosur. Por ne urdhërohemi të jemi të pastër dhe të ecim me drejtësi përpara Shëlbuesit të Izraelit. "Jini të pastër që të mbani enët e Zotit" (DeB 38:42).

Pendimi është një parim shprese dhe shërimi – jo një parim shkurajimi dhe dëshpërimi. Pendimi në të vërtetë është përulje – por jo frikë. Pendimi është njëherësh kërkues dhe ngushëllues, i rreptë dhe lehtësues. Pendimi është një dhuratë e paçmueshme e bërë e mundur përmes Shlyerjes së Atij të cilin e duam, i shërbejmë dhe e ndjekim.


Edhe nëse keni kryer mëkate të rënda, përmes Shlyerjes së Jezu Krishtit

dhe pendimit të sinqertë, ju keni genë ose sërish mund të bëheni të pastër dhe të denjë.

Ka të rinj që ende kanë nevojë të pendohen plotësisht. Tani është koha! Ju lutem, ju lutem, ju lutem mos e shtyni ditën e pendimit tuaj.

Ka të rinj të cilët janë penduar dhe po vazhdojnë të pendohen, dhe që pyesin veten nëse kanë bërë gjithçka që është e nevojshme për t'u pranuar nga Zoti (shih DeB 97:8). Ju lutem kujtoni, Zoti ju kërkon të jeni të pastër por jo të përsosur. Fryma e Shenjtë që vepron sërish në jetën tuaj, është treguesi më i sigurt i faljes nga Zoti sepse “Shpirti i Zotit nuk banon në tempuj jo të shenjtë” (Helamani 4:24). Dhe dijeni se urdhri për t'i “fal[ur] të gjithë njerëzit” (DeB 64:10) përfshin faljen e vetvetes.

Misionarët për *Predikimin e Ungjillit Tim* janë dishepuj nderues të besëlidhjeve dhe të bindur ndaj urdhërimeve të Zotit Jezu Krisht. Ju lutem,



kujtojeni Atë gjithnjë dhe jini të pastër e të denjë për ta përfaqësuar Atë.

### **Kërkesa nr. 3: Misionarët për *Predikimin e Ungjillit Tim* i ruajnë si thesar fjalët e jetës së përjetshme.**

Ju ftoj të “mblidhni vazhdimisht si thesar në mendjet tuaja fjalët e jetës” (DeB 84:85). Mbledhja si thesar e fjalëve të jetës së përjetshme është më shumë se thjesht studimi ose mësimi përmendsh, sikurse “ushq[imi] me bollëk mbi fjalë[t] e Krishtit” (2 Nefi 31:20; shih edhe 2 Nefi 32:3) është më shumë se thjesht të provuarit ose të ngrënit e shpejtë. Mbledhja si thesar për mua sugjeron përqendrimin dhe të punuarin, shqyrtimin dhe përvetësimin, meditimin dhe lutjen, zbatimin dhe nxënien, çmuarjen dhe vlerësimin, si dhe kënaqjen dhe shijimin.

Sillni ndër mend se si bijtë e Mosias – katër misionarë vërtet të mrekullueshëm të quajtur Amoni, Aaroni, Omneri dhe Himni – “ishin përforcuar në njohurinë e së vërtetës; pasi ata ishin njerëz me kuptim të saktë dhe kishin kërkuar me zell shkrimet e shenjta” (Alma 17:2).

Këta misionarë guximtarë vërtet mblodhën vazhdimisht si thesar fjalët

e jetës së përjetshme. Ata nuk i shpërfillën as i zbatuan mekanikisht detyrat për studimin e shkrimeve të shenjta veçmas dhe me shokun. Njohuria dhe kuptueshmëria shpirtërore depërtuan thellë në vetë shpirtat e tyre dhe doktrinën e parimet e ungjillit u pohuan në zemrat e tyre si të vërteta nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë.

Si përfaqësues të Shpëtimtarit, ju dhe unë kemi përgjegjësinë e vazhdueshme për të punuar me zell dhe për të rrënjësuar në zemrat e mendjet tona doktrinën dhe parimet themelore të ungjillit të rivendosur, sidomos ato nga Libri i Mormonit. Ndërsa e bëjmë këtë, bekimi i premtuar është se Fryma e Shenjtë do të na i “kujtojë të gjitha këto” (Gjoni 14:26) dhe do të na fuqizojë ndërsa japim mësim dhe dëshmojmë. Por Shpirti mund të punojë me dhe përmes nesh vetëm nëse i japim Atij diçka me të cilën të punojë. Ai nuk mund të na ndihmojë të kujtojmë gjëra që nuk i kemi mësuar (shih Alma 31:5).

Misionarët për *Predikimin e Ungjillit Tim* i mblodhin vazhdimisht si thesar fjalët e jetës së përjetshme, ata mbështeten te virtyti i fjalës dhe kanë fuqinë e fjalës në vetvete. Ju lutem,

kujtojeni Atë gjithnjë, jini gjithnjë të denjë për ta përfaqësuar Atë dhe mblihdni si thesar e mbështetuni te virtyti i fjalës.

**Kërkesa nr. 4: Misionarët për *Pre-dikimin e Ungjillit Tim* e kuptojnë se Fryma e Shenjtë është mësuesi vendimtar dhe i vërtetë.**

Fryma e Shenjtë është anëtari i tretë i Kreut-Perëndi dhe Ai është dëshmitari i të gjithë të vërtetës dhe mësuesi vendimtar e i vërtetë. Mësimet që ne japim dhe dëshmitë që ndajmë, janë përgatitore për një kërkues që vepron dhe mëson për veten.

Si misionarë, një prej roleve tona më të rëndësishme është të ftojme kërkuesit të ushtrojnë lirinë e tyre morale të zgjedhjes dhe të veprojmë në përputhje me mësimet e Shpëtimtarit. Bërja dhe mbajtja e zotimeve shpirtërore, të tilla si lutja për një dëshmi për të vërtetën, studimi dhe lutja për Librin e Mormonit, frekuentimi i mbledhjeve të Kishës dhe mbajtja e urdhërimeve, kërkojnë që një kërkues të ushtrojë besim, të veprojë dhe të ndryshojë.

Pavarësisht se me sa zell shërbejmë, unë dhe ju thjesht nuk mund ta shtyjme ose detyrojmë të hyjë të vërtetën në zemrat e kërkuesve. Përpjekjet tona më të mira vetëm mund ta sjellin mesazhin e së vërtetës në zemër (shih 2 Nefi 33:1). Përfundimisht, një kërkues ka nevojë të veprojë në drejtësi dhe në këtë mënyrë të ftojë të vërtetën në vetë zemrën e tij apo të saj. Vetëm në këtë mënyrë kërkuesit e ndershëm të së vërtetës dhe të kthyerit e rinj në besim mund ta zhvillojnë aftësinë shpirtërore për të gjetur përgjigje për veten e tyre.

Duke qenë se përgjegjësia jonë është të ndihmojmë kërkuesit të mësojnë me anë të besimit dhe me anë të fuqisë së Frymës së Shenjtë, kjo punë nuk është asnjëherë për mua dhe nuk është asnjëherë për ju. Ne duhet të bëjmë gjithçka kemi fuqi për të përmbushur përgjegjësinë tonë si misionarë dhe njëherësh të “dalim nga skena” në mënyrë që Fryma e Shenjtë të mund të kryejë funksionin dhe punën e Tij të shenjtë. Faktikisht, çdo gjë që unë ose ju bëni si përfaqësues të Shpëtimtarit që me dijeni dhe me qëllim e tërheq vëmendjen tek vetja – te mesazhet që paraqesim, te metodat që përdorim, ose te sjellja dhe paraqitja jonë personale – është një formë e intrigës së priftërinjve që pengon efektshmërinë e mësimdhënies së Frymës së Shenjtë.

“A e predikon atë me anë të Shpirtit të së vërtetës apo me ndonjë mënyrë tjetër? Dhe nëse është me anë të ndonjë mënyre tjetër, nuk është prej Perëndisë” (DeB 50:17–18).

Ju lutem, kujtojeni Atë gjithnjë, jini të denjë për ta përfaqësuar Atë, mblihdni si thesar fjalën e Tij dhe lejojeni mësuesin vendimtar e të vërtetë, Frymën e Shenjtë, të dëshmojë për gjithë të vërtetën.

**Kërkesa nr. 5: Misionarët për *Pre-dikimin e Ungjillit Tim* e kuptojnë se mësimdhënia është më shumë sesa të folurit dhe të treguarit.**

Ndërsa Shpëtimtari u ul në malin e Ullinjve, Ai shpalli: “Mos u shqetësoni që më parë për atë që do të duhet të thoni dhe mos e paramendon; por thoni çfarë t’ju jepet në atë çast, sepse nuk jeni ju që flisni, por Fryma e Shenjtë” (Marku 13:11).

Shpëtimtari, në ditët e hershme të kësaj periudhe ungjillore, i udhëzoi misionarët: “Hapini gojët tuaja e ato do t’ju mbushen” (DeB 33:8, 10) dhe: “Ja ngrini zërat tuaj këtij populli; flisni mendimet që unë do të vë në zemrat tuaja dhe ju nuk do të ngatërroheni



përpara njerëzve; sepse do t'ju jepet në orën e duhur, po, në çastin e duhur, se çfarë duhet të thoni” (DeB 100:5–6).

Këto shkrime të shenjta theksojnë modelin më kërkues e të saktë për predikimin dhe të ndihmuarin e kërkuesve për të mësuar të vërtetën. Misionarët për *Predikimin e Ungjillit Tim* e dinë që ne nuk japim mësim; ne u japim mësim njerëzve. Ne nuk përsërisim ose paraqesim thjesht mesazhe të mësuara përmendsh për tema të ungjillit. Ne i ftojmë kërkuesit e së vërtetës që të përjetojnë ndryshimin e fuqishëm të zemrës. Ne besojmë se vetëm të folurit dhe të treguarit nuk të japin mësim.

Predikimi i ungjillit sipas mënyrës së Zotit përfshin vrojtimin, dëgjimin dhe dallimin si kushte paraprake për të folur. Vijmësia e këtyre katër proceseve të ndërlydhura është domethënëse. Ju lutem, vini re se vrojtimi dhe dëgjimi aktiv i paraprijnë dallimit dhe se vrojtimi, dëgjimi dhe dallimi vijnë përpara të folurit. Përdorimi i këtij modeli u krijon mundësinë misionarëve që të dallojnë dhe të japin mësim sipas nevojave të kërkuesve.

Teksa vrojtojmë, dëgjojmë dhe dallojmë, ne mund të na jepet “në çastin e duhur ajo pjesë që do t'i shpërndahet çdo njeriu” (DeB 84:85) – të vërtetat që duhen theksuar dhe përgjigjet që duhen dhënë, që do të plotësojnë nevojat e veçanta të një kërkuesi të caktuar. Vetëm përmes vrojtimit, dëgjimit dhe dallimit ne mund të drejtohem përmes Shpirtit për të thënë dhe për të bërë gjëra që do jenë më të dobishmet ndaj atyre të cilëve u shërbejmë.



Vrojtimi është një përgatitje jetike për të marrë dhuratën shpirtërore të dallimit. Dallim do të thotë të shohësh me sy shpirtërorë dhe të ndiesh me zemër – të kuptosh dhe të ndiesh pavërtetësinë e një ideje, mirësinë të një person tjetër ose parimin vijues që nevojitet për të ndihmuar një kërkues. Dallimi nënkupton dëgjimin me veshë shpirtërorë dhe të ndierin me zemër – dëgjimin dhe të ndierin e shqetësimit të pashprehur në një koment ose pyetje, vërtetësinë e një dëshmie apo doktrine, ose sigurinë e paqen që vijnë përmes fuqisë së Frymës së Shenjtë.

Misionarët për *Predikimin e Ungjillit Tim* veprojnë me besim dhe drejtohen me anë të Shpirtit për t'i ndihmuar kërkuesit që të mësojnë të vërtetën. Ju lutem, kujtojeni Atë gjithnjë; jini të denjë për ta përfaqësuar Atë; mbliidhni si thesar fjalën e Tij; lejojeni Frymën e Shenjtë t'ju dëshmojë gjithë të vërtetën; dhe vrojtoni, dëgjoni e dalloni ndërsa u dëshmoni për Jezu Krishtin kërkuesve të ndershëm të së vërtetës.

**JU MUND TA BËNI KËTË!**

Ju mund ta lexoni mesazhin tim dhe të besoni se të gjithë të rinjtë e

tjerë mund dhe do ta bëjnë atë që po përshkruaja. Por ju mund të jeni duke pyetur veten nëse mund ta bëni këtë. Ju lutem, dëgjoni. Ju mund ta bëni këtë!

Nëse do të plotësoja dëshirën e zemrës sime, do rrija disa çaste me çdonjërin prej jush personalisht. Do t'ju jepja dorën, do t'ju afroja, do t'ju shihja në sy dhe do t'ju thoja: “Ju mund ta bëni këtë! Zoti që ju përfaqësoni dhe i shërbeni, e di se ju mund ta bëni këtë. Unë e di se ju mund ta bëni këtë. Dhe si shërbëtor i Tij, ju premtoj se do ta keni ndihmën e Tij. Ju lutem, kujtoni gjithnjë se me ndihmën e Tij dhe me forcën e Tij, ju mund ta bëni këtë!”

Ju dua dhe lutem që ndërsa përpiqeni të bëheni ai/ajo që duhet të bëheni, ju do t'i njihni dhe do t'u përgjigjeni me besim zërit dhe drejtimit të Zotit. Më pas ju me të vërtetë do të bëheni përfaqësues të fuqishëm dhe të dobishëm të Zotit Jezu Krisht. ■

*Nga një fjalim i takimit shpirtëror të dhënë në Qendrën e Trajnimit të Misionarëve të Provos, më 24 qershor 2011.*

#### SHËNIME

1. *Predikoni Ungjillin Tim: Një Udhëzues për Shërbimin Misionar* (2004), f. 1.
2. *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 147.

# Thjesht. BUZËQESHNI dhe THONI "JO"

Nga Hazel Mari Tibule

**N**jë verë, mora pjesë në një trajnim pune në një ishull në Bikol, Filippine. Pamja e oqeanit ishte e mahnitshme dhe mezi e prisja çdo mëngjes.

Megjithatë, u druhesha mbrëmjeve. Kjo ndodhte kur njerëzit në kamp do të fillonin të pinin dhe do të organizonin festa. Ftesat ndaj të tilla festave qenë të shpeshta, dhe bashkëpraktikantët e mi dhe unë duhej të ishim të pranishëm, duke qenë se mospjesëmarrja do të ishte mungesë respekti.

Festa e parë ishte një festë mirëseardhjeje për praktikantët e rinj. Kisha frikë që të merrja pjesë, sepse isha shumë e sigurt se do të na ofronin pije dhe nuk isha e sigurt se si t'i refuzoja. I telefonova një miku në lagjen time dhe ai më dha disa këshilla të mrekullueshme që rritën besimin tim tek vetja.

Kur filloi festa, ata na ofruan pije por, fatmirësisht, nuk na detyruan që t'i pijmë. Duke qenë se bashkëpraktikantët e mi e pranuan qëndrimin tim për të mos pirë, refuzimi i ofertave të tjera për të pirë tani ishte i lehtë për mua – deri në një natë. Gjatë njëres prej festave tona, erdhi presidenti i kompanisë. Ai po mbante një shishe me *lambanog* (një verë e

zonës e përgatitur nga arrë kokosi). Pak pas mbërritjes së tij, e pashë atë duke zbrazur pak nga vera. Ai më pas tha: "Ju duhet të mësoni se si të pini" dhe ia dha gotën njëres prej praktikanteve. Ajo e piu ngutas.

Zemra ime filloi të rrihte fort. Shpejt do të vinte radha ime. Po i pëshpërisja vetes në heshtje: "Nuk do

*I kam refuzuar ofertat për të pirë, por tani presidenti i kompanisë po më ofronte një gotë me verë.*

ta pij. Nuk do ta pij." Më pas pashë presidentin të më zgjaste gotën me verë. Nuk dija se çfarë të bëja. Bashkëpraktikantët e mi po më vështronin, duke pritur që të shihnin se çfarë do të bëja. I buzëqesha presidentit dhe plot nderim i thashë: "Më falni, zotëri, por unë nuk pi".

E dija se u zhgënjye. Më pyeti përse nuk pija. I thashë: "Unë jam mormone".

Ai tha: "S'kam dëgjuar për këtë fe. Tingëllon si një lloj ushqimi." Të gjithë qeshën.

Edhe unë buzëqesha, jo për shkak të shakasë së tij por sepse e dija se bëra gjënë e duhur.

Askush asnjëherë nuk më ofroi më një pije. Por ende talljet nuk mbaruan, edhe nga vetë miqtë e mi. Madje njëra tha se po gënjeja dhe se është e paimagjinueshme që anëtarët e Kishës të mos pijnë. Gjatë kësaj kohe ndieva presionet që u vijnë anëtarëve të Kishës.

Qëndrimi në atë ishull më dha shumë mësim, jo thjesht akademike por shpirtërore. Mësova se përqeshja mund të mos mbarojë kurrë, por Shpirti i Zotit do t'ju drejtojë gjithnjë që të bëni atë që është e drejtë. ■

Autorja jeton në Metro Manila, Filippine.





**Nga Plaku  
Adrián Ochoa,**  
i Të Shtatëdhjetëve

*Dëshironi të ndiheni më mirë dhe më të sigurt fizikisht dhe emocionalisht? Ushtrimet e vazhdueshme fizike do t'ju ndihmojnë.*

**K**ohët e fundit lexova një koncept interesant për ushtrimet fizike. Lexova se, nëse ngriheni herët në mëngjes, vishni rrobat e ushtrimeve dhe mendoni: “Thjesht do vesh këtë, do dal jashtë për një shëtitje dhe, nëse ndihem mirë, do nis të vrapoj lehtë”, ju me shumë gjasa do të merrni një stërvitje të mirë përpara se madje ta kuptoni atë. Hartimi i një plani të thjeshtë si ky mund t'ju ndihmojë të zhvillon zakone të mira për ushtrimet fizike dhe kujdes për trupin tuaj. Për shumë njerëz, fillimi dhe të qenit i qëndrueshëm janë pjesët më të vështira. Nëse kujtoni që ushtrimet fizike nuk bekojnë vetëm trupin tuaj por edhe mendjen dhe intelektin tuaj, kjo do t'ju ndihmojë të keni dëshirën për t'u bërë më të shëndetshëm fizikisht. Ndërsa bëni ushtrime, ju do të bëheni një person energjik i cili ndihet i fortë, me besim në vetvete, vigjilent dhe i sigurt.

Më kujtohet historia e një zogu që filloi t'i shkëmbente pendët e tij me krimba. Ishte e lehtë të siguroje ushqim në atë mënyrë dhe zogu mendoi se kishte mjaft pendë. Ndërsa vazhdoi t'i shkëmbente pendët e tij, zogu gëzohej që nuk i duhej më të ngrihej herët për të gjuajtur për krimba. Ai

# JI I FORTË, JI I SHËNDETSHËM, JI I ZGJUAR

mund të ulej në follenë e tij gjithë ditën dhe asnjëherë të mos lëvizte ndonjë muskul. Megjithatë, përfundimisht zogu u mësua së tepërmi me këtë dhe e kuptoi se nuk mund të fluturonte më sepse i kishte humbur pendët e tij jetësore.

Kjo mund t'i ndodh çdokujt që bie në kurthin e zakoneve të këqija, rutinave dembelosëse ose përdorimit të substancave varësuese. Te broshura *Për Forcën e Rinisë* ne lexojmë se këto gjëra “dëmtojnë mirëqenien tuaj fizike, mendore, emocionale dhe shpirtërore. Ato dëmtojnë marrëdhëniet me familjen e miqtë dhe ju bëjnë të ndiheni keq për veten dhe vlerat tuaja. Ato kufizojnë aftësinë tuaj për të bërë zgjedhje për veten.”<sup>1</sup> Të qenit aktiv dhe ngrënia siç duhet na ndihmojnë t'i shmangim këto zakone të këqija. Nëse zogu do të vazhdonte të fluturonte dhe të gjuante, ai nuk do t'i kishte humbur kurrë pendët e tij. Po ashtu, nëse “i përplasim krahët tona” dhe ushtrohemi vazhdimisht, ne zhvillojmë aftësinë për të shmangur prirjet që na dëmtojnë dhe na degradojnë.

Sikurse disa individë luftojnë me shëndetin fizik, të tjerë luftojnë me shëndetin emocional. Jeta mund të jetë

e vështirë dhe ndonjëherë mund të kemi ndjenja ankthi, depresioni ose mungese vetëbesimi. Por mbani mend se si për shëndetin fizik edhe për atë emocional, ushtrimi dhe puna e zellshme ndihmojnë që të mbahet një këndvështrim pozitiv. Kujdesi për trupin tuaj gjithashtu e bekon mendjen tuaj dhe ju ndihmon të kujtoni se ju jeni një fëmijë i Perëndisë dhe mund të keni besim te vetja dhe të jeni i lumtur. Anët tona emocionale, fizike dhe shpirtërore të gjitha lidhen së bashku. Broshura *Për Forcën e Rinisë* jep mësim: “Shëndeti juaj emocional është gjithashtu i rëndësishëm dhe mund të ndikojë në mirëqenien tuaj shpirtërore e fizike. Zhgënjimi dhe trishtimi rastësor janë pjesë të kësaj jete të vdekshme. Megjithatë, nëse keni ndjenja si mërzia, mungesa e shpresës, ankthi ose depresioni, të cilat zgjasin për një kohë të gjatë, flisni me prindërit dhe peshkopin ose presidentin tuaj të degës dhe kërkoni ndihmë.”<sup>2</sup>

Përse gjejmë njerëz përreth nesh që duken të jenë më shumë energjikë dhe të lumtur? Një arsye kryesore janë zakonet. Nëse e shohim trupin tonë nga një këndvështrim shpirtëror dhe e kuptojmë se ai është “një tempull, një

dhuratë nga Perëndia”, ne do ta duam atë dhe do ta mbajmë të shenjtë.<sup>3</sup>

Për mua, *i shenjtë* do të thotë i pastër, i ushqyer dhe i fortë. Një prej mënyrave se si Ati Qiellor na ndihmon t'i mbajmë trupat tanë të shenjtë është duke na dhënë Fjalën e Urtësisë.


Broshura *Për Forcën e Rinisë* shpjegon: “Kur i bindeni [Ligjit të Urtësisë], ju mbeteni të lirë nga varësitë dëmtuese dhe keni kontroll mbi jetën tuaj. Ju fitoni bekimet e një trupi të shëndetshëm, një mendje të zhdërvjellët dhe drejtimin e Frymës së Shenjtë. Ju do të jeni të përgatitur t'i shërbeni Zotit. Kurrë mos e lejoni Satanin ose të tjerët t'ju bëjnë të mendoni se thyerja e Ligjit të Urtësisë do t'ju bëjë më të lumtur, më të famshëm apo më tërheqës.”<sup>4</sup> Ndërsa mbani Fjalën e Urtësisë, kujtoni se ju po kujdeseni si për trupin edhe

për mendjen tuaj dhe se kjo ju lejon të “gje[ni] urtësi dhe thesare të mëdha diturie” (DeB 89:19).

Në vend që të jeni një zog që me përtaci shkëmben pendët, vishni atletet për ushtrime dhe jini aktivë. Ushtrohuni në mënyrë të vazhdueshme. Regjistrohuni në sportin tuaj të preferuar ose bëni miq me të cilët mund të vraponi ose të bëni veprimtari të tjera çlodhëse. Ndërsa bëni aktivitete fizike, ju stërvisni jo vetëm trupin tuaj por edhe mendjen tuaj. Ushtrimi forcon edhe shëndetin emocional. Mbani mend se gjëja më e rëndësishme nuk është se sa i shpejtë ose atletik jeni – më e rëndësishme është se sa i qëndrueshëm jeni. Ndërsa ushtrohuni rregullisht, ju jo vetëm që do të jeni më të lumtur por do të bëheni edhe më të fortë, më të shëndetshëm dhe më të zgjuar. ■

**SHËNIME**

1. *Për Forcën e Rinisë* (broshurë, 2011), f. 26-27.
2. *Për Forcën e Rinisë*, f. 27.
3. *Për Forcën e Rinisë*, f. 25.
4. *Për Forcën e Rinisë*, f. 25.



**Mos u bëni si zogua dembel që shkëmben pendët e tij me krimba.**



# SHKONI PAS Gjurmëve TË TIJ

Të bërit si Shpëtimtari është një proces gradual e për tërë jetën dhe ju mund të filloni duke ndërmarrë hapa të vegjël çdo ditë.

**Nga Melisa Zenteno**

Revistat e Kishës

**S**hkrimet e shenjta na nxisin të bëhemi si Jezu Krishti dhe “të ecim] edhe vetë sikurse ka ecur ai” (1 Gjoni 2:6). Por ndërmarrja e atij hapi të parë mund të jetë e vështirë – sidomos kur nuk dini se si t’ia filloni.

Ju do të gjeni ndihmë te manuali *Predikoni Ungjillin Tim: Një Udhëzues për Shërbimin Misionar*. Ju mund të mendoni se është thjesht një manual për misionarët kohëplotë, por në fakt është një mjet i mrekullueshëm që mund t’ju ndihmojë të filloni punën për synimin tuaj për t’u bërë si Shpëtimtari. Kapitulli 6 është hartuar për t’ju ndihmuar juve të kuptoni dhe zbatoni nëntë cilësi të veçanta si të Krishtit.

Ja tek janë disa sugjerime për mënyrën se si ta përdorni manualin *Predikoni Ungjillin Tim* dhe shkrimet e shenjta ndërsa kërkoni të zhvilloni cilësi si të Krishtit:

- Për të filluar shkoni tek Aktiviteti i Cilësive në fund të kapitullit 6 te *Predikoni Ungjillin Tim* (faqe 130). Ky aktivitet mund t’ju ndihmojë të përcaktoni se cilat cilësi janë aktualisht forcat tuaja



shpirtërore dhe me cilat duhet të punoni.

- Pas përfundimit të aktivitetit, zgjidhni me lutje një cilësi ku të përqendrohëni. Merrni parasysh leximin e seksionit në kapitullin 6 rreth asaj cilësie.
- Vendosni synime të veçanta e të matshme që do t'ju ndihmojnë ta zhvilloni këtë cilësi. Jepini vetes një afat kohor për të punuar për atë synim. Më pas, vlerësoni përpunimin tuaj. Për shembull, nëse po përpunoni të keni më shumë dashuri hyjnore, ju mund të vendosni një synim për të thënë gjëra pozitive rreth vëllait ose motrës suaj tri herë çdo ditë për një javë. Në fund të javës, ju do të vlerësoni se si ia dolët me synimin tuaj dhe do të bëni rregullime që do t'ju ndihmojnë të vazhdoni të përmirësoheni.
- *Predikoni Ungjillin Tim* siguron shkrime të shenja që t'i studioni me secilën cilësi. Ju mund t'i studioni me lutje shkrimet e shenja të renditura dhe t'i shkruani

përshtypjet që merrni teksa lexoni.

- Kërkojini ndihmë Atit Qiellor që të zhvilloni një karakter si të Krishtit. Kërkoni ndihmë të veçantë si: "Të lutem më jep forcë për të mposhtur zemërimin tim kur motrat dhe vëllezërit më marrin gjërat e mia". Sa më specifike të jenë lutjet tuaja, aq më e lehtë do të jetë për ju që të njihni përgjigjet e Zotit.

Të bërit si Shpëtimtari ynë, Jezu Krishti, është një proces gradual dhe një përpjekje e tërë jetës. Ndonjëherë mund të duket më e vështirë se fizika e përparuar. Por mos u dëshpëroni. Zoti na premton: "Ai [ose ajo] që merr dritë e vazhdon në Perëndinë, merr më shumë dritë; dhe ajo dritë shkëlqen gjithnjë e më shumë, derisa dita është e plotë" (DeB 50:24). Ndërsa marrim, studiojmë dhe zbatojmë dritë e të vërtetë dhe vazhdojmë të ndjekim Perëndinë çdo ditë, ne mund të sigurohemi se do të bëhemi më shumë si Shpëtimtari ynë, Jezu Krishti. ■



## DETYRAT E PËRDITSHME

Veprimet e vogla e të përditshme janë gjurmë përgjatë shtegut për t'u bërë si Shpëtimtari ynë. Merrni parasysh këto aktivitete të tjera që ju ndihmojnë të zhvilloni cilësi si të Krishtit:

- Lexoni shkrimet e shenja të renditura tek Udhëzuesi për Shkrimet e Shenja që lidhen me cilësinë që po kërkoni të zhvilloni.
- Lutuni çdo ditë për dëshirën për të ndryshuar dhe forcën për t'u përmirësuar.
- Mbani një ditar për të shkruar përparimin tuaj.
- Flisni me prindërit tuaj. Vëri në dijeni për synimet tuaja në mënyrë që të mund t'ju ndihmojnë.



## LIDHJA NË BASHKËBISEDIM



**G**jatë gjithë muajit tetor, ju do të jeni duke studiuar rreth mënyrës se si të bëheni më shumë si Krishti (nëse lagjja ose dega juaj i ka mësimet e reja në gjuhën tuaj). Pasi ta lexoni këtë artikull, zgjidhni me lutje një cilësi që të punoni këtë javë ose muaj. Ju mund të vendosni një synim dhe më pas të vlerësoni përparimin tuaj. Për shembull, a ishit më shumë dashamirës ose më të bindur apo më të duruar? Si ju ndihmoi synimi juaj për t'u bërë më shumë si Krishti që të mposhtni vështirësitë? Merrni parasysh të ndani përvojën tuaj me të rinj të tjerë ose me familjen tuaj.

## “Çfarë u them unë joanëtarëve që pyesin përse disa anëtarë të Kishës nuk po i jetojnë standardet tona?”

**D**o të ishte e mrekullueshme nëse secili anëtar i Kishës do ta jetonte ungjillin plotësisht. Ata jo vetëm që do të gëzonin më shumë bekime në jetën e tyre, por gjithashtu do të ishin shembuj të mrekullueshëm për njerëzit përreth tyre. Por ne jemi të vdekshëm, kështu që ne të gjithë nuk ia dalim në njëfarë shkalle. Arsyeja kryesore pse disa e jetojnë ungjillin më plotësisht sesa të tjerët është se secili është në nivel të ndryshëm të kthimit vetjak në besim dhe të forcës së dëshmive vetjake. Çdonjëri ka sprovë të ndryshme dhe burime e njerëz të ndryshëm që i ndihmojnë.

Joanëtarët mund të mos i kuptojnë termat si “kthim në besim” dhe “dëshmi”, por ata do ta kuptojnë se secili person mund të zgjedhë se si të jetojë. Ju mund të shpjegoni se Ati Qiellor synoi që të ishte në këtë mënyrë. Ai na dha lirinë tonë të zgjedhjes në mënyrë që të mund të rriteshim shpirtërisht duke zgjedhur të drejtën. Por Ati Qiellor gjithashtu e dinte se çdonjëri – përveç Jezu Krishtit – do të bënte gabime, ndaj Ai dha një Shpëtimtar për ne. Për shkak të Shlyerjes, ne mund të pendohemi, të falemë, të mësojmë nga gabimet tona dhe të shkojmë përpara në jetë.

Ju mund të shpjegoni edhe se ne nuk i gjykojmë ata të cilët nuk po i ndjekin standardet e Kishës. Përkundrazi, ne përpiqemi t'i ndihmojmë ata, t'i kuptojmë ata dhe të jemi të duruar me ta. Ndonëse ne nuk e tolerojmë mëkatin, ne nuk e dënojmë mëkatarin (shih Gjoni 8:11). Pendimi është ende i mundur, për të gjithë ne.

### Kërkoni Shkrimet e Shenjta



Përgjigja për pyetjen mund të gjendet në shkrimet e shenjta. Kur njerëzit nuk i mbajnë urdhërimet, ne duhet të shmangim gjykimin (shih Mateu 7:1). Libri i Romakëve 3:23 thotë: “Sepse të gjithë mëkatuan dhe u privuan nga lavdia e Perëndisë”. Megjithatë, është e vërtetë që anëtarët e Kishës duhet të përpiqen të jenë të bindur.  
*Medison M., 13 vjeçe, Teksas, SHBA*

### Jepni Mësim për Shlyerjen



Kur njerëzit thonë gjëra të tilla, në vend që të gjej faj tek anëtari që nuk po ndjek rregullat, unë e përdor atë si një mundësi për të dhënë mësim për Shlyerjen. Unë u them atyre se thjesht për shkak se jemi mormonë nuk do të thotë se jemi të përkryer dhe se kemi Shlyerjen që të mund të pendohemi për mëkatet tona e t'i ndreqim ato gabime. Kjo zakonisht hap rrugën për akoma më shumë pyetje.

*Xhejdi H., 16 vjeçe, Oregon, SHBA*

### Kisha na Mëson të Bëjmë Mirë



Si çdokush tjetër, anëtarët e Kishës përjetojnë sfida dhe tundime. Të gjithë ne kemi dobësi, por kjo nuk do të thotë se kjo Kishë nuk është e vërtetë. Kjo është Kisha e Jezu Krishtit, që po i ndihmon njerëzit të njohin ungjillin e vërtetë dhe të marrin ekzaltim. Është njeriu i natyrshëm që nuk u bindet

*Përgjigjet synojnë të japin ndihmë dhe këndvështrim, nuk jepen si deklarime zyrtare të doktrinës së Kishës.*

urdhërimeve (shih Mosia 3:19) dhe nuk është faji i Kishës. Kisha na mëson të bëjmë vepra të mira. Por të gjithë ne kemi një zgjedhje.

*Lavinia S., 19 vjeçe, Bulakan, Filipine*

### Standardet Janë për Lumturinë Tonë



Kjo pyetje është e njohur për mua sepse njoh disa persona të cilët kanë bërë zgjedhje që i kanë larguar nga ungjilli. Zoti na jep urdhërime për lumturinë tonë dhe që të "bëjlë" të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme e njeriut" (Moisiu 1:39). Zoti dëshiron që ne të kthehemi tek Ai; megjithatë, Ai dëshiron që ne të bëjmë vetë zgjedhjet tona. Kjo është arsyeja përse disa persona nuk i jetojnë standardet tona. Standardet më ndihmojnë mua personalisht sepse e di se Ati Qiellor m'i ka dhënë ato që të mund të kthehem dhe të jetoj me Të dhe të jem e lumtur. Ato janë provë e dashurisë së Tij për mua.

*Morgan D., 18 vjeçe, Langëdok-Rusijo, Francë*

### Bëhuni Shembull



Kjo Kishë është jetike për të na ndihmuar të përmbushim urdhërimet e Atit tonë Qiellor dhe për të jetuar me Të sërish. Por thjesht sepse dikush i përket Kishës nuk do të thotë se ai apo ajo do të jetë gjithmonë një njeri i mirë. Shikojeni botën tonë sot, plot ligësi dhe neveri, edhe pse bota është e mbushur me njerëz që vendosën ta

ndiqnin Jezu Krishtin në jetën para lindjes. Mendoj se gjëja më e mirë që mund të bëjmë, është të vendosim një shembull për miqtë tanë.

*Kaden S., 15 vjeç, Juta, SHBA*

### Lutuni për Ta dhe Vizitoni Ata

Anëtarët të cilët nuk i jetojnë standardet tona, mund të mos kenë një dëshmi të përqendruar te Jezu Krishti. Ne duhet të lutemi për ta, që ata të kërkojnë drejtimin e Shpirtit dhe që të jenë në gjendje të fitojnë dëshminë e tyre vetjake. Ne duhet t'i vizitojmë këta njerëz dhe t'i ndihmojmë të vijnë te Krishti.

*Andrea C., 13 vjeçe, Lima, Peru*

### Jetoi Standardet Tona



Sikurse çdo organizatë ose fe tjetër, ka disa njerëz të cilët janë më shumë të përkushtuar ose më pak të përkushtuar. Ne thjesht duhet t'i jetojmë standardet tona sa më mirë të mundemi dhe të shpresojmë e të lutemi që edhe të tjerët do t'i jetojnë ato.

*Maren S., 16 vjeçe, Arizona, SHBA*



### SHIHINI TË TJERËT ASHTU SIÇ MUND TË BËHEN

"Ne kemi përgjegjësinë për t'i parë individët jo siç janë, por përkundrazi, ashtu si mund të bëhen. Do t'ju lutesha që të mendoni për ta në këtë mënyrë."

Presidenti Tomas S. Monson, "Shihini të Tjerët ashtu siç Mund të Bëhen", *Liahona*, nëntor 2012, f. 70.

## PYETJA PASUESE

"Po përpiqem t'i kontrolloj mendimet e mia, por ka kaq shumë tundime. Si mund të kem mendime më të pastra?"

Deri më 15 nëntor, dërgojeni përgjigjen tuaj dhe, nëse dëshironi, një fotografi me rezolucion të lartë te [liahona@ldschurch.org](mailto:liahona@ldschurch.org) ose nëpërmjet postës te adresa në faqen 3.

Leja dhe informacioni vijues duhet të përfshihen në mesazhin elektronik apo letrën tuaj: 1) emri i plotë, 2) data e lindjes, 3) lagjja ose dega, 4) kunji ose distrikti, 5) leja juaj me shkrim dhe, nëse jeni nën moshën 18 vjeç, leja me shkrim e prindit tuaj (mesazhi elektronik pranohet për botimin e përgjigjes dhe të fotografisë suaj.



**Nga Plaku  
C. Skot Grou,**  
i Të  
Shtatëdhjetëve

*Ndihma për ju që të pendoheni është një pjesë e veçantë e thirrjes së peshkopit. Ndërgjegjja juaj do t'ju tregojë se kur duhet të flisni me të.*

**J**u mund të pyesni veten përse ju jepet mësim t'i rrëfehni peshkopit ose presidentit të degës suaj kur keni kryer mëkate serioze. Ju mund të thoni me vete: "A nuk është pendimi një gjë personale midis meje dhe Zotit? Nëse nuk sillem më keq dhe i jam rrëfyer Perëndisë, përse duhet të flas me peshkopin tim?"

### **Përse të Flasim me Peshkopin dhe jo Dikë Tjetër?**

Shumë të rinj ndihen më rehat kur ia rrëfejnë gabimet e tyre prindërve apo udhëheqësve të të rinjve. Ndonëse prindërit dhe udhëheqësit tuaj mund t'u ofrojnë mbështetje dhe këshillë të nevojshme, Zoti ka shpallur se peshkopi është një gjykatës i përbashkët në Izrael (shih DeB 107:72, 74). Ai ka përgjegjësinë për të vendosur për denjësinë e anëtarëve të lagjes së tij. Përmes shugurimit dhe të jetuarit të drejtë, peshkopi ka të drejtë për zbulesë nga Fryma e Shenjtë lidhur me anëtarët e lagjes së tij, duke ju përfshirë juve.

Peshkopi mund t'ju ndihmojë përmes procesit të pendimit në mënyra që prindërit ose udhëheqësit e



# PËRSE DHE ÇFARË DUHET T'I RRËFEJ PESHKOPIT TIM?

tjetër nuk janë në gjendje t'i ofrojnë. Nëse mëkati është mjaft i rëndë, ai mund të përcaktojë që privilegjet tuaja në Kishë duhet të kufizohen. Për shembull, si pjesë e procesit tuaj të pendimit, ai mund t'ju kërkojë të mos e merrni sakramentin ose të mos e ushtroni priftërinë për një periudhë kohe. Ai do të punojë me ju dhe do të përcaktojë se kur do të jeni sërish të denjë për t'i rifilluar këto veprimtari të shenja.

Peshkopi juaj do t'ju këshillojë mbi atë se çfarë të bëni për të forcuar aftësinë tuaj për t'i rezistuar tundimit.

Ai mund t'ju nxisë të studioni një temë doktrinale, të tillë si pendimi, dhe më pas të ndani me të atë që mësuat. Ai mund t'ju kërkojë të takoheni me të çdo javë për t'i treguar se si po vepëroni për ta larguar veten nga situatat tunduese.

### **Kur Duhet të Flas me Të?**

Ju mund të jeni duke menduar: "Kjo e gjitha tingëllon mirë, por si mund ta di nëse ajo që kam bërë është mjaft serioze saqë duhet të flas me peshkopin?" Përgjigjja e shkurtër: "Ndërgjegjja do t'jua thotë". Kur të

ndieni shpimin e ndërjegjes, veproni menjëherë (shih Alma 34:31–34).

Lidhur me pendimin, mbreti Benjamin dha mësim: “Unë nuk mund t’ju tregoj juve të gjitha gjërat që mund t’ju shtyjnë të bëni mëkat; pasi ka mënyra dhe mjete të ndryshme, madje aq shumë sa unë nuk mund t’i numëroj ato” (Mosia 4:29). Kështu që, në vend që të jap një listë të hollësishme të gjërave që duhet t’i rrëfeni peshkopit tuaj, më lejoni të ndaj disa parime që do t’ju ndihmojnë ta merrni atë vendim.

### Çfarë Duhet të Rrëfej?

E di se jeni përpjekur të jeni të bindur, por ndoshta keni bërë disa gabime – madje disa gabime të rënda. Shumë prej gabimeve që njerëzit bëjnë, mund të zgjidhen përmes lutjes personale dhe pendimit të sinqertë. Disa gabime, sidomos ato që lidhen me imoralitetin, kërkojnë rrëfim te peshkopi përpara se të mund të merrni faljen e Zotit.

Ndërsa mendoni për gabimet që keni bërë, ju mund të ndiheni fajtor, i pavendosur, i brengosur ose edhe i mjerë. Nëse po përjetoni ndonjë rrënjë prej këtyre ndjenjave, atëherë ju ndoshta duhet të flisni me peshkopin tuaj për ato gabime.

Mos u përpiqni të justifikoheni ose të arsyetoni për fajin tuaj. Ju mund të jeni duke menduar: “Do të ishte shumë sikletosëse t’i tregoja peshkopit mbi atë që kam bërë. Ai mendon se jam një person më i mirë sesa kaq. Ai do

të tronditet nëse i tregoj se çfarë kam bërë. Ai nuk do të më pëlqejë më.”

Ju premtoj se ai nuk do t’ju dënojë. Si shërbëtor i Zotit, ai do të jetë i sjellshëm dhe i mirëkuptueshëm ndërsa ju dëgjon. Ai më pas do t’ju ndihmojë përmes procesit të pendimit. Ai është lajmëtari i mëshirës së Zotit që ju ndihmon të bëheni të pastër përmes Shlyerjes së Jezu Krishtit.

Zoti ka thënë: “Vini re, ai që është penduar për mëkatet e tij, po ai falet dhe unë, Zoti, nuk i kujtoj më ato.

Në këtë mënyrë ju mund të dini nëse një njeri pendohet për mëkatet e tij—vini re, ai do t’i rrëfejë ato e do t’i braktisë ato” (DeB 58:42–43).

Kur ju i rrëfeni dhe i braktisni mëkatet tuaja, Zoti do t’ju falë. Nuk do t’ju duhet t’i rrëfëni Atij për ato mëkate kur të vijë koha që ju të gjykojeni.

### Çfarë Ndoth nëse nuk Rrëfëhem?

Ndonjëherë një person nuk do të veprojë më gabim por nuk do t’i rrëfëhet kurrë, kur është e nevojshme, peshkopit të tij apo të saj. Si pasojë, personi vazhdon ta mbajë i vetëm barrën e mëkatit, në vend që ta lejojë Shpëtimtarin t’ia largojë atë.

Më lejoni t’ju jap një shembull. Një mbrëmje disa vite më parë, po intervistojta të rriturit për rinovimin e reko-mandimeve të tyre të tempullit. Një mesogrua erdhi për intervistën e saj. Ajo ishte martuar në tempull dhe ishte aktive në Kishë gjithë jetën e saj.

Ndjeva një trishtim të thellë në shpirtin e saj. Ndërsa intervista vazhdoi, mora një mbresë shpirtërore. I thashë: “Motër, kam përshtypjen se ju keni kryer një gabim të rëndë kur ishit adoleshente që nuk ia keni rrëfyer një udhëheqësi të priftërisë. A do të jesh e gatshme të më tregosh për të?”

Ajo menjëherë filloi të qante. Ajo më tha se ishte e vërtetë, por ishte ndier gjithnjë tepër e sikletosur për t’ia rrëfyer atë një peshkopi. Ndërsa rrëfeu atë që kishte bërë, ajo tregoi hollësi të mjaftueshme për mua që të përcaktoja denjësinë e saj.

Rrëfimi i mëkatit të saj te një udhëheqës i priftërisë shënoi fundin e procesit të saj të pendimit në vend të fillimit. Ajo kishte mbajtur në mënyrë të panevojshme barrën dhe dhembjen e atij mëkati për më shumë se 30 vjet.

Për shkak se e përfundoi hapin e fundit të pendimit, faji i saj u fshi. Pas mbrëmjes së asaj interviste, do ta shihja atë herë pas here. Pamja e saj u bë e shndritshme dhe ajo ishte e lumtur.

Dua të dini se nuk e mbaj mend emrin e saj. Zoti mund t’i fshijë të tilla kujtime nga peshkopët. Ajo që vërtet mbaj mend është se, përmes rrëfimit tek udhëheqësi i saj i priftërisë, një mesogrua u lehtësua nga ndjenjat e fajit që i kishte mbajtur për tepër shumë vite.

Ju lutem mos e bëni atë gabim. Nëse keni ndjenja faji por nuk jeni të sigurt nëse duhet të rrëfëni te peshkopi



juaj, shkoni ta shihni atë. Lejojeni t'ju ndihmojë. Mos rrezikoni të mbani një barrë të panevojshme gjatë jetës suaj, që do t'ju lërë të ndiheni mjeranë. Përmes rrëfimit tuaj te peshkopi dhe pendimit tuaj, Zoti do ta heq atë barrë nga shpirti juaj (shih Isaia 1:18).

### **Përse Duhet të Pendohem?**

Jezu Krishti pagoi çmimin e mëkateve të të gjithë njerëzimit përmes sakrificës së Tij shlyese. Ai ju fton të pendoheni dhe të shmangni dhembjen dhe vuajtjen e tepërt. "Pendohu, përndryshe . . . vuajtjet e tua do të jenë të ashpra—sa të ashpra ti s'e di, sa therëse ti s'e di, po, sa të vështira për t'u duruar ti s'e di.

Pasi vër re, unë, Perëndia, i kam vuajtur këto gjëra për të gjithë, që ata të mos vuajnë nëse do të pendohen;

Por nëse nuk do të pendohen, ata duhet të vuajnë po aq sa unë; . . .

Si rrjedhim, unë të urdhëroj përsëri të pendohesh . . . dhe që ti të rrëfesh

mëkatet e tua, përndryshe do t'i vuash këto ndëshkime për të cilat unë kam folur" (DeB 19:15–17, 20).

Dëshmoj se, përmes vuajtjes së Tij, Jezu Krishti tashmë pagoi çmimin për mëkatet tuaja. Ju mund të faleni për aq sa pendoheni. Mos u përpiqni të paguani çmimin për mëkatet tuaja. Asnjë sasi e vetë vuajtjes suaj nuk do t'ju shëlbojë; është vetëm përmes Shlyerjes që ju merrni falje.

Ushtrofshi besim në Jezu Krisht dhe Shlyerjen e Tij. Dëshmoj në emrin e Jezu Krishtit se përmes pendimit, duke përfshirë rrëfimin te peshkopi juaj kur është e nevojshme, ju do të bëheni të pastër. Veç kësaj, përmes hirit të Shpëtimtarit – fuqisë së Tij ndihmuese – ju mund të forcoheni në aftësinë tuaj për t'i rezistuar tundimit në të ardhmen. Në këtë mënyrë, ju do të keni paqe të mendjes dhe lumturi në këtë jetë dhe ju do të trashëgoni jetë të përjetshme në botën që vjen. ■



### **MJEKU YNË I MADH**

"Shpëtimtari shpesh quhet Mjeku i Madh. . . . Ndjenja e fajit është për shpirtin

tonë ashtu siç është dhembja për trupin tonë – një paralajmërim për rrezikun dhe një mbrojtje nga dëmi shtesë. Nga Shlyerja e Shpëtimtarit rrjedh balsami qetësues që mund të na i shërojë plagët tona shpirtërore dhe ta largojë ndjenjën e fajit. Sidoqoftë, ky balsam mund të zbatohet vetëm përmes parimeve të besimit në Zotin Jezu Krisht, të pendimit dhe bindjes së qëndrueshme. Rezultatet e pendimit të sinqertë janë paqja e ndërgjegjes, ngushëllimi dhe shërimi e përtëritja shpirtërore.

Peshkopi ose presidenti juaj i degës është ndihmësi i mjekut shpirtëror, që autorizohet t'ju ndihmojë të pendoheni dhe të shëroheni."

**Plaku Dejvid A. Bednar, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, "Ne Besojmë në Qenien të Dëllirë", Liahona, maj 2013, f. 44.**



Nga Plaku O. Vinsent Halek,  
i Të Shtatëdhjetëve

# Ta Ftojme Shpëtimtarin që të Hyjë Brenda

*“Ja, unë qëndroj te dera dhe trokas; nëse dikush dëgjon zërin tim dhe të hapë derën, unë do të hyj tek ai” (Zbulesa 3:20).*

**K**ur isha djalë i vogël, në kohë Krishtlindjeje, nëna ime tregoi një figurë të Shpëtimtarit që po trokiste te një derë. Ne nuk ishim ende anëtarë të Kishës dhe unë gjithmonë pyesja: “Përse po troket Jezusi te dera? Cili është nga ana tjetër?”

Disa vite më vonë, zbulova se nuk kishte dorezë në anën e jashtme të derës ku po trokiste Shpëtimtari.

Njeriu që ishte brenda, duhej ta hapte derën. Tani e di se cili është në anën tjetër të derës.

Jemi ne! Shpëtimtari po troket dhe ne të gjithë duhet ta hapim derën e ta ftojmë Atë të hyjë në jetën tonë.

Kur isha adoleshent, vendosa ta ftoja Shpëtimtarin në jetën time duke u pagëzuar dhe duke u bërë anëtar i Kishës. Miqtë e mi ishin shembuj të mirë për mua. Po ashtu

qe gjyshja ime. Ajo qe punonjëse tempulli në Tempullin e Los Anxhelosit në Kaliforni. Ajo do të dilte nga shtëpia në orën 04:00 në mëngjes që t’i shërbente Zotit në tempull.

Vetëm dy vite pasi u pagëzova, vendosa se dëshiroja t’i shërbeja Zotit si misionar kohëplotë. Në misionin tim, ndihmova shumë njerëz që të mësonin për Shpëtimtarin në mënyrë që të mund ta ftonin Atë në jetën e tyre.

Më vonë, shërbeva si president misioni në Samoa. Gjithmonë i pyesja misionarët e rinj se kur ndodhi që vendosën të shërbejnë në mision. Shumë thanë se ishin në Fillore kur vendosën të shërbenin!

Fillorja do t’ju ndihmojë të përgatiteni për shërbim misionar. Mësoni sa më shumë që të mundeni. Vendosni një qëllim që të shërbeni në një mision. Atëherë edhe ju do të jeni në gjendje t’i ndihmoni njerëzit që ta ftojnë Shpëtimtarin të hyjë në jetën e tyre. Të qenit një misionar do t’jua ndryshojë jetën – ajo e ndryshoi jetën time. ■



# Dhjak Fringo

*Shpërndarja e sakramentit është një përgjegjësi e madhe. Po sikur të bënte rrëmujë?*

**Nga Xhejn Mek-Brajd Çoejt**

Sipas një historie të vërtetë

*“Dhe gjithashtu gjithë ata që e pranojnë këtë priftëri, më pranojnë mua, thotë Zoti” (DeB 84:35).*

**B**enxhi qëndroi para pasqyrës, duke rregulluar kravatën. Këmisha e tij e bardhë dhe pantallonat blu e errët përshtateshin përsosmërisht. Flokët ishin të krehura. Sigurisht që dukej gati të shugurohej dhjak. Atëherë, përse ndihej kaq i shqetësuar?

Benxhi rrëmbeu shkrimet e tij të shenjta dhe u largua nga dhoma. U përpoq të mos mendonte se sa të ndryshme do të ishin gjërat në kishë sot. Dhe pastaj ishte detyra e re e priftërisë që e shqetësonte kurdoherë që mendonte për të: shpërndarja e sakramentit. Po sikur të bënte një gabim herën e tij të parë në javën e ardhshme? Ai u përpoq ta harronte edhe atë ndërsa po dilte nga shtëpia.

Mbledhja e sakramentit shkoi njëlloj si gjithmonë. Por më pas, Benxhi shkoi bashkë me familjen e tij te zyra e peshkop Salazarit. Kjo padyshim që ishte ndryshe. Zakonisht ai do të ishte te veprimtaritë e







“Nëse ju [dhjakë] . . . do ta lartësoni thirrjen tuaj, ju do të jeni mjete në duart e Perëndisë që tani, pasi priftëria të djali është po aq e fuqishme sa edhe priftëria të burri, kur ajo ushtrohet me drejtësi.”

Plaku Ted R. Kelister, i Të Shtatëdhjetëve, “Fuqia e Priftërisë të një Djalë”, *Liahona*, maj 2013, f. 54.

hapjes të orës mësimore të Filllores pikërisht tani.

Benxhi u ul ndërsa Babi, peshkopi, presidenti i Të Rinjve dhe këshilltarët e peshkopatës i vendosën duart mbi kokë. Babi i dha atij Priftërinë Aarone. Gjatë bekimit, shtrëngimet në stomakun e Benxhit u zhdukën. Ai u ndje i qetë e i lumtur.

Benxhi u ul dhe shtrëngoi duart me të gjithë. Pastaj përqafoi Mamin, vëllanë e tij, Xhein, dhe motrën e vogël, Mirasolin.

Më pas, ai shkoi te Shkolla e së Dielës. Edhe pse orët e reja mësimore nuk ishin njësoj si në Filllore, përsëri dukeshin të njohura. Mësimi i kushtojë lutjes. Ai kishte bërë plot mësim mbi lutjen më parë te Fillorja. Benxhi nxori një psherëtimë lehtësimi. Ndoshta të qenit dhjak nuk do të ishte aq e vështirë.

“Do të jetë shkëlqyeshëm”, i tha Xhei Benxhit pas kishës. “Unë do ta bekoj sakramentin dhe ti mund ta shpërndash.”

Gjithë shtrëngimet në stomak u kthyen sërish. “Po, shkëlqyeshëm”, tha ai qetësisht. Shpërndarja e

sakramentit ishte gjëja për të cilën shqetësohej më shumë Benxhi.

Më vonë atë mbrëmje, Benxhi e gjeti Babin duke lexuar në divan. “Po sikur ta kapërcej ndonjërin dhe ai të mos e marrë sakramentin?” pyeti ai. “Po sikur të pengohem?” Ai mund ta shihte fare qartë në mendje tabakanë duke rënë zhurmshëm mbi dysheme dhe gotëzat e ujit duke fluturuar ngado.

Babi i shtrëngoi supin Benxhit. “Më kujtohet hera e parë kur shpërndava sakramentin. Ndoshta isha më i shqetësuar nga sa je ti pikërisht tani.”

Benxhi kapsalliti sytë i habitur. “Ti? Ti nuk ke frikë nga asgjë!”

Babi qeshi. “Jam tmerruar plot herë. A e di se çfarë më ndihmoi ta kapërceja shqetësimin?”

Benxhi mendoi për një çast. “Lutja?”

Babi buzëqeshi. “E saktë. Lutja. Dhe babai im më dha një bekim. A do të doje që të të jepja një bekim?”

Benxhi pohoi shpejt me kokë. “Po. Do të doja shumë.”

Familja u mblodh në dhomën e ndenjjes. Babi i vuri duart mbi

kokën e Benxhit. Ndërsa Babi fliste, Benxhi ndjeu t’i mblihdeshin lotë. “Kujto”, tha Babi në bekim, “ti e ke marrë priftërinë përmes një ordinarie të shenjtë. Ati Qiellor na e dha priftërinë që ne të mund t’u shërbejmë të tjerëve. Nëse mund ta bësh këtë me qëllim të plotë të zemrës, ti do të bekohesh në këtë dhe në të gjitha gjërat.”

Gjithë javën Benxhi u lut për ndihmë. Të dielën pasuese, ai u bashkua me dhjakët në fillim të sallës kishtarë. Ai dëgjoi nga afër kur Xhei tha bekimin për bukën.

Befas ai u ndje tërësisht i shqetësuar sërish. A mund ta bënte vërtet këtë? Ishte kaq e rëndësishme! Pastaj ai kujtoi premtimet nga bekimi i Babit. Ndjenjat e tij të shqetësimit u larguan ndërsa Shpirti qëndroi mbi të.

Ai mori tabakanë dhe lëvizi me besim në vetvete te rreshtat që i kishin caktuar. Me kujdes, ai i dha tabakanë një gruaje në rreshtin e parë.

Ajo i buzëqeshi atij. Benxhi i buzëqeshi, duke e ditur se po i shërbente Zotit. ■

# Duke Pritur

në

## Lagjet Dimërore

Lagjet  
Dimërore

SHTEGTIMI I AJOUAS

AJOUA


Navu

Nga Xhenifer Medi

### Një Qytet i Ri

Pasi u vra Profeti Jozef Smith, Navuja në Illinois u bë një vend i rrezikshëm. Shenjtorët u larguan me të shpejtë nga shtëpitë e tyre për të gjetur një vend më të sigurt për të jetuar. Në shkurt 1846, grupi i parë i shenjtorëve filloi udhëtimin e tyre drejt perëndimit, por moti i keq dhe sëmundjet i ngadalësuan ata. Në kohën kur kapërcyen Ajouan, ishte tepër vonë për të kapërcyer Malet Shkëmbore përpara dimrit. Kështu që udhëheqësit e Kishës zgjodhën një vend ku shenjtorët të mund të qëndronin gjatë dimrit. Ata e quajtën atë Lagjet Dimërore.

*Kjo paraqitje brenda Qendrës së Shtegut të Mormonëve në Lagjet Dimërore rikrijon një kamp në shtegun e Ajouas ku Uilliam Klejtoni shkroi himnin "Eni Shenjtorë" (Himne dhe Këngë të Fëmijëve, f. 2).*





### Puna së Bashku

Disa njerëz ndërtuan shtëpi me trungje ose torfë. Të tjerë jetuan në tenda dhe shpella. Shenjtorët u përpoqën të ishin të gëzueshëm gjatë dimrit të gjatë e të ftohtë. Ata e ndihmuan njëri-tjetrin. Ata shkuan në koncerte dhe kënduan e vallëzuan. Ata ndërtuan një mulli mielli, një bashki dhe një punishte prodhimi koshash.

### Shkuarja Përpara

Koha që shenjtorët kaluan në Lagjet Dimërore, qe e vështirë. Shumë njerëz vdiqën. Por pionierët patën besim se Zoti do t'i bekonte ata dhe do t'i ndihmonte t'ia dilnin të shkonin në Sion. Kur më në fund erdhi pranvera, grupi i parë i pionierëve u largua nga Lagjet Dimërore për të udhëtuar për në Luginën e Solt-Lejkut.

Sot, ju mund të shihni Tempullin e Lagjeve Dimërore në Nebraskë dhe të vizitoni Qendrën e Shtegut të Mormonëve në Lagjet Dimërore për të mësuar më shumë për pionierët. ■

*Te Qendra e Shtegut të Mormonëve, ju mund të shihni llojet e furnizimeve që shenjtorët morën në udhëtimin e tyre drejt perëndimit. Udhëheqësit e Kishës u thanë atyre të merrnin miell, erëza, oriz, fasule dhe lopë qumështi.*



*Disa nga shenjtorët ndërtuan kasolle me trungje për të jetuar në kohën kur ishin në Lagjet Dimërore.*



# Shenjtorët Ndalojnë te Lagjet Dimërore

Nga Ari Van De Graf

Pionierët u vendosën për njëfarë kohe te Lagjet Dimërore për të pritur që të kalonte dimri, përpara se të vazhdonin në udhëtimin e tyre drejt perëndimit. Shihni nëse mund të gjeni objektet e fshehura në këtë figurë.



Laps



Copë byreku



Tenxhere



Lugë



Lopatëz



Libër



Çelës mekanik



Filxhan



Leukoplast



Birilë bulingu



Karotë



Lëpirëse



Gjilpërë



Orë dore



Dardhë




# Si u flet profetëve Jezu Krishti?

**Nga Plaku D. Tod Kristoferson,**

i Kuorumit të  
Dymbëdhjetë  
Apostujve


*Anëtarët e Kuorumit  
të Dymbëdhjetë  
Apostujve janë  
dëshmitarë të veçantë  
të Jezu Krishtit.*

Ai mund të dërgojë një  
lajmëtar ose të shfaqet  
personalisht.



Ai mund të  
flasë me zërin  
e Tij ose në-  
përmjet zërit  
të Frymës së  
Shenjtë.

Ai mund t'u flasë shërbëtorëve  
të Tij veçmas, ose mund t'u flasë  
atyre teksa këshillohen  
së bashku.



Nga "Doktrina e Krishtit",  
*Liahona*, maj 2012, f. 86–90.

SIPAS DRETTIMITË AKREPAVE TË ORËS OË NGA LART MATIAS. THE FIRST VISION (VEGIMI I PARË), NGA JOHN SCOTT © IRI. JOSEPH SMITH RECEIVING THE PLATES (JOZEF SMITHI DUKE MARRË FLETËT), NGA KENNETH RILEY © IRI. FOTOGRAFI NGA DAVID WILLIAM NEWMAN © IRI. FOTOGRAFI NGA BUSAITH PHOTOGRAPHY; ENOS, PRAYING (ENOSI DUKE U LUTURJ), NGA ROBERT T. BARRETT, © IRI

Si mund të ishte e sjellshme  
Ema kur Violeta sillej kaq keq?

# Ndihmë

**Nga Sharlot Mae Shepard**

Sipas një historie të vërtetë

*“Dua je të afërmin tënd porsi vetveten” (Marku 12:31).*

**E**ma e mbërtheu më fort çantën e shpinës ndërsa hyri në klasën e re. Ishte dita e parë e shkollës. Kishte veshur fustanin e saj të parapëlqyer dhe Mami i kishte paketuar një ushqim të veçantë me drekën – biskota me forma kafshësh.

“Sot do të shkojë shkëlqyeshëm”, mendoi Ema me vete. “Për aq kohë sa –”

Ema ndaloi dhe vështroi ngultas nëpër klasë. Ja ku ishte ajo. Violeta.

Vitin e kaluar, Violeta kishte luajtur vetëm te shkallët suedeze në çdo pushim. Ajo i kishte vënë nofka Emës. Ajo madje i kishte grabitur Emës shoqen më të mirë!

Violeta e pa Emën dhe i nxori gjuhën. Ema e pa me inat, duke e shtrënguar edhe më fort çantën e saj të shpinës. Violeta nuk ishte sjellë miqësisht gjatë të gjithë vitit të kaluar dhe dukej se ky vit nuk do të kishte ndonjë ndryshim.

“Mirë se erdhët në një vit të ri, nxënës!” tha zj. Kolduell që nga fillimi i klasës. “Le të caktojmë vendet.”

Tavolinat ishin rreshtuar dyshe nëpër klasë. Zj. Kolduell lëvizi

gishtin nëpër listën e emrave; pastaj tregoi me gisht një çift tavolinash nga fundi. “Ema. Ti do të ulesh atje pas.”

Ema u ul në një nga tavolinat e pasme. Ajo shpresonte që Lizela të ulej pranë saj. Ose Xheimi. Ose – “Violeta.”

Koka e Emës hovi përjetë. A e kishte dëgjuar mirë?

Po. Zj. Kolduell ende po tregonte me gisht nga tavolina pranë të sajës. “Ti do të jesh fqinja e Emës, Violeta”, tha ajo.

Violeta eci zvargur drejt Emës me vetulla të rrudhura. Ema vuri kokën mbi tavolinë dhe ia nguli sytë murit. Do të ishte një vit i gjatë.

Në orën e matematikës, zj. Kolduell shkroi në tabelë disa problema që klasa t’i zgjidhte. “Mund të punoni vetëm ose me fqinjin tuaj”, tha ajo.

Ema me të shpejtë u kërrus mbi fletën e saj, duke bërë sikur ishte e zënë me punë. Problemat ishin mjaft të thjeshta. Ajo thjesht po përpiquej të shmangte Violetën. Ajo nuk i kishte hedhur asnjë vështrim gjithë mëngjesin.

Diçka e shpoi në sup. Dukej si një laps. Ema e shpërfilli.

Një shpim tjetër. Violeta po e shponte! Ema vazhdoi të punonte me kokëfortësi.

Shpimi i tretë i Violetës ishte aq i fortë sa t’i dhimbte. Ema mund ta ndiente veten duke vluar përbrenda. A do të ishte kështu i gjithë viti? Ajo mendoi të ngrinte dorën e t’ia



# për Violetën

tregonte zj. Kolduell. Ose ndoshta ajo thjesht do t'i hidhte Violetës një tjetër vështrim me inat.

Pastaj Ema dëgjoi një shfryrje hundësh. Mos po qante ndokush? Lapsi e shpoi sërish. Ajo ngriti sytë dhe pa Violetën që po e vështronte. Lapsin e kishte në dorë dhe kishte lotë në sy. Fleta e saj ishte mbuluar me njolla gome.

Violeta përdrodhi lapsin në duar. “A mund të më ndihmosh?” pyeti ajo qetë.

Ema e pa për një minutë, e tron-ditur. Violeta donte që ajo ta ndihmonte? Pasi ishte sjellë gjithmonë aq keq? Ema u kthye sërish te fleta e vet. Violeta mund të punonte vetëm. Ajo nuk e meritonte ndihmën e Emës, edhe nëse ajo ishte . . .

. . . fqinja e saj?

Ema heshturazi ishte kthyer përpara. Ajo mund ta dëgjonte Violetën që po qante dobët pranë saj. Shkrimet e shenjta gjithmonë thoshin ta doje të afërmin tënd – por Violeta ishte kaq e ndryshme! Ema thjesht po ulej pranë saj në klasë!

Ema iu kthye sërish punës së vet. Pastaj ndaloi. Ndoshta Violeta nuk ishte e ndryshme. Ndoshta kur shkrimet e shenjta thoshin ta doje të afërmin tënd, ato nënkuptonin gjithkënd. Madje dhe ato që silleshin keq. Edhe nëse ishte e vështirë.

Ema psherëtiu dhe ngadalë e uli poshtë lapsin e saj. Ajo u kthye nga

Violeta dhe u përpoq sa mundi që të buzëqeshte. “A mund të të ndihmoj?” pyeti ajo.

Violeta pohoi me kokë, duke i fshirë lotët me dorë.

Ema u përkul mbi fletën e Violetës dhe filloi ta ndihmonte për problemin e parë. Tashmë ajo kishte një ndjenjë të ngrohtë përbrenda. Ajo po vriste mendjen nëse Violetës i pëlqenin biskotat me forma kafshësh. ■



## DUKE NDJEKUR JEZUSIN

Jezusi do që ne ta duam gjithsecilin. Në shkrimet e shenjta, Ai na mëson ta duam familjen dhe miqtë tanë e t'i trajtojmë ata me mirësi. Jezusi dha mësim gjithashtu: “Duani armiqtë tuaj, beconi ata që ju mallkojnë, u bëni të mirë atyre që ju urrejnë” (Mateu 5:44). Kjo do të thotë që, edhe kur dikush nuk është i këndshëm me ju, ju mund ta ndiqni Jezusin duke u sjellë mirë dhe duke u përpjekur të jeni një mik.

ILLUSTRIMI NGA BRAD TEARE, THE LORD/JESUS CHRIST (ZOTI/JEZU KRISHTI), NGA DEL PARSON © IRI



# Unë do ta Ndaj Ungjillin me të Gjithë Fëmijët e Perëndisë

MAITAS: ILUSTRIM NGA MARK JARMAN, DIATHIAS; SIPAS AKREPAVE TË ORËS NGA MAITAS  
LART: ILUSTRIME NGA JIM MADSEN, JARED BECKSTRAND, ERIC BARCLAY DHE CELESTE SMITH

## KARTA PËR T'I NDARË

Ju mund ta ndani ungjillin duke dhënë një kartë për shpërndarje. Thjesht ngjitini kartat e faqes tjetër në një letër të trashë. Pastaj pritini kartat dhe shkruani mesazhin tuaj vetjak në anën tjetër.

## KËNGË DHE SHKRIM I SHENJTË

- Zgjidhni një këngë për punën misionare.
- Mateu 5:16

## LE TË BISEDOJMË

Mund ta bëni secilin pjesëtar të familjes që të vizatojë një figurë të frutit të parapëlqyer të tij apo të saj. Pastaj, në anën e pasme të vizatimit, secili person mund të shkruajë mbi atë se si ungjilli i bekon jetën. Më pas ju mund të flisni së bashku mbi mënyrat se si mund ta ndani ungjillin me miq e fqinjë.

**A**këni ngrënë ndonjëherë diçka që ishte aq e mirë saqë donit ta ndanit atë? Profeti Lehi pa njëherë në ëndërr sikur po hante një copë të një fruti të shijshëm. Shija ishte kaq e mirë saqë ia “mbushi shpirtin [e tij] me një gëzim jashtëzakonisht të madh” (1 Nefi 8:12). Lehi dëshironte që edhe familja e tij ta shijonte atë frut të shijshëm.

Fruti në ëndrën e Lehit është si dashuria e Atit Qiellor. Lehi dëshironte që familja e tij ta ndiente dashurinë e Atit Qiellor. Ai dëshironte ta ndante ungjillin me ta sepse e dinte që ai do t'i bënte ata të lumtur.

Fëmijët shpesh janë shumë të mirë në ndarjen e ungjillit me të tjerët.

Maria tetëvjeçare i pa misionarët në rrugët e Ekuadorit. Ajo i pyeti nëse ata do t'ia mësonin asaj ungjillin. Misionarët erdhën në shtëpinë e Maries që t'i jepnin mësimë familjes së saj. Maria ishte e para në familjen e saj që u pagëzua. Ajo ishte shumë e lumtur kur e gjithë familja e saj përfundimisht u bashkua me Kishën gjithashtu.

Eriku nëntëvjeçar ishte kaq i emocionuar për paraqitjen e Fillores në mbledhjen e sakramentit saqë ftoi fqinjët e tij që të vinin. Ata erdhën.

Që të dy këta fëmijë ndanë diçka të çmuar me njerëzit që i donin. Ndërsa ndani ungjillin, dëshmia juaj do të rritet. Ashtu si Lehi, ju do të ndieni “gëzim jashtëzakonisht të madh”. ■



“Mos ki frikë, sepse unë jam me ty.”

Zanafilla 26:24



“Lum ata që përpiqen për paqen.”

Mateu 5:9



“Jini të mirë dhe të mëshirshëm njeri me tjetrin, duke e falur njëri-tjetrin.”

Efesianëve 4:32



“Për çdo gjë falënderoni.”

1 Thesalonikasve 5:18



The Statue of Liberty is shown in the background on the left side of the page, holding the torch aloft. The background is a clear blue sky.

# Kamila nga Nju-Jork-Siti

**K**amila nëntëvjeçare ka plot shokë e shoqe. “Gjëja që më pëlqen vërtet për shoqet e mia, është se ato janë të gjitha të ndryshme”, thotë ajo. “Ato vijnë nga vende të ndryshme dhe kanë mënyra të ndryshme për t’i bërë gjërat.” Kamilës i pëlqen shumë të mësojë gjëra të mira nga shoqet e saj dhe i pëlqen të ndajë gjëra me to. Gjëja më e mirë

që ka ndarë ajo ndonjëherë me një shoqe, është ungjilli. Pasi ndau nenin e parë të besimit me shoqen e saj, Jalinën, Kamila e ftoi familjen e shoqes së saj që të takohej me misionarët. Kamila gjithashtu i mësoi Jalinës se si të lutej. Tani Jalina dhe nëna e saj janë anëtare të Kishës.

*Shoqja ime, Jalina, u pagëzua në vitin 2011. Më pëlqen shumë që ne mund të shkojmë në kishë së bashku. Unë po e ndihmoj atë që të mësojë përmendsh Nenet e Besimit. Ne po punojmë me nenin e nëntë të besimit.*

*Këngët e mia të parapëlqyera janë “Fëmi i Per’ndis’ Jam” dhe “Familjet Mund të Jen’ Bashk’ Përgjithmon’”. Shkrimi i shenjtë i parapëlqyer është Doktrina e Besëlidhje 19:23: “Mëso nga unë dhe dëgjoji fjalët e mia; ec në butësinë e Shpirtit tim dhe ti do të kesh paqe në mua”. Ky shkrim i shenjtë gjithmonë më mbush me gëzim kur jam e trishtuar.*



*Mami dhe babi im janë nga Republika Dominikane. Kjo ndoshta është arsyeja pse gjella ime e parapëlqyer është oriz e fasule me pulë. Ajo më kujton vendin prej nga vjen familja ime.*



*Në familjen time janë pesë vetë. Motra ime, Emilia, u pagëzua dhe u konfirmua në dhjetor. Vëllai im, Viktori, ka të njëjtin emër me babin. Nuk kam ende ndonjë kafshë shtëpiake, por po mendoj që të marr një breshkë. Më pëlqejnë breshkat sepse janë tërheqëse dhe të ngadalta, kështu që nuk largohen.*



*Më pëlqen shumë ndodhia e Kapiten Moronit në Librin e Mormonit. Babi im e lexoi në mbrëmje familjare dhe më frymëzoi që të bëj vetë flamurin tim. Flamuri im më kujton se cila jam dhe se Ati Qiellor është gjithmonë me mua.*

# FAQJA JONË



Prindërit e mi më kanë dhënë mësim ungjillin dhe kanë qenë shembuj të mirë për mua që kur isha i vogël. Unë mësova të lexoj ndodhi për fëmijë nga shkrimi i shenjtë dhe tani e dua Librin e Mormonit. E lexoj atë çdo ditë, vetëm dhe me familjen time. Amoni është njeriu im i parapëlqyer në Librin e Mormonit. Ai ishte një misionar i shkëlqyer, gjë çfarë dua të bëhem kur të jem më i madh.

**Esteban M., 8 vjeç, Kolumbi**




Kur familja jonë ishte me pushime në Panama, vendlindja e nënës sime, prindërit e mi na çuan motrën time të vogël, Joalibetën, dhe mua që të vizitonim Tempullin e Qytetit të Panamasë në Panama. Nëna na çoi që të preknim murin e tempullit. Më vonë, kur i thashë nënës sime se sa i lumtur u ndjeva kur ishim në tempull, ajo më tha se kisha ndier Frymën e Shenjtë.

**Serxhio B. i Riu, 7 vjeç, Floridë, SHBA**



**Pasha Z., 9 vjeç, Ukrainë**



**Kur Leticia C., 6 vjeçe, ishte 3 vjeçe, u përfundua Tempulli i Kuritibës në Brazil. Asaj i pëlqente shumë të shkonte në tempull dhe shkoj atje çdo ditë të javës së fundit të shtëpisë së hapur. Asaj ende i pëlqen shumë të vizitojë tempullin dhe të eci nëpër kopshtet e mrekullueshme. Leticias i pëlqen shumë edhe të vizatojë e të notojë.**



**FILLORJA: NDIQENI JEZUSIN**

**Mauricio D., 11 vjeç, e pëlqen mbledhjen e sakramentit sepse mëson për Atin Qiellor dhe Jezu Krishtin. Atij i pëlqen të shkojë në kishë sepse është zbavitëse, interesante dhe shumë bukur. Ai është i lumtur në Kishë dhe ka shumë shokë.**



Kur po bëheshim gati për ceremoninë e hapjes së themeleve për Tempullin e Tihuanas në Meksikë, ishim shumë të lumtur. Ne shkua si familje për të dhënë shërbim. Ne pastruam mjedisin e tempullit. Unë e di se Zoti do ta vizitojë shtëpinë e Tij kur të përfundojë.

**Hezus S., 6 vjeç, Meksikë**



Bảng Khắc  
Bảng Vàng


Studimi i shkrimeve të shenjta më ndihmon të zgjedh të drejtën.

**"Fletët e Arta", nga P. Tuiet Hoa, 10 vjeçe, Kamboxhia**



Unë zgjedh të drejtën kur ndjek Atin Qiellor dhe Jezu Krishtin.

**N. Ti Lin-Da, 8 vjeçe, Kamboxhia**



Pjesa ime e parapëlqyer në Librin e Mormonit është historia e Nefit dhe udhëtimi përmes detit.

**Keli C., 10 vjeçe, Filipine**



Neve na duhet të vulosemi në tempull që të mund të jetojmë si një familje përgjithmonë.

**Shana C., 8 vjeçe, Filipine**



Më pëlqen të shkoj në kishë me familjen time dhe të mësoj për Jezu Krishtin. Në shtëpi më pëlqen të lexoj dhe mësoj ndodhi nga shkrimi i shenjtë, të këndoj himne dhe të luaj lojëra gjatë mbrëmjeve familjare. Ungjilli bekon familjen time dhe më bën të ndihem i lumtur. Lu kam dhënë tashmë nga një Libër të Mormonit tre mësuesve dhe shokut tim më të mirë, Migelit. Kënga ime e parapëlqyer e Fillores është "We'll Bring the World His Truth" ["Botës t'vërtetën e Tij do t'i Sjellim"] (*Children's Songbook*, 172).

**Martim P., 6 vjeç, Portugali**



**Henrike S., 7 vjeç, Brazil**

# Jezusi i Bekon Fëmijët e Vegjël

**Nga Jan Pinboru**

Revistat e Kishës

Shumë njerëz u mblodhën  
përreth Jezusit. Ata donin ta  
dëgjonin Atë të tregonte histori.  
Ata donin ta dëgjonin Atë t'u  
mësonte për qiellin.





Kur njerëzit ishin të sëmurë, Jezusi i shëroi ata. Ai shëroi njerëz që nuk mund të shihnin. Ai shëroi njerëz që nuk mund të dëgjonin.



Një ditë, disa njerëz i sollën fëmijët e tyre të vegjël që ta shihnin Jezusin. Ata donin që Ai t'u jepte një bekim fëmijëve të tyre. Dishepujt e Jezusit u thanë njerëzve të mos e bezdisnin Jezusin. Ata menduan se Ai ishte tepër i zënë.

Jezusi nuk ishte tepër i zënë. Ai u tha dishepujve që t'i lejonin fëmijët të vinin tek Ai. Ai tha se mbretëria e qiellit u përket njerëzve që janë si fëmijët e vegjël.



Jezusi i do të gjithë fëmijët. Nuk ka rëndësi se cili jeni, çfarë pamje keni, apo ku jetoni. Jezusi ju do juve! ■

*Nga Marku 10:13-16.*





**Jezusi i Bekon Fëmijët e Vegjël**

“Dhe, si i mori në krahë, i bekoï duke vënë duart mbi ta” (Marku 10:16).

# UNË BETOHEM . . .

Nga R. Val Xhonsion

Revistat e Kishës

Vështrimi në fytyrën e nënës time më këputi zemrën. Tronditje. Trazim. Zhgënjim. Të gjitha këto emocione i mbushën sytë asaj njëri pas tjetrit dhe pastaj u shkrinë në një emocion – tradhti.

Megjithë mësimet e saj gjatë gjithë 15 viteve të mi për të nderuar Atin Qiellor në fjalë e vepër, ja ku isha, fajtor se lejova një fjalë veçanërisht fyese të dilte nga buzët e mia.

Nuk kisha ndër mend të betohesha. Përpara atij viti, nuk kisha përdorur kurrë fjalor të pistë. Por atë verë kisha punuar për Departamentin e Peshkimit dhe Lojërave të Jutas dhe e kisha marrë atë zakon nga djelmosha të tjerë që punonin me mua.

Detyra jonë kryesore ishte të pastronim anët e rrugëve shtetërore nga bimët e rrodheve. Menjëherë e dalluam se *Arctium minus* është një barishte veçanërisht e keqe. Ajo rritet në sasi të madhe thjesht në çdo vend dhe mbyt shumë bimë të tjera. Rrodhet e saj i ngjiten çfarëdo gjëje që i vjen afër.

Me lopata në duar, ne e luftuam atë kundërshtar gjatë gjithë verës, deri në rraskapitje – dhe fjalor të pistë. Së pari, e vlerësova si fytes fjalorin e shokëve të mi të punës. Pastaj e lejova. Së fundi, e përvetësova. Deri nga fundi i verës, betimet po u ngjiteshin fjalëve të mia po aq shumë sa rrodhet u ngjiten qimeve të qenit.

Reagimi i nënës time ndaj shkarjes sime të gjuhës, megjithatë, më bindi se kisha nevojë të ndryshoja.



*Betimet po u ngjiteshin fjalëve të mia po aq shumë sa rrodhet u ngjiten qimeve të qenit.*

Nuk ishte e lehtë. Betimi nuk është thjesht një zgjedhje fjalësh. Ai është gjithashtu një model i të menduarit. Bisedat që lejojmë në jetën tonë, fjalët që lexojmë, dhe figurat që shohim, iu japin formë mendimeve tona. Shpejt mësova se më duhej të ndryshoja atë çfarë ftoja në mendjen time nëse dëshiroja të ndryshoja fjalët që përdorja.

Fatmirësisht, isha aktiv në pjesëmarrje në kishë dhe seminar. Betimi kishte përzënë mendime më lartësuese, por të qenit në një mjedis ku isha i ekspozuar ndaj atyre mendimeve më lartësuese i lejoi ato të zinin rrënjë sërish. U përqendrova në leximin e shkrimeve të shenjta çdo ditë dhe te lutja. Qëndrova larg prej filmave dhe programeve televizive që risillnin mendime të padrejta.

Ngadalë, pashë se fjalori im po përmirësohej. Nga fundi i vitit, isha çliruar nga zakoni im i të betuarit.

Që nga ajo përvojë, kam mësuar shumë mbi fuqinë e fjalëve. Fjalët mund të krijojnë ose të shkatërrojnë. Ato mund të lëndojnë ose të shërojnë. Ato mund t'i poshtërojnë njerëzit ose mund të mbjellin fara shprese dhe dashurie.

Më duket interesante se Vetë Shpëtimtarit, Krijuesit të qiellit dhe tokës, i referohen si Fjala (shih Gjoni 1:1–4; DeB 93:6–11).

Kam mësuar se betimi ka një kuptim pozitiv ashtu si dhe një negativ. Ne betohemi që të themi të vërtetën në një gjykatë. Ne pretojme solemnisht, ose betohemi, të mbajmë urdhërimet e Perëndisë kur pagëzohemi. Ngjashëm, ne bëjmë premtime të shenjta që të mbajmë besëlidhjet tona të tempullit me qëllim që të marrim bekimet më të madhërishtme të Atit Qiellor.

Përfundimi është ky: Ne bëhemi më shumë si Fjala kur fjalët tona e nderojnë Atë dhe pasqyrojnë lavdinë e Tij. ■



## DEJVID O. MEK-KEI

Dejvid O. Mek-Kei u rrit në **fermën e familjes** së tij në Hantsvill në Juta. Ai i donte shumë kafshët dhe mbajti **kuaj** gjatë gjithë jetës së tij. Kur shërbeu një mision në Britaninë e Madhe, ai zbuloi një **thënie** që u bë motoja e tij: “Pavarësisht se kush je, luaje mirë rolin tënd”. Ai u kthye shumë herë në Britaninë e Madhe dhe përkushtoi **Tempullin e Londrës në Angli** në vitin 1958.



*“Si prindër dhe udhëheqës, neve na duhet ta ndihmojmë rininë që jo vetëm të përgatitet për shërbim misionar kohëplotë, që zgjat veçse disa muaj, por gjithashtu për të bërë dhe mbajtur besëlidhjet e tempullit, që zgjaten për përjetësinë. Hapat e parë mund të fillojnë në fëmijëri.” Shih “Adoleshentët dhe Besëlidhjet e Tempullit”, faqe 18. Ky artikull dhe artikuj të tjerë këtu mund të ndihmojnë anëtarët, si të rinj edhe të moshuar, që të përgatiten më mirë për të ndarë dhe jetuar ungjillin.*

KISHA E  
JESU KRISHTIT  
E SHENJTORËVE TË  
DITËVE TË MËVONSHME

4



02107901011

1

ALBANIAN

10730 Oct 13